VITI XVI BOTIMIT Nr.703 13 JANAR 2024 ÇMIMI 50 LEKË / 0,50 EURO

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online

NACIONAL

Botues: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com
Mob: 068 20 74 316
www.gazeta-nacional.com
Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Flet politikani, historiani dhe shkrimtari Dr. Uran Butka, në 85 vjetorin e lindjes

Uran Butka: Ju tregoj mbijetesën në diktaturë dhe zhgënjimin nga demokracia

Poezia është e ndikuar nga një serë fenomenesh, letrare, sociologjike

Poezia e Asja Mulgecit si një ripërtëritje e saj nëpërmjet variantit gegë

Nga dr. Mujë Buçpapaj

EDITORIAL

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE KOSOVË- SERBI, NJË ÇËSHTJE SIGURIE PËR RAJONIN DHE EUROPËN

Nga Bajram BEGAJ
President i Republikës

Për mua ky takim është i një rëndësie të veçantë, sepse është mundësi e mirë të ndajmë bashkë jo vetëm

LIBRI "QEVERISA E SHQIPËRISË GJATË LUFTËS II BOTËRORE 1939-1944"

Nga Jusuf Buxhovi

Libri i Gjet Ndojt "Qeverisa e Shqipërisë gjatë luftës II botërore 1939-1944" duhet parë si një kontribut i rëndësishëm demistifikimti

AKDAMIK VALTER MEMISHA NJË PERSONALITET I SHQUAR I GJUHËSISË SHQIPTARE

Nga Feti ZENELI

Të shkruash për Akademik Valter Memishën nuk është e lehtë. Jo se nuk ke material apo të dhëna për të.

EDHE NJË HERË PËR JURITË LETRARE

Nga Rudolf Marku

Gjatë vitit që sapo kaloi, bota jonë letrare u

Bisedë me Gjuhëtarin, Filozofin dhe Shkrimtarin Albert V. Nikolla, Bruksel

A KA NJË MARRËVESHJE TË FSHEHTË GREKO-TURKO-SERBE PËR ZHDUKJEN E KOMBIT SHQIPTAR ?

Poezia e Bardhyl Maliqit u botua në dhjetra gjuhë të ndryshme, duke u vlerësuar edhe me çmime të rëndësishme letrare

NDAHET NGA JETA POETI DHE STUDIUESI I MIRËNJOHUR, DR. BARDHYL MALIQI, PEDAGOG I FILIALIT UNIVERSITAR TË SARANDËS

Prof. Dr. Luan Perzhita merr "Çmimin e historianit të vitit 2023", për librin "Fortesat e Drinit në shekujt IV-VI", nga gazeta "Nacional"

Tre libra me epigrame bashkëkohore të Viron Konës

Shkruan: Fran GJOKA

KËNGËTARI I NJOHUR ARIF DUSHAJ, SAPO KA REALIZUAR "KANGË KUSHTUAR FATIME SOKOLIT"

NË BRENDËSI

FAQE 12

POEMË NGA WALT WHITMAN
PËRKTHEU: UKË BUÇPAPAJ

FAQE 4
POEZI NGA LAURA GARAVAGLIA
SHQIPEROI: ANILA DAHRIU

FAQE 10

FLET PËR "NACIONAL" POETI AMERIKAN MICHAEL LEE JOHNSON
INTERVISTOI: IRMA KURTI

FAQE 5
POEZI NGA MIRASH MARTINOVIÇ
PËRKTHEU NGA GJUHA MALAZEZE QAZIM MUJA

FAQE 6

SONETI NË POEZINË SHQIPE
NGA PROF. DR. MR. MILAZIM KRASNIQI

FAQE 22
FLUTURA E DHJETORIT DHE TREGIME TË TJERË
NGA KONSTANDIN DHAMO

FAQE 14

SPORTELI NUMËR ZERO
TREGIM SATIRIK NGA ADEM NIMANI

UNIVERSITETI LUARASI

Bisedë me Gjuhëtarin, Filozofin dhe Shkrimtarin Albert V. Nikolla

KA NJË MARRËVESHJE TË FSHEHTË GREKO-TURKO-SERBE PËR ZHDUKJEN E KOMBIT SHQIPTAR

Petro Zheji; "Shqiptarët janë antishqiptarë. Nuk është bërë asgjë për Veriun. Për zbulimin arkeologjik të Shqipërisë. Atje janë mbledhur vetëm këngët për partinë: 'Moj parti moj bukuroshe, qe me hedh qoshe me qoshe'. Pikë e zezë!"
Frazë e shkëputur nga seria e intervistave te Afërdita Zajës me Petro Zhejin.

Intervistoi Prof.Doc. Mujo Buçpapaj

M.B: Zoti Albert Nikolla! Universiteti i Oxfordit, në verën e vitit 2022, publikoi studimet gjenetike ne popullatat evropiane ku konfirmoi se gjeni EV-13 që mbartin shqiptarët në Shqiperi Kosovë e dhe atë të viseve ku jetojnë Arvanitët , konsiderohet si më i vjetri në Evropë? Ju e kishit pretenduar një fakt të tillë që në botimin tuaj në versionin frëngjisht që në verën e vitit 2020?

-Po! Të thëna rreth etnogjenezës se popullit shqiptar, i pata hasur në studimet e antropologut me origjinë Bullgare Georgi Georgiev, i cili përcakton mbërritjen e njeriut të parë në tokën evropiane rreth 48 mijë vite me parë nëpërmjet Dardaneleve në zonat jugore të Ballkanit dhe me pas studimeve laboratorike të Neo-zelandezit Quentin Atkinson. Por studime më të thelluara gjenetike dhe antropologjike u kryen sidomos nga grupi i shkencëtarëve Leonidas-Romanos Davranoglou, Aris Aristodemou, David Ëesoloësky dhe Alexander Heraclides, në qendrën e kërkimeve gjenetike të Oxfordit ne Angli (Oxford University Museum of natural Histori) dhe Scool of Science, - European Univesrsity Ciprus, në Nikozi të Qipros . Këto studime nuk janë të rastësishme, (vetëm disa vjeçare), por përfshinë dy gjenerata studiuesish evropianë e amerikane ku spikasin sidomos studimet e profesorit italian Luigi Luca Cavalli Sforza , i cili që para 20 vitesh ka paraqitur nga ana e tij edhe skemën e vjetërsisë së gjuhëve gjuhësore bazuar në të dhënat gjuhësore, atropomologjike dhe gjenetike. Kështuqë nuk e pata të vështirë të kryeje edhe një paralele mes këtyre studimeve gjenetike dhe atyre gjuhësore dhe pjesën aksiale që zë shqipja ne sistem. Madje edhe rritjen e moshës se gjuhës fillestare indo-evropiane me rreth 2 mije vite më shumë, personalisht e pata parashikuar ne librin tim versioni frëngjisht, "LE CELTE PRÉHISTORIQUE : GUÈGUE, LA LANGUE–MÈRE DU MONDE" -Bruksel 2020,- (Ribotim EUE - London 2023) para se studimi të publikohej për publikun nga 33 gjuhëtaret , antropologët dhe gjenetistët më të mëdhenj të Botës aktuale

-M.B: Por kohët e fundit, megjithëse rezultatet janë tashmë të pakthyeshme dhe te vulosura shkencërisht, kane dale zëra donkishoteskë, sidomos brendaShqipërisë, që e kundërshtojnë këtë ngritje në qiell të vlerave të gjuhës shqipe?

-Me kanë folur për një fushatë denigruese që ka ndërmarrë Gjergj Bojaxhiut , kundër meje ... si përkrahës i tezes pellazgjike... Pelagonia ka qenë fakt unë kam patur respekt Gjergjin . Duhet njohje multidisiplinore për ta kuptuar. Akili vetëquhej Akil Pellazgu. Homeri na flet për ta . Prezencën e tyre e hasim në shkrimet hitite. Pellazget fillimisht kanë shkruar me alfabetin sumer. Ka shume dokumeta të gjetur në zonat e Turqisë, ne gjuhën Pelagone, qe janë konsideruar si të padeshifrueshëm . Janë bashkëkohësit e hititëve dhe flisnin gati të njëjtën gjuhë me ta. Ata jetoni ne zonat e bregut të detit të zi, të Turqisë së sotme dhe ne Zonën më jugore



Figure 10. Graphical representation of clade formation (cumulative sum of new subclades) of the principal paleo-Balkan haplogroups of modern Albanians, using TMRCA estimates from Y-full. Plotted using data from Table S32.

të ballkanit. Behet fjalë për të parat fise që hynë në Evropë, në mijëvjeçarin e tretë para krishtit. Platoni, Aristoteli, dhe Hermogjeni e konfirmojnë prezencën e tyre. Ilirët u krijuan nga përzierja e këtyre fiseve pellazge me ato Dore. Por sipas gjasave ata flisnin te njëjtë gjuhë, por me ngjyrime zonale nëndialektore. Pelagonia ka qenë fakt... Unë kam patur respekt për Gjergjin. Por kur dikush me tha : Albert! Njëfarë Bojaxhiu ka thënë se ; " Këtyre gjuhëtarëve të rinj duhet t'u mbyllet goja, dhe t'u pritet mundësia e daljes ne media. Nuk duhet t'u japim asnjë lloj mbështetje". Ato momente mu kujtua fraza e të madhit Kujtim Çashku: "Shqiptaret edhe gjuhën e tyre shesin për pushtet", dhe thashë me vete "Hebrenjtë shesin gjithçka, por tri gjeta nuk i shesin, gjuhën, Token dhe atdheun e tyre", kurse ne shqiptaret shesim flamurin, besimin, gjuhën dhe atdheun për pak para, të cilën në fund të fundit zhvleftësohen nga inflacioni ose zhduken ne bankat perëndimore. Shikoni, unë në Shqipëri nuk kam asgjë, as prona, as apartamente, as vila, asgjë prej gjeje. E megjithatë punoj për të mirën e gjuhës shqipe, të Shqipërisë, Kosovës e kombit. Monstrave politike Shqipëria u ka dhënë gjithçka; pasuri, prona, pushtet... dhe punojnë kundër Shqipërisë. Madje ka qarkulluar edhe një peticion të iniciuar nga disa pseudo-akademikë të teorisë "Kreole"qe marrin rroga të majme nga shqiptarët, për të ndaluar me ligj botimin e veprave të disa autorëve për gjuhën shqipe. Profesor Shezai Rokaj më tha në një bisedë që pata me të , se kishte refuzuar ta firmoste duke thënë: "Nuk duhet të lejojmë instalimin e ligjeve fashiste, mendimi është i lire në demokraci"..

M.B: Por sulmet më të ashpra të janë adresuar nga Revista Kibernetike " Fjale Cimbuese", e Ardian Vehbiut?

-Po, Vehbiu sulmin e ka filluar që në vitin 2006, në kohën kur unë punoja në Qendrën Evropiane të Shtypit. Asokohe, ai kishte hedhur disa ide sipas te cilës shqipja ishte një surrogat turko-sllavo -greko latino - rumun.... Unë isha ndër të paktët specialistë i specializuar për Etimologjinë dhe Semantiken Strukturale dhe Prehistorinë e gjuhëve, regjistruar ne Forum. I shkruajta me mirësjellje që të hiqte dorë nga denigrimi i gjuhës shqipe... Ai vazhdoi më tej.... tek e fundit ai ishte pjellë e të atit, Ylvi Vehbiu i cili pat përgatitur raportin për shtrimin në spitalin psikiatrik të Petro Zhejit. Kjo ndodhi në kohën kur Petro Zhejit po përflitej në Komitetin Qendror të PPSH-se, do t'i jepej drejtimi i Akademisë se Shkencave. Kasta filosllave e Akademisë se Shkencave me sa duket ja kërkoi në fshehtësi këtij psikiatri, të përgatiste një dokument mjekësor ku thuhej se Petro Zheji ishte; "i sëmurë mendor" ... Kështuqë për të mund të thuhet shprehja : "Bëm baba të-të ngjaj."... Unë mendoj dhe e them me humor se revista e filoserbe "Fjale Cimbuese" e Ardian Vehbiut do të më akuzojë mua se kam manipuluar studiuesit e Oksfordit, për ta nxjerrë gjenin shqiptar EV-13, si më të vjetrit në kontinent, - 48 mije vjeçare. Në fakt unë e pata thënë që në vitin 2020, në botimet e mia në frëngjisht , pa ditur se Oxfordi "do të më kopjonte"... Edhe vjetërsinë 9 mijë vjeçare të shkrimeve te Detit te Vdekur, unë i përcaktova si shkrime në Kulturën Cadmium të Mesdheut (Deshifrohen me shqipen primitive)....Në shkrimin Maobite, 9 mijë vjeçare flitet për mbretin Balak, që përshkruhet

Në foto: Albert V. Nikolla

në Testamentin e Vjetër të Biblës. Edhe po të dua unë të gënjej, nuk me lë Bibla dhe gjeni EV-13....

M.B: Keni hedhur disa teza shumë të avancuara për çështje gjuhësore. Për shembull keni thënë se fjala "Vatikan" vjen nga gjuha iliro-etruske?

-Normale. Kolonat e krishterimit në Evrope i kanë ngritur Ilirët. Shën Pali, duke qenë Filistin, u prit me dashuri tek vëllezërit Ilirë, pasi flisnin të njëjtën gjuhë. Ka shumë revista spanjolle, italiane e franceze që e kanë thënë para meje se "Vatikani" u ndërtua mbi tempullin e perëndisë Etruske "Vatika", dhe u quajt "Vatika an"(Ana e Vatikës - Vatikan). Vetë origjina e fjalës "Vatika" vjen nga fjala "Vatër" e shqipes, në të folmet e Mirditës "Vand" (vend-> toke ku jeton).... fjala vend vjen nga folja e gegnishtes */Va/ (vë) - (vendos kufij, përcaktoj tokën time).... nga ku kemi dhe fjalën "vatan" (Van tan) (vendi ton -> siç thonë korçaret).... Fjala "Vatan", haset në gjuhen Kopte, (Egjiptiançen e vjetër) dhe është marrë si huazim nga Arabët, hebrenjtë dhe popujt turkofonë.... Gjendet edhe ne gjuhën Rumune, në substratin e përbashkët primitiv mes dy gjuhëve. Kur të shikoni skulpturën e */ Vatikes/, do të kuptoni pse Aleksandri i madh dhe Gjergj Kastrioti (Skenderbeu) mbanin në kokë përkrenaren e dhisë Amaltea që ushqeu Zeusin...

-M.B: Ju gjithashtu keni thënë se frëngjishtja ka më shumë fjale me shqipen sesa me latinishten. Këto janë teza te guximshme.

-Duke qenë frankofon, unë ndjek me interes aktualitetin kulturor te botës frankofone. Dhe normal që ndjehem keq nga injoranca e disa gjuhëtarëve francezëve që janë gati të pranojnë origjinën kineze te gjuhës se tyre, sesa origjinën shqiptare. Po frëngjishtja ka me shume fjalë nga gegnishtja sesa nga Latinishtja. Për shembull togfjalëshi " kön fort" është i shqipes





gege, kurse fjala "confort", "confortable", cilësohen me origjine latine. Togfjalëshi "kön firm, është i shqipes gege, kurse "confirme" është me prejardhje latine. Togfjalëshi "e xa gjer" është i shqipes gege, kurse fjala "exagere" quhet si e marre nga latinishtja. Nuk kemi të bëjmë me qindra fjalë por me dhjetëra mijëra fjalë të këtij modeli fjalëformues. Shumë filologë franceze, fjalët e frëngjishtes të marra nga shqipja i quajnë arabe: Po jap disa shembu, fjala "magasin", e cila vjen nga togfjalëshi i shqipes gege "ma ka zin" -> "mban furnizime"- "atrikuj te shitshëm", konsiderohet si arabe. Pastaj kemi falën "galère", e cila vjen nga togfjalëshi i shqipes që haset dhe ne gjuhen mikenase "ka le ri" në konceptin kuptimor * "kan lindur te reja" ose "produkte te reja", e cila konsiderohet si arabe. Foljen "taks" dhe emrin "tarif/, që hasen ne shqipen gege dhe në gjuhën sumere në formën " T'a ri-f ", "ajo që të rri", "që të takon ta paguash", e konsiderojnë si huazim arab ne frëngjisht. Mund të shtojmë këtyre fjalën "avani" që vjen nga togfjalëshi i shqipes gege " a va ni" (a shkoj të marr vesh) . Ose ta zëmë fjalën "jupe" e cila lidhet me "gjup" të shqipes e prejardhur nga folja primitive "gju" (gjuan) e njeriut primitiv, sepse lëkura e kafshës së gjuajtur është quajtur "gjup" (xhup). Në këtë grup hyjnë fjalët "baraka", që vjen nga togfjalëshi i shqipes gege "ba rak a" (vend për fjetje është), numri "zero" , nga folja shqipe "zer" (fillesë) e mbi të gjitha fjala "divan" që vjen nga folja "di" (i zgjuar), që ka dhënë fjalë të tilla si diva, (krijese e zgjuar) divan, vend ku rrinë krijesat e zgjuara, etj...Nuk kanë lidhje me arabishten, janë të shqipes. Pra, ne si gjuhëtarë shqiptarë duhet të mbrojmë atë pasuri leksikore që i takon shqipes së vjetër.

M.B: Deklarata juaj se Greqishtja e vjetër është versioni i standardizuar i gegnishtes me urdhër të Pisistratit ne shekullin e VI para krishtit, ndërsa greqishtja e re një përzierje arvanito-armeno- adamike ka bërë shumë bujë. Ku e mbështesni?

-Shikoni. Për krijimin e Greqishtes se Re, ka pasur tre reforma gjuhësore dhe shtatë ndërhyrje për ta stabilizuar gramatikisht, dhe parë është një gjuhë me fjalë kilometrike të gjata ndryshe nga Shqipja, Gjermanishtja dhe Anglishtja, si shembull të gramatikave të stabilizuara në mënyrë natyrore... nëse greqishtja e re do te ishte një gjuhë e kuruar me sistem natyror si shqipja, për çfarë duheshin shtatë ndërhyrje? Nga ana tjetër ndaj studiuesve shqiptarë ka pasur genocid të vazhdueshëm ... kush e ka financuar këtë fushatë gjenocidesh kulturore? Eshtë e qartë si drita e diellit! Nëse një studiues grek shkruan një vepër gjuhësore që ngre lart Greqishten e re Koinea (Ja thonë vetë origjinën nga Konia e Turqisë) , ai është i ditur, erudit, patriot i gjithë-pranuar nga greket dhe gjithë shkenca ndërkombëtare, automatikisht pa u thelluar se çfarë ka brenda. Kur një studiues shqiptar publikon një vepër me mbi 5 mijë shembuj të bazuar mbi teorinë e rreth 200 gjuhëtarëve më të mëdhenj të pesë shekujve, ai është "i marrë në sytë e shqiptarëve", i padëshiruar nga akademitë dhe universitetet ndërkombëtare, madje edhe nga Akademia e Shkencave të shtetit amë, dhe i luftuar nga televizionet e kontrolluara nga shteti. Në disa televizione është dhënë urdhër që unë të mos ftohem asnjëherë në emisionet për gjuhen shqipe. Meqë nuk ja dalin dot shkencërisht, shpallin censurë... mos ju duket kjo gjë normale. Dua t'ju them diçka: një profesor i universitetit të Arizonës ishte i dashuruar me muzikën greke; ai shkoi në dhe bleu disa disqe me muzikë të vjetër dhe i dëgjonte rregullisht... në një darkë fton një koleg të ri profesor pa e ditur se kush ishte nacionaliteti i tij dhe vendosi t'i tregonte këngën e tij të preferuar. Por ai mbeti i shtangur kur i ftuari i tha "Kjo kënge eshtë shqiptare e zonës së Përmetit "Ç'ja thoshte bilbili".. Janë me mijëra këngë arvanite, dhe të zonës së jugut të Shqipërisë që shiten si thesare te muzës greke në Amerikë... Deri në këtë shkallë ka arritur vjedhja e kulturës shqiptare nga grekët... ata kanë vjedhur gjithçka, me fustanelle, me vallen e Osman Takes, me shkrimet antike te atikes, dhe tani duan edhe te marrin jugun e Shqipërisë. Ekziston një plan i fshehtë Greko-Serbo-Rus, që në bashkimi i Kosovës me Shqipërinë të shoqërohet me asimilimin e Jugut të Shqipërisë nga shteti shovinist Grek . Për këtë janë ngritur "varrezat greke" në jug me eshtrat e shqiptarëve të vrarë nga Andartët Grekë. Politikanët Grekë, në thellësi të tyre janë anti-europianë me të zinj sesa politikanët rusë... Ata do ta bllokojnë gjithmonë hyrjen e Shqipërisë ne BE, ndaj Shqipëria duhet të shohë një alternative të krijimit të një blloku ekonomik dhe politik me Shtetet e Bashkuara te Amerikës dhe Anglinë .

-M.B: Kohët e fundit, Erdogani vizitoi Athinën, dhe sipas të gjitha gjasave arkivat e Stambollit do të jenë të mbyllura per shkencën shqiptare... si e shikoni këto lëvizje..

-Flitet se ka një marrëveshje të fshehtë mes Turqisë dhe Greqisë, sipas te cilës Turqia do ta lejojë Greqinë të marrë jugun e Shqipërisë, dhe Greqia do të bllokojë përjetësisht aderimin e Shqipërisë në BE, në mënyrë që t'i japë kohë Turqisë për turqizimin e Kosovës dhe te Maqedonisë. Pra Greqia po i ngul thikën pas shqipe Unionit Evropian. E dyta nga ana kulturore Turqia ashtu si Greqia është e interesuar ta shuaje kombin shqiptar për arsye se gjithë gjetjet arkeologjike ne Turqi, janë civilizim shqiptar. Ka pasur financime të vazhdueshme për të nxjerrë shumë huazimeve të shqipes nga Turqishtja, por nuk e di sesi një gjuhe e vjetër 8332 vjeçare siç është shqipja , (sipas specifikimeve te shumta shkencore) mund të huazojë nga një gjuhe e krijuar në vitin 1917, nga Sami Frashëri mbështetur mbi dialektin Selçuk të Tartareve. Para krijimi të gjuhës turke, është përdorur Osmanishtja, një derivat i persishtes. A ka ndonjë gjuhëtar serioz që mund t'i gëlltisë manipulimet historike dhe gjuhësore te këtij lloji, që një gjuhë prehistorike si shqipja ka huazuar fjale nga një gjuhë e krijuar artificiale e teknike fillim-shekullit të XX .

-M.B: Ju keni argumente kohorë kokëfortë. Po a mund të na jepni shembuj etimiologjike konkretë?

-Ka shembuj pafund! Ta zëmë; Togfjalëshi "shef da" është i Shqipes, po fjala "Sefda" është shpalluar nga arnautologët si e turqishtes.... le ta themi me të qeshur: Të dashurën, pra vajzën e zemrës , e "shef da", se po nuk e "pe da" nuk ke si ta puthesh në sy të publikut, e aq më pak të bësh dashuri me të. Në shqip fjala "ka kuptim , ka semantike, ka aksion", - siç thotë Saussure. Ka ndonjë gjuhëtar serioz qe i jep hall kësaj mënzyre (nëng nxir-je) etimologjike që na bëjnë arnautologët tanë të dashur! Por si duket e keqja nuk ka fund, për shembull fjala "dollap", konsiderohet si huazim nga turqishtja kurse togfjalëshi "do le hap" , që ka dhenë fjalën "dollap" është e shqipes. Fjala "çekiç" konsiderohet si e turqishtes, kurse togfjalëshi "që kiç" (që mbyll me gozhda) është i shqipes. Fjala "harem" është e turqishtes, ndërsa fjala "hare" nga rrjedh fjala "harem" është e shqipes... fjala "hendek" është huazuar nga turqishtja, kurse togfjalëshi "hen dek" pse "hin dek", nga rrjedh fjala "hendek" është i shqipes... lista e fjalëve është e pafund... shihni pra sesa është vjedhur gjuha shqipe, dhe pse e luftojnë sot aq shumë gjuhën shqipe dhe kombin shqiptar.

-M.B: Cili është gjuhëtari juaj i preferuar?

-Jane disa albanologë shumë të dashur për mua, si Leibnitz, Bopp, Benloeë, Xilander, Thunmann, Von Han , Fallmerayer Mallory, Georgi e Vladimir Georgiev etj., disa gjuhëtarë të gjuhësisë teorike si Saussure, Brèal, Barthes, Jakobson etj., por më i dashuri shpirtërisht është thjesht Holger Pedersen. Ai u dërgua nga qeveria daneze dhe Universiteti i Kopenhagenit për të mësuar Greqishten, por kur e pa që popullsia fliste gjuhën arvanitika, mësoi shqipen dhe u bë albanolog. Asnjëherë nuk bëri kompromis që ta shiste shqipen (siç bëri Bajroni ta zëmë) megjithëse ju afruan favore të mëdha financiare. Ai i qëndroi besnik moralit të tij, se shqipja Arvanite ishte gjuha pasardhëse e Greqishtes Antike.

-M.B: Po burri më i rëndësishëm, për ju sa i takon i historisë shqiptare?

-Nga shqiptarët Gjergj Kastrioti , por siguri-sht në kohërat moderne Kaiser Franz Joseph, burri që meriton një shtatore si ajo e Skënderbeut në Tiranë. Ne si komb duhet të kemi respekt pafund për kombin austriak dhe atë hungarez. Ata sakrifikuan perandorinë që sot ne shqiptarët të kemi Shqipërinë. Eshtë rasti i vetëm në botë kur një perandori shuhet për të mbrojtur një komb dhe një gjuhë. Kajzer Franz Joseph e dinte mirë se me daljen e ruseve ne Adriatik qytetërimi perëndimor merrte fund nën thundrën Ruse. Austro-hungarezët u sakrifikuan që qytetërimi perëndimor të mos merrte fund, dhe sot të kemi një Komunitet Evropian Demokratik.

Bibliografia e autorit

Albert V. Nikolla është një autor shqiptaro-belg , lindur më 16 nëntor 1968 në Mat.

Nga qarqet akademike franceze dhe belge është vlerësuar si shkrimtar, gjuhëtar, kritik letrar dhe filozof. Ka kryer studimet filologjike në Tiranë 1994, dhe studime akademike pranë institutit Rogier Guilbert, Anderleht (2007-2010), në fushën Strukturalizmit dhe Komunikimit Modern, dhe pranë IFOSUP Wavre Belgjike(2010-2013).

Libri i tij "Etimologjia dhe semantika strukturale", botim I Shtëpisë botuese "Nacional" Tiranë 2022, pati një ndikim nderkombetar në fushen e studimeve albanologjike, duke e radhitur nder alabanologet me te shquar qe jane gjalle.

Ka publikuar më 1995, volumin e parë me tregime, titulluar "Dashnori i fundit", Botim i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artisteve Tiranë 1985. Më pas ka botuar "Ngjyrat e çmendurisë", tregime, shtëpia botuese Toena , Tirana 1997;"Lojë tulipanësh", -Tregime, shtëpia botuese "Dita", Tiranë1998; "Thellësia", - Roman, Botimet enciklopedike Tiranë1999; "Weekend i mallkuar në Bruksel"- Roman -Ideart 2004; "Baudelaire, Rimbaud, Migjeni dhe gjeneza e poezisë moderne shqipe", Ese filozofike, Shtëpia botuese Globus -R Tiranë 2007; "Golgota e Kuqe", -Roman, Shtëpia botuese ILAR, Tiranë 2009; "Kanun", Roman, ILAR- Tiranë-2009; "Vallëzim nën yje", - Roman, ILAR, - Tiranë-201; "Vrasës dhe Gjenij", Roman, ILAR -Tiranë 2011; "Humbësi i vetvetes", Roman, ILARTiranë 2012; "Shtegtimi i pelikanëve": Studime letrare, Hipoteza gjuhësore – Mitologji ILAR- Tiranë 2012 ;"Love eksplozion" , Poezi, ILAR-Tiranë 2013; "Brigjet e Shpirtit", Roman, ILAR-Tiranë 2014; "Në emër të dashurisë , Poezi, ILAR-Tirana 2015"

Publikime në gjuhën Frënge dhe Angleze :

"Cronique d'Asassinats Mafieux", Roman –L'esprit d'Aigle éditions - Bruksel 2010;"Les rives de l'âme" (brigjet e shpirtit) , Roman, Edilivre edicion , Paris-2014; "Le Celte préhiqtorique : Guègue, La langue -Mère du monde": -

Etimologji préhi-storike volum 1 dhe 2- L'esprit D'aigele éditions, Bruxelles 2020; "Un VISAGE D'ENFER" (Fytyra e ferrit) – Roman , Amazon Editions- Paris 2020 "La colonie Nibelungen"-Roman Amazon Editions- Paris 2020; "LA PENINSULE DU DIABLE" (Gadishulli i djallit) The dictatorship trilogy , Amazon , Paris 2021; "SAD STAR IN

LOVE" : poezi (English Edition) Amazon, London 2021, etj.

Ka botuar mbi 500 artikuj me kritika letrare; mini-ese dhe studime gjuhësore në gazetat dhe revistat kulturore e letrare si Nacional, AKS, Drita, Republika, Rilindja, Merh Licht, Spekter etj.

POEZI SHQIP LAURA GARAVAGLIA

Shqiperoi Anila Dahriu

Në këto vargje të reja të Laura Garavaglia përbëjnë një rrjellë të vërtetë organike, efektive edhe një projekt, në kontekstin e referencave dhe simetrive të saj të brendshme, Laura Garavaglia lëviz duke u lëkundur mes dy poleve thelbësore: nga njëra anë dëshirë e gjallë. të njohurive autentike, jo të parëndësishme, të pa krijuara në module para-ekzistuese; nga ana tjetër, dridhërima të emocionit ose të ankthit, e të ankthit herë pas here, ose e gëzimit po aq herë pas here, e të qenurit aty. Për të thënë, me pak fjalë, se në ndershmërinë e përvojës reale atë personale, poeti mund të kombinojë inteligjencën e botës dhe shtysën lirike (ose analizën e thellë).

Maurizio Cucchi

Kladestinë

Vështroj nëpër çatitë e qelqta
Kuadrin e shirarëve
Këmbën e fryrë e të gjakosur
Dhe, jam pak Rimbaud.
Në Tijuana të dëshpëruarit
madje dhe minjtë kalojnë
Ndërmjet telave tërë gjëmba
Dhe, unë prek sakaq hundën, teksa
Më përshëndet "Hej e dashur"
Dhe, vrapoj kushedi për të dhënë kurajon.
Kam një shpellë në tru
Madje, krateret në mushkëri
Por ,do ja dal mbanë?!

YUSUFI

Yusufi ulet pranë nënës, trupi i saj shtrirë nëpër fushë
Drita e diellit pret vështrimin e djaloshit.
Në mëngjes lindin bubullimat dhe shtrëngatat:
Ndoshta kohë e keqe pa shi,
Teksa shkrin tokën në përrenj të errët
Lufta fshin kufijtë e sensit.
Ndoshta ishte një lojë dhe nëna po fle!
Me krahët e kryqëzuara orë të tëra mbi bark
Nuk zgjohet
Dhe, nëpër vorbullën e zezë kanë humbur gjërat e shtëpisë.
Yusufi nuk di që dhe babai e vëllai i tij
Larg të vrarë janë,
Përtej shkretëtirave të gjakosuar
nga agimit deri në perëndim.
Nëna e tij rrëfente historirat për paqe.
Yusufi tashmë pret zërin e vet.

NËNAT

Të flas nga larg me zërin e gruas dhe të nënës
Sepse je grua dhe nënë edhe ti ,
dhe e di mirë ç'do të thotë!
Të jetosh pa ëndërruar
dhe të udhëtosh në ërrësirën e dhimbjes.
Ti e njeh mirë gjithashtu,
Shëmbjen që kë përbrenda ,po ashtu dhe unë.
Të humbësh një fëmijë një ditë vere
Ndërsa përreth shushërinë jeta dhe drita fryn orët
Duke pasur vdekjen aq afër dhe mos ta prekësh.
Por,ti nuk e dije, as unë nuk e dija!
Gjatë asaj rruge të bardhë
Me sa dhunë dhe urrejtje shekullore
Dy jetë u shkatëruan.
Të vdesësh njëzet vjeç nën çatinë e diellit,
është tmerr,
Yt bir kishte shkuar larg dhe kur u kthye
kuptoje ndryshimin
Por, ti e dije ,siç e dija dhe unë
Që të vrasësh në emër të Allahut
Është si të gërryesh qiellin
Dhe, tashmë gjthëçka të shfaqet e tepërt
madje e pabesushme,
Dhomat më të dashura kaher në errësirë.
Pyetjet e ngelura pezull vrapojnë në zemër
Dhe, kujtimi gërryen atë çfarë mbetet tek ne.

MUNGESA

Tashmë je ti që flet
Në kujtesë zërit yt është aq i kthjellët
Madje dhimbja është ekzema që gërryen.
Hija e kohës lë gjurmë në çdo send
Qelqet e zyve të thyera
Veshjet në dollap
Radio, librat, poezitë, pikturat.
Për atë që ke qënë.
Ose për atë që je tashmë
Tjetër kush absolutisht
Që të mohon kush të ka dashur.

POEZIA

Ka raste që fjalët janë sy
Vështrojnë qëllimisht botën.
Gërryejnë deri në fund
Perspektiva të ndryshme.
Kaher fjalët ndalojnë në ajër
Dhe nuk mund të mbërrijnë në qoshet e jetës.
Madje frazat janë pluhur
Mbrenda një rreze drite.

LAURA GARAVAGLIA

Laura Garavaglia ka lindur në Milano në vitin 1956. Jeton dhe punon në Como (ITALI). Bashkëpunon në faqet kulturore të gazetave «Il Gazeta», «Il Corriere di Como», «L'Ordine». Profesore letërsie në shkollat e mesme. Prej kohësh ka shkruar poezi. Ka themeluar dhe drejton shoqatën kulturore "La Casa della Poezia e Komos" (www.lacasadellapoesiadicomo.it) dhe është organizatore dhe kuratore e Festivalit Ndërkombëtar "Europa in versi" që mbahet çdo vit në Como.Gjithashtu bashkëpunon me Festivali i Letërsisë "Parolario", me ekspozitë artistike bashkëkohore "Miniartextil" (Como) dhe me Festivalin "Poestate" (Lugano). Është anëtare i jurisë së çmimeve letrare "Antonio Fogazzaro" dhe "Città di Como". Është anëtare e PEN Klubi italian dhe zviceran dhe Licéo Poetico i Benidorm (Spanjë). Poezitë e saja janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Gjithashtu janë përfshirë në shumë antologji e revista letrare të huaja. Ka marr pjesë në shumë Festivale Ndërkombëtare të Poezisë në mbarë botën. Rumani,Japoni,Korea Sud,Meksikë,Spagna,SHBA, eccc… Shkruan si kritike letrare në blogje dhe bashkëpunon me shumë shtëpi botuese. Ka fituar shumë çmime nazionale dhe internazionale mbarë botës.

Prezenca e gjallë e gjërave
Valë kujtimesh
Gërryejnë rërën e mendjes
Shndërohen pa formë
Në oqeanin e memories.
Jemi vetëm kujtime në horizont
Në prezencën e gjallë të gjithëçkaje.

ATA JANË VËLLEZËRIT E TU DHE MOTRAT E TUA

Përktheu nga gjuha malazeze Qazim Muja

Ti heq shpirt me kokë në jastëk
turp vogëlushi
Im

Ke mundur tekefundit të ngjeshësh armët
e Asimit
E të shkosh në Bejrut
Të vdesësh për Palestinën

(Ali Podrimja: "Të shkosh në Bejrut", korrik 1982)

Të qortoja
Gjersa ti po vdisje
Por s'kisha të drejtë
As që duhej ta kisha menduar

E dija që do
Luftoje për Palestinën
Djali im i vdekur
Ti je rritur
Je bërë luftëtar
Luftëtar i përjetshëm
Për Palestinën e përjetshme
Për të gjitha Palestinat Lumi
Edhe pse i vogël
Vetëm nëntë vjeç
Ti kishe një ndjenjë
Të pagabuar për drejtësinë
Sapo fillove të ecësh
Sapo fillove të flasësh
U pa kjo

Çdo poet është një luftëtar
Dije këtë Lumi
Dhe mbaje mend këtë
Do vijnë te ti
Aq shumë vëllezër të tu
Dhe motrat të tua
Shpirtrat e tyre do vijnë
Disa nga ata
As që i kishin çelur sytë
Dhe vdiqën Lumi
Të pafajshëm dhe të pastër
Gati për në qiell
Priti
Dhe jepu atyre shumë lodra
Nga ato tuat
Edhe librat
Ia dhashë një gruaje
E cila
Rendte
Nëpër kontejnerë
Duke kërkuar lodra
Për të birin
Bëhu i kujdesshëm Lumi
Mbroji ata
Tani ti je i rritur
Edhe në vdekje je rritur
Je bërë
Një djalosh i bukur dhe i guximshëm
Do vijnë
Shumë fëmijë
Do vijnë
Dhe të vdekur
Do luftojnë
Për Palestinën
Të vdekurit më së miri
Luftojnë

Ata janë të patrembur
Mos harro
Në fund të fundit ti këtë
Edhe vetë e ke përjetuar
Çfarë jam duke të folur
Të njoh Lumi im
Je i guximshëm
Je luftëtar
Vogëlushi im

Të vdekurit janë luftëtarë
Të kalitur
Të gjallët asnjëherë
Nuk ia dolën kundër tyre
Pranoji të gjithë ata fëmijë
Dhe jepu atyre
Shumë lodra
Shumë nuk e dinë
Çfarë janë lodrat?
Prit derisa të rriten
Ashtu siç ti je
E kur të rriten
Shpalosni flamujt palestinezë
Shpalosni flamujt e drejtësisë
Deri atëherë
Lëri le të luajnë

E përsëris
Ata janë vëllezërit e tu
Dhe motrat e tua
Nuk isha i drejtë
Kur të
Qortova
E dija diku
Se edhe i vdekur
Do luftoje për Palestinën
Ata janë të vegjël tani
Por do rriten si ti
Do luftojnë
Si ti

Unë të njoh
Babai i yt jam dhe ti je
Biri im
Askush më mirë birin
Nuk e njeh
Sesa babai

Me siguri ke takuar atje
Mahmud Dervish
Poetin palestinez
I madh
Ashtu siç është i madh
Populli i tij
Jam i sigurt se ai të njohu
Dhe të përqafoi
Ashtu siç unë do të
Përqafoja
Ndiqe biri im
Ai
Lufton me poezi

Dhe secili që
Kështu e sheh luftën
Është fitimtar Lumi

Mos e harro këtë

Kush e fitoi këngën

Dhe mos harro
Lumi im
Të gjithë ata fëmijë
Që nxitojnë drejt teje
Janë vëllezërit e tu
Dhe motrat e tua

Tani ti je diku
Në Gaza
Edhe unë jam diku në Gaza

Së bashku jemi Lumi

Mirash Martinoviq

Dhe veç
Të të them
Fjala do sjellë drejtësi
Vendimi i saj
Vjen në fund
Dhe do gjykojë
Kush
Kishte të drejtë
Të drejtë gjithmonë kanë
Fëmijët

Djaloshi im

Më 11 nëntor 2023

Nga libri në përgatitje VDEKJA NË GAZA

Përktheu nga gjuha malazeze Qazim Muja

KËNGËZA E DËSHIRËS SË PARË

Nga Federico Garcìa Lorca

Përktheu: Angela Kosta

Ka shpirtra tek të cilat dëshiron të shikosh si në një dritare me diell.

SA TË RËNDA JANË DITËT

Sa të rënda janë ditët,
në asnjë zjarri nuk mund të ngrohem,
nuk më qesh tashmë asnjë diell,
gjithçka është bosh,
gjithçka është e ftohtë dhe e pamëshirshme,
e edhe të dashura yjet e qarta
më shikojnë pa ngushëllim,
që kur mësova në zemrën time,
se edhe dashuria mund të vdesë.

KËNGËZA E DËSHIRËS SË PARË

Në mëngjesin e gjelbër
doja të isha
Zemër.

Doja të isha zemër.
Zemër.

Dhe në mbrëmjen e thellë
doja të isha bilbil.
Bilbil.

Shpirt,
bëhu ngjyrë portokalli!
Shpirt,
bëhu ngjyrë dashurie.

Në mëngjes ende gjallë
unë doja të isha unë.

Zemër.

Dhe në mbrëmje tashmë të rënë
doja të isha zëri im.

Bilbil.

Shpirt,
bëhu ngjyrë portokalli!
Shpirt,
bëhu ngjyrë dashurie!

Studimi i sonetit në poezinë shqipe, që nga shfaqja e parë i tij në vitin në 1777

SONETI NË POEZINË SHQIPE

"Hulumtimi i këtyre aspekteve të mundësive shprehëse të gjuhës, të përvojave poetike dhe të vlerave estetike që funksionalizohen në vargun poetik në formën e sonetit, mundëson që të krijohet një pamje më se e qartë e zhvillimeve gjuhësore, social-kulturore dhe vlerave estetike në poezinë shqipe."

Prof. Dr. Mr. Milazim KRASNIQI



HYRJE

Studimi i sonetit në poezinë shqipe, që nga shfaqja e parë i tij në vitin në 1777, kur poeti arbëresh Nikollë Keta me sonetin "Për vetëhenë", e inauguroi këtë formë poetike e deri në ditët tona, mundëson studimin e një segmenti esencial të poezisë shqipe. Soneti si formë poetike, me një numër të saktësuar të vargjeve, me organizim të rreptë të tyre në nga dy katrena dhe në nga dy terceta, me harmoni të theksuar të elementëve metrikë, veçmas të rimës, e cila është e organizuar në skema, në rastet e katrenave, dhe në variacione të shumta, në rastet e tercetave, dhe me njëmbëdhjetërrokëshin si metër strandard, shpalos në mënyrë shumë autentike mundësitë shprehëse të gjuhës, aspiratat e poetit dhe nivelin estetik të vargut. Për të krijuar këtë formë poetike në një gjuhë, është e domosdoshme që ajo të ketë një zhvillim të leksikut dhe të strukturës së saj, që do të mundësonin shqiptimin e ndjenjave dhe ideve, duke ruajtur strukturën e konservuar të vetë formës poetike dhe të funksionimit të metrit e të rimes, si elementë kyç të kësaj forme. Në rastin e sonetit, krahas shpalosjes së aspiratave dhe e mesazheve poetike, në planin e kumtimit ose informimit me synim estetik, poeti shpreh edhe një qëndrim ose pozicion ndaj vetë poezisë, në këtë rast ndaj një forme të saj. E kjo nuk mund të bëhet pa një njohje elementare të traditës poetike në këtë formë dhe pa zotërimin e një përvoje elementare të shkrimit. Mbase për këtë arsye, rrallë ndodh që poetë fillestarë të sprovojnë veten në këtë formë poetike, veçse këtë e realizojnë në një fazë më të konsoliduar të përvojës së tyre krijuese. E kjo do të thotë që studimi i sonetit jep një pasqyrë më esenciale edhe të krijimtarisë poetike të tyre. E treta, në formën e sonetit janë të shkruara disa nga ekzemplarët më të mirë poetikë të një numri të poetëve, çka e bën edhe më motivues studimin e këtyre arritjeve kulmore 3 estetike në krijimtarinë e tyre. Hulumtimi i këtyre aspekteve të mundësive shprehëse të gjuhës, të përvojave poetike dhe të vlerave estetike që funksionalizohen në vargun poetik në formën e sonetit, mundëson që të krijohet një pamje më se e qartë e zhvillimeve gjuhësore, social-kulturore dhe vlerave estetike në poezinë shqipe. Dihet se fatet historike të kombit shqiptar dhe konteksti social-kulturor në të cilin u krijua poezia shqipe, bënë që ajo të ketë një zhvillim jotipik, në krahasim me poezinë në shumicën e letërsive kombëtare europiane. Vonesat e mëdha të formacioneve stilistike dhe të formave poetike, janë tragjikisht evidente. Libri i parë i shkruar në gjuhën e shqipe dhe që është në dispozicion të traditës kulturore shqipe, është i mesit të shekullit XVI,1 saktësisht i vitit 1555. Mirëpo, as "Meshari" i Gjon Buzukut dhe as veprat e autorëve të tjerë të vjetër, Pjetër Budit, të Frang Bardhit e të Pjetër Bogdanit, nuk janë vepra të mirëfillta letrare, të cilat do të shërbenin si pikënisje e letërsisë shqipe. Disa prej tyre janë përkthime, të tjerat tekste liturgjike dhe filozofike. Megjithatë, tradita letrare fillon me dy prej këtyre autorëve, me Pjetër Budin dhe me Pjetër Bogdanin, të cilët kanë lënë në trashëgimi të shqipes disa poezi origjinale. Mirëpo, ai fond i pakët dhe ajo traditë që praktikisht ndërpritet në shekullin XVIII, nuk arrin të konsolidojë një letërsi të qëndrueshme, e aq më pak të krijojë një spektër të llojeve dhe të formave e poetike, që ishin kultivuar në letërsitë e ndryshme europiane nëpër shekuj. Letërsia shqipe përjetoi edhe në shekujt që pasuan pas zbaticës që pësoi tradita letrare e filluar ne Buzukun, vonesat e shfaqjeve të formacioneve e të dukurive letrare dhe mungesat e mëdha të gjinive e të llojeve letrare. Fryma e poezisë provansale dhe larmia e saj, rryma e madhe e humanizmit dhe e renesanës dhe formacioni stilistik i klasicizmit, do të kalojnë pa prekur brigjet e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Ndërlidhja e letërsisë sonë në rrymimet letrare europiane do të ndodh vetëm në periudhën e romantizmit. Është krejt e logjikshme që në një kontekst të tillë historik, social dhe kulturor, edhe soneti si formë poetike, u shfaq me pesë shekuj vonesë. Është vërtet e dhimbshme kjo gjë, kur dihet se gjeografikisht viset shqiptare qenë në afërsi direkte me truallin e lindjes së sonetit, me Sicilinë, ku kjo formë poetike lindi në shekullin XIII.

Meshari i Gjon Buzukut, Rilindja, Prishtinë, 1987. 4 Prandaj, është e kuptueshme që edhe kultivimi i gjuhës shqipe dhe i poezisë shqipe në përmasat ku formësohen si potenciale të mëdha të shprehjes së ideve, mendimeve dhe ndiesive njerëzore, ka ecur më ngadalë dhe më me vështirësi. Ky evoluim i vështirë gjuhësor dhe poetik mund të hetohet edhe në zhvillimin e sonetit në poezinë shqipe. Ai mund të na ofrojë një tabelë të tendencave dhe të dukurive gjuhësore e poetike, që e kanë shoqëruar dhe i kanë krijuar identitetin e sotëm poezisë shqipe. Ndërsa, kjo tabelë ose kjo pamje do të na ndihmonte që të kuptojmë më mirë edhe natyrën e fateve historike dhe kontekstet social-kulturore, të cilat kanë lënë dëshmitë e tyre të pashlyeshme edhe në poezinë shqipe, që nga alfabetet e përdorura, nga leksiku, nga figuracioni e deri te idetë dhe mesazhet poetike, që kanë qenë shprehje e identitetit kombëtar e fetar dhe e idealeve njerëzore të poetëve shqiptarë nëpër kohë. Po të krahasohen këto elemente të vargut poetik në sonetet e Pjetër Zarishit dhe të Arshi Pipës, fjala vjen, hetohet ai proces marramendës i evoluimit gjuhësor, si dhe i ndryshimeve rrënjësore të idealeve njerëzore të këtyre poetëve shqiptarë. Rezultatet shkencore të hulumtimeve të orkestruara mbi tekstet ekzistuese të soneteve në poezinë shqipe, mund të ofrojnë një alternativë serioze të pamjes së poezisë shqipe dhe të vlerave të saj në përgjithësi. Në një letërsi ku me shekuj ka dominuar poezia gojore dhe ku edhe poezia e shkruar u ka ndenjur afër intonimeve dhe ritmeve të saj për një kohë shumë të gjatë, një studim i tillë për sonetin, fiton rëndësi të veçantë njohjeje dhe vlerësimi. Soneti si formë poetike është krejt i ndryshëm nga ajo traditë e poezisë gojore shqipe dhe e poezisë së shkruar që është krijuar mbi modelet e saj. Prandaj, soneti edhe është dëshmi e frymës së re që u shfaq dhe e përshkoi poezinë shqipe, duke e pasuruar me intonacione të reja metrike, ritmike dhe përgjithësisht estetike dhe duke e ndërlidhur me rrjedhat e poezisë europiane. Meqë kjo formë poetike ishte dhe mbeti vazhdimisht e tillë, që me anën e harmonisë kompozicionale, pasurisë gjuhësore, shprehësisë figurative dhe variacioneve eufonike e ritmike, të poetizojë maksimalisht objektin poetik, mund të konstatohet që në krye të herës se pati ndikim emancipues mbi poetët shqiptarë. Sonetistët shqiptarë qenë të ndërgjegjshëm se vargu i shkruar në formën e sonetit, kërkonte intonacione dhe ritme të ndryshme nga metrat, të cilët u rrinin krejt pranë ritmeve të poezisë gojore e që 5 përthithnin edhe leksik e figura nga një ambient social, i cili nuk kërkonte abstragime të mëdha konceptuale dhe figurative. Me sonetin ndodhte ndryshe. Kërkoheshin fjalë më të zgjedhura dhe figura që shprehnin koncepte e ideale më të larta të subjektit poetik, gjë që hetohet që nga soneti "Për vetëhenë" (ose "Farie së nderme në Kuntisë u bi"), i Nikollë Ketës, po më dukshëm te sonetistët pasues, Leonardo de Martino, Ndye Bytyçi e Pjetër Zarishi, për të mbërritur kulmet e realizimit poetik në sonetet e Zef Serembes, të Ndre Mjedjes, të Asdrenit e të Arshi Pipës më vonë. Kjo frymë emancipuese e sonetit përshkon gjithë poezinë shqipe, me rënie e me ngritje, varësisht nga kontekstet sociale dhe politike, në të cilët jetuan dhe shkruan sonetistët shqiptarë. Por, ajo frymë hetohet gjithandej. Rrjedhimisht, studimi i kësaj problematike që tematizon disa aspekte esenciale të poezisë dhe të konteksteve gjuhësore e social-kulturore, është një sprovë për secilin studiues. Puna bëhet më e vështirë, në rastet kur përveç vështirësive metodologjike, studiuesi ballafaqohet edhe me disa vështirësi praktike. Tejkalimi i këtyrë vështirësive nuk është një punë e lehtë në ambientin kulturor e shkencor që mbretëron sot në Prishtinë dhe në botën shqiptare përgjithësisht. Mungesa e antologjive të sonetit, mungesa e botimeve kritike për autorët, mungesa e botimeve elementare të autorëve të vjetër, madje edhe mungesa e një rrjeti efikas bibliotekar, paraqesin një frenim të vullnetit të studiuesve që të hyjnë në orbitën e studimeve të kësaj natyre, ku tekstet paraqesin themelin e studimit. Roli frenues dhe pengues i kësaj gjendjeje, në fillim vetëm mund të përfytyrohet, po kur studiuesi futet më thellë në projekt, e ndien dhe e sheh me dhembje se çfarë vakumesh ka në fushën e botimit, të sistemimit dhe të vlerësimit të vlerave letrare shqipe. Nga ana tjetër, në realizimin e projekteve studimore, zgjidhja e problemeve metodologjike me të cilat do të realizohet studimi, vetvetiu është një punë jashtëzakonisht e vështirë. Përzgjedhja ndërmjet shumë metodave të studimit, si dhe përzgjedhja e literaturës themelore, është një sfidë intelektuale, dhe në esencë paraqet edhe kushtin elementar për suksesin e një pune studimore. Në rastin tonë këtë e kemi zgjedhur duke aplikuar qasjen strukturale mbi të gjitha nivelet e tekstit letrar, që nga niveli eufonik, metrik, ritmik, te niveli i ideve, tematikës, semantikës poetike dhe funksionit estetik. Pra, vetë teksti, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tij semantik e estetik, janë 6 hulumtuar dhe studiuar në mënyrë të nuancuar, megjithëse duke pasur gjithnjë para sysh ruajtjen e integritetit artistik të objektit të studiuar dhe koherencës së metodës me të cilën është realizuar studimi. Teksti me materialin e vet gjuhësor dhe me funksionin semantik të konstituuar brenda tij, ka qenë dhe ka mbetur pikënisje për të ndjekur organizimin e brendshëm të elementëve përbërës të poezisë, raportet e tyre opoizicionale dhe harmonike, ndryshueshmërinë e këtyre raporteve nga rasti në rast dhe rrezatimet e kuptimeve që burojnë nga vepra konkrete poetike. Edhe relacionet më të largëta brenda opusit të një poeti ose të lidhjeve të tij me të tjerët, për bazë themelore e kanë analizën e tekstit dhe të funksionit estetik të tij. Kjo qasje strukturale2 , jep mundësi të identifikimit dhe të vlerësimit të të gjitha niveleve të tekstit dhe të funksionit estetik të tij.

a) "Ambicia e strukturalizmit nuk kufizohet në llogaritjen e këmbëve ose në zbulimin e fonemave: ajo duhet të merret edhe me fenomenet semantike, të cilat siç e dimë nga Malarmeu, përbëjnë esencialen e gjuhës poetike, dhe më përgjithësisht, me problemet e semiologjisë letrare". (Zherar Zhenet, Figura, Rilindja, Prishtinë, 1985, fq. 14). b) "A priori, vërtet strukturalizmi si metodë është themeluar për t'i studiuar strukturat ku t'i ndeshë, por

para së gjithash, strukturat nuk janë shumë afër, objekte që takohen, ato janë sisteme të relacioneve latente, më parë të përfytyruara sesa të vërejtura që analiza i konstrukton në atë masë saqë i zhvesh dhe herë herë madje rrezikon t'i shpikë duke menduar se i ka zbuluar, nga ana tjetër strukturalizmi nuk është vetëm një metodë, ai është gjithashtu, siç e quan Kasireri, "një tendencë e përgjithshme mendimi…" (Po aty, fq. 15- 16) c) "Struktura nuk është vetëm një vepër e veçantë, e vetmuar. (…) Çdo vepër artistike- edhe ajo "më burimorja"- është, pra, e inkuadruar në rrjedhën e ndërlidhur që përshkon kohën. Nuk ka vepër artistike, e cila do të ishte e shkëputur nga kjo rrjedhë, edhe në rast se na duket që në raport me atë rrjedhë disa prej tyre duken krejt të papritura". (Jan Mukarzhovski, Mbi strukturalizmin, te "Struktura, znak, funkcija, vrednost, Nolit, Beograd, 1987 (përkthim imi) d) Në çka manifestohet dëshmia poetike?- Në atë që fjala të përjetohet si fjalë, e kurrsesi si përfaqësuese spontane e objektit të emërtuar, ose si eksplozion emocional. Në atë që fjala dhe kompozicioni i saj, kuptimi i saj, forma e jashtme dhe e brendshme, nuk janë si dëshmim indiferent i realitetit, por që fitojnë peshën dhe vlerën e vet". (Roman Jakobson, Çka është poezia, Prosveta, Beograd, 1978, fq. 118) f) Poetika strukturale mirret me cilësitë abstrakte, që e përbëjnë veçantinë e faktit letrar, literaritetin. Qëllimi i këtij hulumtimi nuk është të artikulojë një parafrazë, një rezyme të arsyetuar të veprës konkrete, por të afrojë një teori të strukturës dhe të funksionimit të diskursit letrar, një teori e cila do ta paraqiste tabelën e mundësive letrare, rastet e veçanta të së cilës janë veprat ekzistuese letrare." (Cvetan Todorov, Poetika strukturale, Nolit, Beograd, 1978, fq. 52). 7 Zgjedhja e sonetit si objekt studimi ka një peshë të konsiderueshme shkencore, sepse soneti është "forma metrike më e njohur, më e rëndësishme dhe më e përhapur".3 Soneti si formë poetike, që nga paraqitja në skenën letrare në shekullin XIII e deri në ditët tona, përshkoi letërsitë kombëtare europiane në përmasa të habitshme dhe pothuajse të pashpjegueshme. Mjafton të përkujtohet se sonetin e krijuan kolosët e poezisë: Dante Aligieri, Françesko Petrarka, Mikelangjelo, Uiliam Shekspiri, Lope De Vega, Miltoni, Volfgang Gëte, Hajnrih Hajne, Teofil Gotje, Sharl Bodleri, Pol Valeri, Artur Rembo, Raine Maria Rilke, po të kufizohemi në përmendjen e vetëm disa emrave të mëdhenj. Preokupimi i poetëve më të mëdhenj të botës me sonetin si formë poetike, dhe realizimi prej tyre i vlerave kulminante estetike në këtë formë, është një tregues se soneti është një formë poetike e jashtëzakonshme, me harmoni strukturore, e cila mundëson artikulimin gjuhësor dhe estetik në një mënyrë gati të mahnitshme. Zgjedhja e sonetit në poezinë shqipe si objekt studimi, përveç rëndësisë konkrete për vetë poezinë shqipe dhe zhvillimet e brendshme të saj, ka edhe një fundament të fuqishëm teorik, thënë në kuptim të gjerë. Një studim i tillë e bën sonetin më të verifikueshëm dhe më të pakontestueshëm si formë poetike gjithëpërfshirëse në letërsitë kombëtare europiane, kësaj radhe duke e bërë këtë verifikim edhe me shembullin e një letërsie kombëtare, si letërsia shqipe, që është zhvillluar në procese të vështira historike dhe kulturore. Forma fillestare e sonetit ishte në njëmbëdhjetërrokësh dhe me strukturën e rimave: abab/abab dhe të tercetave: cde/cde. Mirëpo, kolosët e poezisë, Dante Aligieri dhe Françesko Petrarka, u dhanë një mundësi të re kombinimeve të rimave të katrenave, duke e krijuar shemën: abba/abba, përderisa kombinimet e rimave të tercetave mbetën gjithnë të larmishme. Një model specifik, sonetin elizabetin, ose sonetin shekspirian e krijoi Uilliam Shekspiri. Shema e rimave të këtij soneti është" abba/cddc/efef për katrena dhe gg për distikun përmbyllës. Në disa raste më të rralla, soneti elizabetin ose shekspirian, ka shemën e rimave:

Në foto: Uran Kostreci

abba/cddc/effe dhe disktiku: gg.3

(Recnik knjizevnih termina, Nolit, Beograd, 1986, fq.751. 8)

Njëri nga elementët e funksionalitetit të sonetit si formë poetike, është e lidhur me përbërjen e tij asimetrike, pra nga dy lloje strofash të ndryshme, nga katrena dhe nga terceta, dhe nga izometrizmi metrik, në anën tjetër. Zakonisht në dy katrena krijohet një stabilitet ritmik, falë numrit të njëjtë të vargjeve dhe ndërlidhjes së rimave. Por, ky stabilitet ritmik dhe kompozicional vihet në sprovë serioze në terceta, të cilat kanë numër më të vogël të vargjeve dhe kombinime krejt të tjera të rimave. Në rastet e realizimeve të larta poetike të sonetit, ky ndryshim ritmik, është i ndërlidhur edhe me ndryshime të disponimit dhe të intonacionit poetik, sepse pas ekspozimit të motivit në katrena, në terceta shpaloset ideja dhe epilogu i ligjërimit poetik. Këto ndryshime strukturore dhe motivore, i japin sonetit dinamikë të brendshme dhe aftësi që të funksionojë si një formë poetike, përmes të cilës poeti mund të shprehë vizionet e veta poetike, në nuancat më delikate gjuhësore dhe figurative. Njëmbëdhjetërrokëshi si vargu tipik në të cilin është shkruar soneti, ka provuar aftësinë që të bartë mbi vete larmi të mëdha të ritmeve, të intonacionit dhe të transfigurimeve poetike. Është metër që hepohet me elasticitet ndërmjet diskursit poetik solemn dhe diskursit elegjik, ndërmjet intonimit lirik dhe narracionit poetik, sepse mundësia e shpërndarjes së theksave dhe e aplikimit të lirive poetike, në këtë metër është më e madhe se në dhjetërrokësh dhe në dymbëdhjetërrokësh, ritmet e të cilave shumë shpesh anojnë drejt uniformitetit, gjë që provohet edhe nga ritmet e këngëve popullore. Soneti si formë poetike ka fituar një dimesion të ri edhe me krijimin e kurorës sonetike, si formë më e komplikuar e vargëzimit. Kurora sonetike, e përbërë nga pesëmbëdhjetë sonete, të ndërlidhura ndërmjet tyre që nga objekti poetik, e deri te një element i ri, ai i ndërlidhjes së njësive sonetike me vargun nistor, me akrostikun dhe veçanërisht me magjistralin, u ka dhënë sonetistëve një rast të veçantë që të sprovojnë talentet e veta në një aventurë gjuhësore dhe poetike sui generis. Kurora sonetike, me magjistralin si gjetje poetike estetikisht aktive, ka bërë që kjo formë poetike të zgjerohet në planin kompozicional dhe në planin tematik, duke arritur nga pikëpamja sasiore deri te kufijtë e poemës. Edhe nga kjo anë, kjo formë poetike u ka dhënë sonetistëve hapësirat e 9 nevojshme që ata të shijojnë aventurat krijuese, duke e testuar fantazinë e tyre në luftë me enigmat e gjuhës. Pra, soneti vërtet mund të quhet forma poetike më perfekte, sa i përket harmonisë ndërmjet strukturës së vet dhe mundësisë që ajo jep për realizim estetik. Rrjedhimisht, studimi i kësaj forme poetike, është studimi i një segmenti esencial të artit poetik. Ky konstatim vlen edhe për studimin e sonetit në poezinë shqipe. Nga ana tjetër, soneti si formë poetike, me prejardhjen e vet të mbështjellë me vello misteri në një pjesë të madhe, poashtu ka një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore, sepse prekë në vetë esencën e interkomunikimeve të kulturave dhe të qytetërimeve në truallin europian. Nga rezultatet e studimeve të deritashme, është evidente se prejardhja e kësaj forme poetike është rezultat i simbiozës së gjatë kulturore arabo-europiane, përkatësisht nga lulëzimi i kulturës arabo-spanjolle në Andaluzi dhe nga tradita poetike arabe në Sicili. Lulëzimi i poezisë lirike me strukturë strofike, e emërtuar si muvashah dhe i zexhelit në Andaluzi, në një përzierje të çuditshme gjuhësore arabe-latine dhe arabe-spanjolle, me një strukturë strikte të rimave dhe me numër të caktuar të strofave, është vetë tharmi i poezisë provansale dhe i formës poetike të sonetit. Ndikimi i drejtpërdrejtë dhe i fuqishëm i literaturës andaluziane mbi poezinë provansale dhe më tutje mbi poezinë europiane, tashmë shkencërisht është i argumentuar. Fjala vjen, Giomi IX, i cili mirret si themeluesi i poezisë provansale, ka qenë në kontakte direkte me botën arabe dhe islame, sepse ka marrë pjesë në kryqëzatën e organizuar nga Papa Urbani II, ka jetuar me vite në Jerusalem dhe në vende të tjera të botës arabe. Poashtu, Giomi IX në oborrin e vet ka mbajtur një numër të madh të poetëve e dijetarëve arabë. 4 "Prandaj, ka qenë normale për njeriun e kulturuar, ose për femrën nga jugu i Francës, ku u paraqitën poetët e parë trubadurë, që të kënaqet në llojin e ri të poezisë, i cili u shfaq në Andaluzinë Islame. Poashtu, ishte normale që Giomi IX, poet i cili jetoi në luks dhe kishte kulturë të gjerë, të ishte një lidhje ndërmjet muvashahut të Andaluzisë dhe poezisë

(Grupa autora, Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevo, 1987. 10)

lirike europiane dhe të krijonte poezi sipas shembullit të Mukadam ibn Muafa al Karbit, i cili ishte i pari që e krijoi muvashahun, dyqind vite më herët".5 Një argument vendimtar për këtë ndërlidhje kulturore dhe për prejardhjen e poezisë lirike europiane, duke përfshirë tercinën dhe sonetin, është ndikimi që ka pasur mbi Dante Aligierin literatura islame-andaluziane, veçmas vepra " Libri mbi Miraxhin". Orientalisti italian, Levi della Vida, konstaton se "sot definitivisht është argumentuar fakti se "Libri mbi Miraxhin" (Ngritjen e Muhamedit), e cila ishte në dispozicion të botës latine në dy gjuhë europiane, (latinisht dhe frengjisht), nëse jo në tri (duke përfshirë edhe spanjishten), nuk ka mundur as rastësisht të jetë larg vëmendjes së Dantes, sepse kjo duket e pamundshme. Vetëm tash mund të pohojmë se teoria e Asin Palaciosit është jashtë çdo polemike dhe diskutimi. Më nuk dyshojmë në mundësinë që Dante i ka lexuar burimet arabe. Ky është fakt të cilin duhet ta marrim si të vërtetuar".6 Pra, kur një autor si Dante Aligieri, i cili veç kryeveprës së tij, "Komedia Hyjnore", të krijuar me një strukturë të jashtëzakonshme tematike dhe poetike, me tercinën si një strofë specifike, krijoi edhe shumë sonete në vëllimin "Vita nuova", ka qenë nën ndikimin e kësaj literature, është e qartë se prejardhja e këtyre formave poetike është nga ajo simbiozë arabo-andaluziane dhe arabo-siciliane. Nuk mund të jetë rastësi lindja në shekullin XIII e shkollës së parë poetike, shkollës siciliane, në të cilën u kultivua edhe soneti si formë e re poetike, në truallin ku për më shumë se tre shekuj ishte intensive letërsia arabo-andaluziane me poezinë lirike të saj, muvashahun dhe sexhelin, të njohura për forma të rafinuara poetike dhe skema precize të rimave. Madje, edhe mënyra e stimulimit të krijimtarisë poetike dhe e kulturës në përgjithësi nga ana e mbretit sicilian Frederiku II Hohenstaufen (1194-1250), i cili e pushtoi Sicilinë, është identike me mënyrat e kultivimit të krijimtarisë e të kulturës në oborret mbretërore araboandaluiziane, në katër shekujt pararendës..

(Po aty, fq. 52. 6. Po aty, fq. 90. 11)

Në shkollën poetike siciliane u promovuan sonetistët e parë, Jakopo da Lentini7 , Pier dela Vinja, Guido dela Kollone, Xhakomino Pulineze, etj., të cilët krijuan themelet edhe për lindjen e "stilit të ri të ëmbël", nga i cili doli kolosi i letërsisë europiane, Dante Aligieri. Tradita poetike arabe në Sicili të Italisë, pra, në vetë truallin ku lindi soneti si formë poetike dhe poezia e madhe europiane, është poashtu e faktuar dhe e përmasave të mëdha. " Në orbitën kulturore të Magrebit ka jetuar edhe Sicilia përgjatë dy shekujve të sundimit arab në këtë ishull: kultura arabe sundoi përafërsisht edhe një shekull, sa ishte nën Normanët."8 Pra, edhe kur shikohet nga aspekti i prejardhjes, i relacioneve të kulturave dhe të qytetërimeve, me një fjalë i rëndësisë historike, soneti imponohet si formë poetike e përmasave të mëdha, pothuajse planetare, gjë që në rastin tonë e ka bërë edhe më atraktiv studimin e tij. Hulumtimi pas këtyre relacioneve kulturore të qytetërimeve të një kohe të largët, të para dhjetë shekujve, si dhe të transformimeve fantastike të formave poetike, jep një shans më shumë që të kuptohet natyra integrale dhe komplementare e historisë dhe e kulturës njerëzore. Mbase mund të thuhet se ekziston një natyrshmëri e këtyre relacioneve dhe e këtyre transformimeve, të cilat burojnë nga vetë natyra e njeriut, e cila më shumë aspiron drejt njohjes dhe përfitimit nga arritjet e përbashkëta, se sa nga ekskluziviteti dhe përjashtimi i tjetrit. Nga kjo tablo e shkurtër bëhet më e qartë se studimi i sonetit në letërsisë tonë kombëtare, mund të zbulojë lidhjet e poezisë shqipe me poezinë europiane, si dhe specifikat që janë shfaqur për shkak të realiteteve të hidhura historike dhe

Vijon numrin e ardhshëm

Flet politikani, historiani dhe shkrimtari Dr. Uran Butka, në 85 vjetorin e lindjes

MBIJETESA NË DIKTATURË DHE ZHGËNJIMI NGA DEMOKRACIA

Butka: Kujtimi i parë i dhimbshëm është kur familja Butka, u internua ne fillim të vitit 1945 në kampin e perqëndrimit të Krujës, madje edhe e shoqja e Sali Butkës. Në vitin 1976 me urdhër të Hysni Kapos, sekretar i KQ te PPSH-se dhe anetar i Byrosë politike të PPSH, u internuam në rrethin e Tropojës me shënimin e tij arbitrar– të zhvendosen nga Tirana larg kufirit dhe larg njerëzve. Ferri i diktaturës nuk do t'i ikë kurrë këtij vendi."

- 85 vjet, gati një shekull jete dhe përvoje të pazakontë i politikanit, historianit, shkrimtarit, njeriurt të kulturës dhe të medias, Uran Butka. Nga vjen z.Uran?

-Përgjigje- Vij nga familja Butka e Kolonjës, e cila e kishte origjinën nga Frashëri, nga fisi autokton Aliçka, i lidhur ngushtë me frashërllinjtë, madje gruaja e Abdyl Frashërit, Ballkizi, ishte nga Aliçkajt. Gjyshi im Sali Butka dhe gjithë burrat e familjes Butka kanë punuar, luftuar dhe kanë rënë për Shqipërinë.

- Çfarë kujtoni nga fëmijëria juaj?

- Kam lindur në Tiranë më 2 dhjetor 1938. Emrin ma ka vënë mjeku i mirënjohur Jani Basho. Në atë kohë, babai im Safet Butka, që kishte studiuar për filozofi në Austri, ishte drejtor i gjimnazit shtetnuer të Tiranës dhe reformator i arsimit kombëtar bashkë me Mirash Ivanaj. Për shkak se organizoi protestat e studentëve të Tiranës në datat 3-6 prill 1939 kundër pushtimit italian të Shqipërisë, u arrestua dhe u internua si antifashist në ishullin Ventotene për 3 vjet. Nga andej i shkruante nënës sime Hatixhesë, që t'i shiste enciklopeditë që kishte sjellë nga Austria dhe me ato para të shlyente kredinë e ndërtimit të shtëpisë të vogël në Tiranë. Por ajo nuk i shiti ato, as librat e bibliotekës, shiti gjerdanin e florinjtë të martesës. Sot librat e çmuar dhe enciklopeditë janë në bibliotekën time si trashëgim nga prindët . Kur im atë u kthye nga internimi në vitin 1942, krijoi çetat nacionaliste në qarkun e Korçës dhe luftoi edhe kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë në disa beteja, që janë futur në histori.

- Cilat janë momentet më të spikatura të jetës tuaj nën regjimin komunist?

- Kujtimi i parë i dhimbshëm është kur familja Butka, u internua ne fillim të vitit 1945 në kampin e perqëndrimit të Krujës, madje edhe e shoqja e Sali Butkës. Një ditë, kur gjyshja u afrua tek telat me gjemba dhe i kërkoi një krutani pak çaj se po digjej nga temperatuta e lartë mbesa Rita, krutani i dhimsur ai solli fijet e çajit bashkë me një paftë sheqeri, por të nesërmen morëm vesh se roja që e kishte lejuar, ishte zhdukur dhe krutanin bamirës e kishin varur në litar në sheshin e qytetit për të bërë terror.

Nëna ime, Hatixheja, bijë e dëshmorit të Rilindjes, Ramiz Lubonja, na u gjend pranë në fatkeqësi e vështirësi jete, ajo na rriti neve katër fëmijve, - Saliut, Iljazit, Uranit dhe Teftës me sakrifica, por me përpjekjen per të mos na lënë pa shkollë.

- Ju kini qenë arsimtar për disa vjet. Ka qenë privilegj, detyrim apo pasion?

- Unë kreva shkollën pedagogjike dhe punova për 15 vjet si mësues në rrethe të ndryshme. Nuk ishte privilegj, por rekrutim si në ushtri, megjithatë kam qenë mësues i pasionuar. Na mobilizuan si mësuesa për mungesë kuadrosh dhe na pushuan nga puna për biografi, kur u plotësuan me mësues të dalë nga kurset.

Në atë kohë, në momentet e zbutjes së luftës së klasave, që zhvillohej me zikzake, kreva universitetin e Tiranës me korrespondencë.

Më pyetët për momentet e vështira të jetës. Në vitin 1967 sollën në Krujë me qarkullim kuadrosh Masar Bekteshin, që kishte punuar në Komitetin Qëndror të Partisë; e prunë si drejtor të shtëpisë së kulturës. Në prag të festës së Krujës, 22 shtatorit, ai thirri në mbledhje ata persona që merreshin me kulturën, bie fjala me këngët, vallet etj. Më thirri edhe mua që përgatisja çdo vit nxënësit për recitime, por më tha: "Ti do të recitosh në miting "Epopenë e Ballit Kombëtar". Unë iu përgjigja se mësuesi nuk reciton në publik, por përgatit nxënësit dhe se ky ishte një provokim nga ana e tij. Siç dukej, ishte parapërgatitur terreni. Kallëzimi ishte bërë -" Ka mbrojtur Ballin Kombëtar etj". M'u pre fletarresti nga Dega e Brendshme, e cila njoftoi drejtorin e gjimnazit, Stefan Bulo, se do ta bënte arrestimin në një klasë të maturës ku jepja mësim. Drejtori i gjimnazit shkoi në komitetin e partisë, ku sekretar i parë ishte Piro Kondi, edhe ai i qarkulluar atëherë në Krujë. Stefani i kërkoi Piro Kondit, që unë të mos arrestohesha në orën e mësimit në mes të nxënësve dhe i tregoi të vërtetën e asaj ngjarjeje. Piro Kondi, që kishte qenë nxënës i Safet Butkës në Gjirokastër, e anulloi vendimin, Nuk më arrestuan, por më çuan mësues në një fshat të Krujës, Derven i thonë. Pas disa vitesh, më pushuan nga puna.

- Cfarë pune bëtë pasi ju larguan nga mësuesia?

- Në Tiranë punova për disa vjet si punëtor në komunale. Më pas kreva shkollën e mesme artistike "Jordan Misja" degën e piktures (pas universitetit!) dhe arrita të vendosem si piktor në fabrikën e këpucëve. Atje u njoha me mjeken Merjeme Pasmaçiu, nga një familje qytetare beratase, e cila ishte mjeke nefrologe në Spitalin e Përgjithshëm në Tiranë. Ajo kishte ardhur në fabrikën e kepucëve për një studim mbi ndikimin e lëndëve helmuese në tensionin arteria. Pak kohë pasi u martuam, natyrisht pa dasëm, nisi odiseja tjetër e familjes sonë të re. Merjemes i bënë presion që të ndahej nga unë për arsye biografije, por ajo nuk pranoi. Në vitin 1976 me urdhër të Hysni Kapos, sekretar i KQ te PPSH-se dhe anetar i Byrosë politike të PPSH, u internuam në rrethin e Tropojës me shënimin e tij arbitrar– të zhvendosen nga Tirana larg kufirit dhe larg njerëzve. (E kam botuar këtë vendim).

Na hipën në një kamion të mbuluar dhe na çuan në Tropojën e vjetër, por atje ishim afër kufirit, ndaj na hoqën urgjentisht dhe na vendosën në qytetin e Fierzës, por atje ishim afër njerëzve. Në mbledhjen e klasës punëtore në Këndin e Kuq në Fierzë për të na demaskuar, na akuzuan se mund të hidhnim ne erë hidrocentralin etj, madje një punëtor me kasketë tha që "këta t'i hedhim ne lumin Drin..." Mandej Komisioni i Dëbim Internimeve me në krye Manush Myftiun na degdisi në Martanesh, në teqenë rrëzë malit të Kaptinës, larg kufirit dhe larg njerëzve, larg edhe fshatrave të Martaneshit. Atje jetuam mëse 11 vjet, 1976-1987. Unë nuk mund te isha arsimtar, por më tjetërsuan në llogaritar të këshillit, duke zëvëndësuar një fillorist! Vazhdonte egërsisht tjetërsimi i njeriut në socializëm. Merjemes ia hoqën specializimin si mjeke nefrologe dhe ajo shkeli ne katër fshatrat e Martaneshit si mjeke e përgjithshme, duke u shërbyer me devotshmëri njerëzve edhe në kushtet e vështira të dimrit të ashpër atje. Edhe kur shpëtoi nga vdekja nje grua shtatzane, Kadife quhej, që u rrëzua nga një pemë dushku tek priste gjeth për bagëtinë e kooperativës dhe kur familja e saj e falënderoi doktoreshën, sekretari i byrosë së partisë në Martanesh kundërshtoi publikisht:

-"Nuk e shpëtoi mjekja, por e shpëtoi partia! A e dini pse e kanë sjellë këtu?... Dua të theksoj se qoftë në Tropojë, qoftë në Martanesh, populli na ka respektuar dhe na ka dashur, sidomos Merjemen.

- Ju kini marrë pjesë në Lëvizjen demokratike te viteve 1990 dhe në Partinë Demokratike. Mund të na thoni diçka?

- Kur u kthyem në Tiranë në prag të rënies së regjimit komunist, punova për dy vjet sërish punëtor në ndërmarrjen komunale si bojaxhi, lyeja makinat, biçikletat etj. Në dhjetor 1990 filloi lëvizja demokratike edhe unë natyrisht që isha pjesë e saj, mandej anëtar i PD-se. Gjithashtu isha një nga drejtuesit e Shoqatës kombëtare të të Përndjekurve politikë të Shqipërisë me Osman Kazazin, që kontribuam ne përmbysjen e diktarures. Studentët ishin dallëndyshet e para të lëvizjes demoktratike dhe të pluralizmit politik, por të përndjekurit politikë ishin forca goditëse. Më 20 shkurt 1991 isha bashkë me qytetaret e Tiranës në rrëzimin e shtatores se diktatorit Enver Hoxha. Në zgjedhjet e 31 korrikut 1991 Partia Demokratike fitoi në qytetet e mëdha. Tomor Malasi, kryetar i Komitetit pluralist të Tiranës më emëroi nëndrejtor të shkollës "Ismail Qemali. U ktheva sërish në profesionin tim, gjithashtu kryeredaktor i gazetës "Liria" organ i shoqatës të të përndjekurve politikë të Shqipërisë, ku janë evidentuar krimet e regjimit komunist dhe martirët e tij . Në zgjedhjet politike të 22 marsit 1992 u zgjodha deputet i Kolonjës dhe më pas anëtar i kryesise së Partisë Demokratike, madje dhe kandidat për kryetar Partie në konkurim me Sali Berishën. Jam zgjedhur edhe kryetar i Komisionit parlamentar të Mediave dhe Kulturës për dy legjislacione (92-96 dhe 96-97), kam punuar në parlament për ligjet e reja në fushë të kulturës dhe të mediave, madje nismëtar i televizioneve publike e private dhe realizova draftin e parë ligjor në parlament për televizionin publik dhe privat në Shqiperi, sepse deri atëherë ekzistonte vetëm televizioni shtetëror. Në atë kohë kam realizuar kthimin nga SHBA të eshtrave të Faik Konicës në atdhe, bashkë me ministrin e kulturës, Teodor Laçon dhe Bardhyl London. Kohët e fundit edhe kthimin e eshtrave të Midhat Frashërit pranë vëllezërve Frashëri dhe Faik Konicës në kodrat e liqenit, tek ai vend i bukur e i lartësuar, që e kam menduar si Panteoni i njerëzve të shquar të kombit. Shpresoj që së afërmi të vijnë atje edhe eshtrat e Fan Nolit.

Dua te theksoj se qysh në fillim të karrierës politike, kam qenë për kthimin e pronës tek i zoti, tek ish ish-pronaret, si një parim themelor i demokracisë dhe detyrim ndaj pronarëve të shpronësuar e të persekutuar për gjysmë shekulli, edhe me një grup deputetësh te djathte, kunder ligjit komunist 70501, si edhe kam ndihmuar për dëmshpërblimin e të burgosurve politikë e statusin e tyre

social. Gjithashtu kam kërkuar në parlament dënimin e regjimit komunist, dënimin e krimeve te komunizmit dhe ndarjen nga e kaluara komuniste e Sigurimi famëkeq i Shtetit.

- Për këtë veprimtari intensive e të guximshme, a ke pasur sulme nga enveristët dhe ish-Sigurimi i Shtetit?

- Natyrisht kam pasur edhe kërcënime, por nuk jam thyer. Bie fjala, një herë kur u ktheva në mesnatë nga Konispoli, ku përurova shtatoren Nëna Çamëri, me fytyrën e një nëne, ku loti i saj çante edhe gurin për tragjedinë Çame, e gjeta nënën time në Tiranë duke lexuar gazetën Zëri i Popullit, me një titull te madh "Uran Butkën do ta gjejë si i ati, do të vrasë veten". Një herë tjetër, isha ne shtëpi duke punuar, kur ra zilja e telefonit, Ishte gruaja, Merjema, që më fliste nga poliklinika ku punonte si mjeke. "Po bije shi dhe nuk e kam marrë çadrën, A mund te vish, merr edhe çadren time me vete". Më erdhi keq që u ndava nga puna, sidoqoftë shkova. Poliklinika ishte karshi Prokurorisë së Përgjithshme, Duheshin edhe disa minuta qe ajo te dilte, Për t'u mbrojtur nga shiu i rrëmbyer, u futa nën strehën e prokurorisë dhe prita. Buzë trotuarit u ndal një veturë. U hap xhami i ndenjëses së pasme dhe nxorri kokën ish- prokurori i përgjithshëm Aranit Çela. "U mundove të na bësh gropën neve, po re brenda vetë – më tha, Ëhëë…, të paskan thirrur në prokurori!" U afrova drejt tij dhe i thashë. "Unë jam i qetë, ndërsa ti duhet te ishe në Prokurori. A të zë gjumi natën, a të dalin në ëndërr ata që ke burgosur, vrarë apo varur në litar?" Ai mbylli xhamin dhe makina u zhduk. Në atë çast erdhi gruaja. "Pse nuk e hap çadrën, shiko si je bërë qull." E hapa çadrën. "Me cilin po flisje ashtu?- me tha. - "Me te shkuarën,- i thashë.

- Çfarë marrëdheniesh këni pasur dhe kini me PD?

-Parlamenti i vitit 1992-1996 , ku kam kontribuar edhe unë, ka qenë model i parlamentarizmit, ai e futi Shqipërinë në rrugën e demokracisë dhe të Evropës. Më pas ndodhi deformimi i PD për shkak të lidershipit të saj. Unë kam qenë kritik ndaj lidershipit të PD, autokratizmit dhe shmangjes nga parimet demokratike. Për këtë shkak u largova nga PD dhe u mora me studime dhe botime.

- Ju kini bërë mjaft botime në fushë të historisë, publicistikës, letërsisë, kritikës historike dhe të kulturës. Mjaft prej tyre i kemi publikuar në gazetën "Nacional" si "Ringjallje", "Marrëveshja e Mukjes", "Safet Butka", "Bombë në legatën Sovjetike", "Masakra e Tivarit", "Lufta civile 1943-45","E djathta dhe e majta në luftë", "Miti i Haxhi Qamilit", "Elita shqiptare", "Vuajta e bukur", etj.

- Duke marrë shkas nga titulli i fundit, vuajtja në jetë më ka shërbyer edhe si një pasuri për botimet e mia letrare dhe memuaristike. Si kryetar i Komisionit ad hoch per vlerësimin e figurave, kam vlerësuar historikisht jo vetë personalitete të martirizuara të së djathtës si Hysni Lepenica, Skënder Muço, Musine Kokalari, Sabiha Kasimati, dhe qinra të tjerë, por edhe të së majtës progresive si Mustafa Gjinishi, Ymer Dishnica, Llazar Fundo, Drita Kosturi e të tjerë.

- Një nga botimet më të rëndësishme është edhe vepra e zgjedhur e Midhat Frashërit në 12 vëllime. Sa kohë kini që punoni për këtë kolanë?

- Aktualisht jam drejtor i Institutit të studimeve historike "Lumo Skendo", themeluar në vitin 2016 nga unë dhe humanisti Agron Shehaj, duke u nisur nga testamenti i tij i vitit 1929, me anën e të cilit i linte veprat e Abdylit, Naimit, Samiut si edhe bibliotekën e tij prej mëse 40.000 vëllimesh për themelimin e një Instituti albanologjik në Tiranë. Në këtë institut kam hulumtuar, studiuar dhe botuar veprën e plotë të Midhat Frashërit, kolosit të historisë dhe kulturës shqiptare, me materiale të nxjerra nga arkivat shqiptare dhe arkivat e Francës, Britanisë së Madhe, Zvicrës, Greqisë, Rumanisë , Sofjes, Italisë, ShBA, etj si edhe botimin e Albumit të Frashëllinjve.

- Ndër pikturat që zbukurojnë mjedisin tuaj familjar, janë edhe një portret dhe një pikturë në vaj. A mund të na thoni diçka për to?

- Njëra është një nga pikturat e mia, peisazh vjeshte në Martanesh. Eshtë shkrirë me natyrën, ideja e lindjes, plakjes dhe rigjallërimit të jetës, e përjetësisë. Piktura tjetër është porteti im i realizuar nga piktori i mirënjohur Buron Kaceli.

- Kini marrë vlerësime dhe çmime kombëtarë e ndërkombëtarë si Mësues i Merituar, Mjeshtër i Madh, Penda e Argjentë në letërsi, , Urdhëri Kalorës i Gjerg Kastriotit Skënderbeut, urdhëri i shenjtores Nënë Tereza, çmim për veprën e Midhat Frasherit, titujt Doktor kauza në disa universitete të Kosovës e SHBA etj. Komenti juaj?

- Për mua ka rëndësi më shumë se çmimet, që të lesh gjurmë të mira në jetë dhe të kesh një familje të mirë.

- Çfarë projekte kini në të ardhmen?

- Të vijoj krijimtarinë, që më mban gjallë dhe nëse do të kem jetë, të botoj veprën e zgjedhur të Isuf Luzajt dhe të Musine Kokalarit.

- Ju uroj shëndet, jetë të gjatë dhe veprimtari të mëtejshme.

- Faleminderit!

PËRBINDSH I KATUNDIT



Tregim nga Sami Milloshi

-Ai asht përbindsh - tha Gjoka - për t'Parin e Katundit tonë.

-Nuk ka qenë kështu.- thashë unë.

- Ka qenë përbindsh !-kamnguli Gjoka.

- Gjokë, unë t'maj për burrë të mençëm. Mos ngul kamë si mushka n'akull.-thashë unë.

- Mirë pra - e bamë na përbindsh.- tha Gjoka.

- Për cilin e ke fjalën or Gjokë?-pyeta unë -sikur ajo çka thoshte ai t'i përkiste nji planeti tjetër, por jo atij e mue.

- Ti e unë e bamë përbindsh- tha Gjoka.

Mue sikur m'ra nji copë akulli mbi krye e ma bani nji varrë gjaku qi m'rrodhi n'ballë e rrshqiti përgjatë qafës e m'i mushi kpucët plot përplot me gjak...

- Ti e unë?!!- thashë sërish me nji habi të madhe.

- Po, po, ti e unë -e përsëriti tue e drejtue gishtin e tij tregues kah unë e kah vetja.

- Si? Në ç'mënyrë e bamë unë e ti përbindshin? - thashë unë.

-Ta them unë. Na heshtëm.Na myllëm gojën. Jo jo, desh të rrejta.Në fillim myllëm sytë. Mandej na myllëm veshët. Në fund myllëm edhe gojën...

Jo në nji ditë.Kaloi do kohë prej mylljes së syve nje kur myllëm edhe veshët.Kur myllëm edhe sytë edhe veshët, I Pari i Katundit e pa se mujti me na vu n'gjumë. Dhe sak na vuni n'gjumë. Bash njat ditë qi na vu n'gjumë ai u ba përbindsh. Bash njat ditë e myllëm edhe gojën.

Gjoka heshti pak. Nxorri kutinë e sermtë të duhanit. E drodhi nji cigare për vete. E bani edhe nji tjetër për mue. E qiti unurin dhe eshkën e ma nezi mue të parin cigaren. Mandej nezi edhe të vetën.

- A shkon ky tym duhani nje ke I Pari i Katundit tonë ,o Gjokë? - pyta unë.

- Sa axhami ke met,mor burrë! -tha Gjoka - Ti kujton se me lojnat e fjalëve qi ban rradakja jote,I Pari i Katundit e ven ujin n'zjarr për ty e për mue? As qi don me ia dijtë për na të dy a jemi gjallë. Shumë shumë, na ka n'defter veç si numra . Por, edhe si numra don me na fshi krejt.

- Po pse?- pyta unë.

- Se kur e preu pyllin e katundit na myllëm sytë.Kurrkush nuk u ba i gjallë.Se, helbete, pylli ishte n'mal. Se pylli ishte i tanë katundit e nuk ishte i askujt.

A t'kujtohet kur e hapi nji gurore

për me ba gëlqere ? E hapi për hesap t'vet,e hapi për kuletën e vet.A t'kujtohet si u mush mali plot me furra gëlqerje? A të kujtohet si u zhdukën sa çel e myll sytë pishat dhe ahet, shkoza dhe frashni ...

- Po,mor si nuk m'kujtohet -thashë unë. - Bile m'kujtohet kur I Pari i Katundit tha se furrat e gëlqeres së malit tonë kanë me pushtue tanë Ballkanin.E ka ba edhe nji festë për gëlqeren tonë.

- A t'kujtohet ai serbi qi kishte ardhë i ftuem prej të Parit të Katundit tonë kur tha:

" Ta pijmë me fund nji gotë për gëlqeren tuej qi ka me ia zbardhë muret tanë Ballkanit!"-tha Gjoka .

- Nuk e maj men- thashë unë.

- Po pra- se na ishim qorrue at kohë.Por, bash n'nat festë I Pari i Katundit ka bërtitë n'kupë t'qillit :" O milet kush thotë nji fjalë të zezë për gëlqeren tonë të bardhë ia kam kalarue gruen."

Mirë se ishim qorrue kur preu pyllin, po kur kërcnoi se ka me na kalarue gratë,veshët a i patëm n'vend? A thue edhe ato na i pat pre me kmesat qi preu pyllin?! - tha Gjoka.

- Veshët i kishim -po nuk na e muer menja se çmendet isani deri aty -thashë unë.

- Po na myllëm edhe gojën bash njat ditë qi ky i pari i katundit e qiti at pisllëk prej gojës së tij.Kurrkush nuk bzani nji fjalë me e kundërshtue. Unë për vete thashë nëpër dhamë " Munç me iu afrue grues sime,se kam me ta gri mishin me kadhë si berr!" -tha Gjoka.

- Kem qenë bashkë at ditë - thashë unë - veç n'e paç thanë me za t'vogël,se unë pasha t'madhin Zot nuk e kam nigju nji fjalë prej teje.

- Po pra - tha Gjoka - njaté jam tue pranue edhe unë. Jam tue thanë se kam folë si miza n'qyp e, kurrkush nuk e nigjoi se unë ia bana benë t'parit të katundit.

Si fola unë si miza n'qyp,bash njashtu foli krejt gjindja qi qe aty. Mandej na ,të tanë pa përjashtim e myllëm gojën krejt. Dhe a e din pse?

- Pse ?- pyta unë.

- Sepse na tuteshim se I Pari i Katundit mburrej se ishte miku i Mretit e i kishte shpatullat e ngrofta. Pasha t'madhin Zot, Mreti as donte e as don me ia dijtë për t'Parin e Katundit tonë. Por na, si u bamë qorra,shurdhanë e memecë me dëshirën tonë,jo vetëm I pari i Katundit,por edhe Mreti vetë, nuk pordhi hiç a ishim dhe a jemi gjallë a jo. Katund i vogël, katund i humbun n'skaj t'Botës katundi ynë....

Tash qi ne na kanë ardhë mendt na kanë shkue dhent...

Le që kamë bariu nuk ka met në katund. Janë tue ra edhe rrasat e çative prej kullave.

Tash na jem kujtue me ia fut duert në fyt të Parit të Katundit për gjithë t'zezat qi na ka ba.

Po nuk e dij a kem me mujtë me ia kthye vedit sytë e paqorruem,veshët e pashurdhuem dhe gojën e hapun.Jo veç për bukë!

Gojën e hapun me thanë nji fjalë për katundin tonë qi asht ba si xhenazja buzë vorrit...

Intervistoi: IRMA KURTI

Intervistë me poetin amerikan Michael Lee Johnson

POEZIA NUK PAGUAN, POR AJO MAGJEPS ZEMRËN

Poezia nuk mund t'i kapërcejë vitet e indoktrinimit, historisë dhe besimeve siç janë e vërteta apo zhgënjimi. Ajo mund t'i ndihmojë njerëzit të mendojnë, por vetëm koha dhe brezat e rinj mund t'i kapërcejnë paragjykimet.

Michael Lee Johnson ka jetuar në Kanada për dhjetë vjet gjatë periudhës së Vietnamit dhe është njëkohësisht qytetar i Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë. Sot, ai është një poet, shkrimtar i pavarur, fotograf amator dhe pronar i një biznesi të vogël në Itasca, DuPage County, Illinois. Ai ka 301 video me poezi në YouTube. Michael Lee Johnson është poet ndërkombëtar me vargje të botuara në më shumë se 1488 antologji; poezitë e tij janë botuar në 45 vende të botës. Michael Lee Johnson redakton dhe boton 10 faqe interneti me poezi. Ai është nominuar për 7 çmime Pushcart Prize në gjininë e poezisë dhe 6 nominime si Autori më i mirë në rrjet. Gjithashtu, është editor i 3 antologjive me poezi, të disponueshme në Amazon si dhe ka botuar disa libra me poezi e të tjerë me format të vogël. Ka në arkivin e tij 463 poezi të botuara. Michael është administrator i 6 grupeve të Poezisë në Facebook. Ai është po ashtu anëtar i Shoqatës së Poezisë në Illinois: http://www.illinoispoets.org/.

Mund të na tregoni diçka për veten tuaj?

Pjesa më e madhe e jetës sime është përmbledhur në biografinë time. Pas një reflektimi shikoj se ajo duket paksa e cunguar. Kam jetuar një jetë plot tension e çmenduri në kufirin e shumë ngjarjeve të rrezikshme ndër vite, të shoqëruara me periudha mërzie dhe vetmie. Në shkollën e mesme isha atlet, një fëmijë nën mesataren, që mezi merrte nota kaluese. U martova herët, shumë herët, dhe hyra në një kolegj lokal të paakredituar në atë kohë. Arrita mesataren B ose një notë 3 nga 4 dhe për shumë vite ndoqa 7 kolegje dhe universitete të ndryshme. Ndërsa lufta e Vietnamit u zgjerua dhe unë nuk isha më i martuar me një fëmijë, m'u kërkua nga qeveria e SHBA që të shërbeja në forcat e armatosura. Emigrova në Kanada me shumë vështirësi. Kam jetuar në rrugë, kam bërë autostop, kam qendruar në hambarin e kuajve të një fermeri për muaj të tërë përpara se të merrja statusin ligjor në Kanada. Ishte luftë për mbijetesë. Më në fund arrita të marr një diplomë në sociologji ndërsa nuk munda të kaloj një kurs për të shkruarin krijues. Fillova një program Master për korrektorë, përfundova kursin pa mbrojtur dot ndonjë tezë, ndërsa përfundova 3 kurse para-doktoraturë në Sociologji për t'i braktisur më pas të gjitha këto. Pas 10 vjetësh në mërgim, u ktheva në Shtetet e Bashkuara në pranverën e vitit 1980. Qysh atëherë e deri më tani, më është dashur shumë kohë për t'u marrë me aktivitetet që kryej sot.

A ju kujtohet poezia apo tregimi juaj i parë?

Poezia ime e parë titullohej UDHËTIMI: Humori im po mbaron, e shkruar në shkurt 1968. Tani, duke hedhur shikimin pas, vërej se ishte një vargëzim tipik i një të riu përpara Luftës së Vietnamit. Ju lutem, konsiderojeni këtë poezi si diçka tjetër dhe jo si një reflektim të gjendjes sime aktuale. Ashtu si shumë poetë të rinj, ajo ka të bëjë me përsiatjen, romancën dhe frikën. Kini parasysh se kjo ishte poezia e një fillestari, që mund të të vërë edhe në vështirësi. Ne të gjithë fillojmë nga një pikë e caktuar; kjo poezi tani ka mbushur 55 vjeç. Atëherë isha thjesht një i ri që ende s'kishte marrë një drejtim në jetë.

Në foto: Michael Lee Johnson

UDHËTIMI: Humori im po mbaron (Poema # 1)

Humori im po mbaron, mendja ime po bëhet realiste,
mendimet shkojnë përsëri tek kjo shoqëri.
Kthehen në rrugën e rutinës së përditshme,
rrugët plot, njerëzit aq meskinë dhe të ftohtë –
por sonte, në dhomën time, jam krejt i vetëm,
kur gjithçka është e qetë, dhe vetmia hyn në zemrën time –
mendja ime bëhet sërish aktive, mendimet vijnë pa pushim.
Thonë se që të largoj mendjen, më duhet të bëj një shëtitje,
apo të eci
por kjo mos vallë ndodh pse ata kanë frikë brenda vetes të kërkojnë,
apo të hyjnë në mendjet e tyre, të përballen me veten,
të hyjnë në thellësi të shpirtit të tyre?

02-03-1968
(Para-Mërgimit në Kanada. Lufta në Vietnam)

Përse shkruani?

Shkruaj sepse mundem. Kjo tani bën pjesë në atë grup të vogël të aftësive që unë zotëroj. Kam qenë i bekuar nga Zoti me një pasion që të paguan pak ose aspak, përveçse rasteve kur dikush njihet si "më i miri absolut" dhe kujtohet, zakonisht pasi largohet i vetmuar nga kjo botë. Vetëm atëherë duan të dinë se ku ka jetuar ai poet, nivelin e tij arsimor, ku mund t'i gjejnë fotografitë e tij, historinë e tij dhe kritikët ose poetët me të cilët ai rrinte.

Ju keni 301 video me poezi në YouTube. A është kjo një mënyrë tjetër për të dialoguar me lexuesit në mbarë botën?

Është një format i preferuar për mua për disa arsye të forta. Pa respektuar radhën mund të them se kam një cilësi zëri shumë të mirë për radio, pasi më lejon të dëgjoj zërin tim, të kap gabimet e thjeshta përpara prodhimit në YouTube dhe të korrigjoj poezitë përpara se t'i dërgoj ato në botim për një vlerësim më serioz. Më magjepsin teknikat e arranxhimit, përzgjedhja e fotografive, ndarja e fjalëve dhe zgjedhja muzikore për secilën poezi. Grafika dhe zëri arrijnë një audiencë reale dhe afatgjatë shumë më tepër se sa thjesht fjala e shkruar, por të dyja kanë avantazhet e tyre.

https://www.youtube.com/watch?v=2m0a-FXu0MgU&t=187s

https://www.youtube.com/watch?v=RG6X-HHDThDc

Cila është tematika e poezive tuaja?

Në vitet e para, si shumë fillestarë, tematikat e poezive të mia ishin të fokusuara në dashurinë e humbur, dashurinë e fituar dhe romancën, duke depërtuar në thellësinë e një zemre rinore njerëzore. Duhet mendjemprehtësi për të trajtuar tema të mëdha. Shpesh, poezia ishte një formë vetë-terapie, traume emocionale. Me kalimin e moshës dhe pjekurinë graduale, temat evoluan në një mjedis më të qëndrueshëm. Ato nuk ndryshuan shumë, por stabiliteti emocional ndryshoi. Poezia u bë pasion, jo terapi; ajo nuk varej më nga një mbështetje e jashtme. Temat e poezive të mia tani janë vdekja, natyra, meditimet mbi ngjarje të përditshme dhe poezitë e zymta, vargje munduese të fillimit dhe të fundit të jetës. Jezusi shpesh shfaqet në qoshet e poezive të mia për të mos u tejmbushur nga ateistët dhe jobesimtarët.

Ju jeni botues i 3 antologjive me poezi. Çfarë kanë të përbashkët shumica e poetëve?

Më pëlqen kjo pyetje. Është baza e të menduarit apo çmendurisë. Supozohet se shumica e poetëve janë të rezervuar, por jo të gjithë. Disa kanë mësuar të jenë të hapur për shkak të nevojës, për të siguruar jetesën dhe mbijetesën në platformën vetjake ose martesore brenda shoqërisë.

Përtej normales, për mendimin tim, poetët ndajnë disa nga këto gjëra:

- Një interpretim të ngjarjeve të thjeshta natyrore. Natyrës në përgjithësi.
- Shpesh hulumtojnë botën mistike, sfondet e pasigurta, traumat.
- Arratisen në botën e tyre të kufizuar.
- I shohin ngjarjet dhe vendet ndryshe nga shumica e njerëzve.
- Përpiqen më tepër se të tjerët. Nuk janë më inteligjentë, por shumë më të vendosur.

A mund të kontribuojë Poezia në bashkimin e poetëve në mbarë botën? A mund të ndihmojë ajo edhe për të kapërcyer paragjykimet?

Mediat sociale (Facebook, Instagram, Twitter ose X, dhe shumë platforma të tjera) ndihmojnë në bashkimin e poetëve dhe në inkurajimin e tyre për të ecur më tej. Lidhjet kuptimplote me krijues të tjerë me interesa të ngjashme vetëm mund të ndihmojnë. Ndarja e ideve, burimeve, poezive dhe informacionit ndihmon në ndezjen e një zjarri të nëndheshëm. A mund të ndihmojë ajo edhe për të kapërcyer paragjykimet? Jo. Kjo është një fantazi. Poezia nuk mund t'i kapërcejë vitet e indoktrinimit, historisë dhe besimeve siç janë e vërteta apo zhgënjimi. Ajo mund t'i ndihmojë njerëzit të mendojnë, por vetëm koha dhe brezat e rinj mund t'i kapërcejnë paragjykimet.

Çfarë interesash të tjera keni përveç të shkruarit?

Kam interes të jetoj edhe disa vite të tjera. Të administroj grupet e mia të poezisë në Facebook, gjë që e bëj nga viti 2012. Shoh nga dritarja ime dhe kënaqem me "krijesat e mia të natyrës" më tepër sesa me shumicën e "qenieve njerëzore". Pjesa më e madhe e njerëzve nuk e mendojnë veten si kafshë. Tingëllon e padenjë për disa nga të njohurit e mi më të rafinuar. Fakti është se ne të gjithë jemi kafshë.

Cila do të ishte këshilla juaj për autorët e ardhshëm?

Mos lejoni që dikush t'jua rrëmbejë gëzimin! Poezia nuk paguan, por ajo magjeps zemrën dhe nuk mund të shmanget nga vargshkruesit më të mirë. Trashëgimia e vlerave është pasion; përpjekja e bën atë realitet. Nëse besoni në ëndrrat dhe jetën përtej vdekjes dhe mbështetni fort përkufizimin tuaj të besimit dhe shpresës, ka të ngjarë që të jeni në rrugën që të çon në këndin e lojërave të Parkut të Poezisë.

Nga Odise Kote

NË ITAKË, DUHET TË KTHEHEM PATJETËR ...

Atje në Itakë,
duhet të kthehem një ditë patjetër,
Për të ndjerë gëzimin e ngrohtë,
kur këmba e marinarit shkel tokën,
magjepsur pas origjinës dhe racës.

Duhet të kthehem një ditë patjetër,
Një ëndërr fëmije për të rigjetur.

Sa mundësi kam të takoj,
një plak hokatar, jetëgjatë që pendohet.
Bashkë me erën që s'pushon,
dhimbjet e hirin e brerjes që djeg,
Duhet të kthehem patjetër…

Ska gjë të thjeshtë për të qënë e thjeshtë,
Kur vija ndarëse kalon mespërmes shpirtit,
Tejngopur nga talenti dhe vetmia.

Atje në Itakë,
një ditë duhet të kthehem patjetër.

Po ku qenka strukur Itaka e fëmijërisë?,
Ka vdekur?
Sirenat thonë: Itakën,
e paska rrëmbyer njeriu i verbër …!

VAJZA PRET NJË DJALË NË BREG ...

Në mbarim të muzgjeve dhe agimeve,
një anije në mes të detit fanitur.
Eh, eh, e...e, po ku ka mbërritur?

Sirenat që vijnë çdo herë prej larg,
veshur me tinguj të butë harrese,
sjellin vetëdijen të mbytur në thellësi.

Sikur pritja të mos qe kaq e gjatë,
të kishte të paktën një cak, dhe ...
të nderej gjithë ai mallkim e shpagë,
oii, oii.

Ç'është në horizont ai pelikan vetmitar,
metaforë apo lajmëtar?

Dallgët shkalafyten baticë - zbaticë,
shpresë vdekur, ikje - moskthim ...
eh, e....ehu, dallgë që thërmon shkëmbinj.
Oii, oii.

KUR HËNËN SHOH SI ZBEHET NËPËR MUZG ...



Në mbarim të agimeve e muzgjeve ...

ZOGJTË KAGARO MBI OQEAN ...

Këndojnë zogjtë Kagaro mbi oqean,
qiell' i natës vajtimin dërgon larg,
brigjeve matanë.

Paqësori sonte qenka llahtaruar.
Egërshan, zemërak, dallgë,
gjëmon kambanë,
sikur diçka të pistë, të vjetër
po e mbyt natës ngadalë.

Këndojnë a ngashërehen
zogjtë Kagaro mbi oqean?

Ngashërehen zogjtë Kagaro
mbi oqean,
drit ' e parë e agut kontinental
nxjerr kryet fshikëzës së çarë ...

Zogjtë Kagaro mbi oqean ...

KUR TË MË SHIKOSH

Kur të më shikosh që çdo ditë zvogëlohem,
mos u trishto, jam duke ikur.
Po e ndjen që me zogjtë e agimit zgjohem,
gëzo, është shenjë që festa sa ka nisur.

Mos u zemëro që rropatem burimin të gjej
atje ku mëllenja e çafka fshihen nga vapa.
Dashuria s'është siguri, është vetëm një vjegë
që punë të bekuara të lësh mbrapa.

A të kam thënë që do të mbetesh lule?
Lulja ka në thelb aromën, pjellorinë ...

Sikur thellë në pus, skajit në fundajë
pafajësia kurrë s'do ta braktisë njerinë.

Nëse më shikon që çdo ditë zvogëlohem
sa një grimcëz kozmosi,
mos u tishto, jam duke ikur ...

KUR HËNËN SHOH SI ZBEHET NËPËR MUZG ...

Kur hënën shoh si zbehet nëpër muzg,
më vjen ndërmend qerpiku yt i hollë,
dhe ikja në terrin që pushton hapësirën
me kuptimin e gjërave të fshehura,
në harmoni të padukshme.

Gjithë natën pastaj jam i mikluar
nga aroma dashurish fluturake,
derisa sa bindem se zogu i agimit
ka fluturuar i lirë në botë dhembjesh,
me mënyrën e tij si përjeton universin,
duke ikur shumë larg.

A ke mbajtur ndonjëherë një pëllumb në duar,
t'ia dëgjosh zemrën se si i rreh?

Kur e shoh hënën si zbehet nëpër muzg ...

SI NË NJË NGASJE QË NGJAU...

Kthehesha nga fushëbeteja plot gëzhoja e të vrarë,
nën shirat e dendur të natës dimërore,
(e dini: ushtarët kthehen në shtëpi, heronjtë vdesin).
Shpresat më shkaktonin dhembje,
e shkuara u jepte mendimeve forma të çuditshme.

Si në një ngasje - zigzage vetëtime që ngjau...

Pas shirave të rrëmbyer befas ndriti hëna,
pemët u drodhën e shkundën gjethet,
ky është çasti kur gjumashëve u hapen zavalle*,
të mençurit nuk besojnë alibitë e disfatës,
dhe rrugëve gjeta burra, (ishin vërtet burra?)
që peshonin më pak se fjala që thoshin.

Shirat nisën përsëri, kësaj here egërsisht.
Ndoshta ato ishin tingujt e mundësive
për të ndjekur pas imagjinatën e pambërritur.

Si në një ngasje - zigzage vetëtime që ngjau...

Krijimet origjinale i bëjnë të rinjtë. Kjo dihet.
Poezia bëhet e mërzitshme
kur ekzaminon me mikroskop.

- Zavalle* - kokëçarje, shqetësime.

TI JE E VETËM-JAFTUESHME.

Ç'të mbjell për ty
në tokën pa kufi të metaforës,
premtime shiu apo fjalë të kripura deti
pjekur në diellin e jugut përvëlonjës.

Je shpirt lumi i rrëmbyeshëm,
damarëve të nëndheut,
ujë i kristaltë, e qeshur prilli
thellë majës së lartë,
përbrenda dëborës ...

Ç'të mbjell për ty
në tokën pa kufi të metaforës ...

Mbase një tufë dobësish tokësore,
të qortueshme.

Sepse ti je e vetëmjaftueshme.

POEZIA IME ...

Ndan sekretin me një të panjohur,
pa destinacion, tren ekspres në ikje.
Aty ku asnjëherë s'më kishin pranuar,
lehtësisht më shpie.

Shpesh si zjarr, kurm' ëndrre zmadhuar,
çliruar frerësh, lëkurës së burrit.
Gjithçka prej shpirti, prej lëngu rrënjësh,
zbut qetësisht dhe mëritë e gurit.

Pa e ditur ku shkon, pa ditur ku fle,
natës së thellë, agimit që shkrumb.
Vizatuar me lapsa trilli e pasioni,
vjen dhe ikën, shfaqet e humb.

Aty ku asnjëherë s'më kishin pranuar,
lehtësisht poezia më shpie …

E shtunë, 13 janar 2024
NACIONAL

TË MENDOSH PËR KOHËN

POEMË NGA WALT WHITMAN





Përkthue: UKË ZENEL BUÇPAPAJ shqipëruar dhe pajisur me pasthënie

1

Të mendosh për KOHËN – për gjithë atë kohëparakalim,
Të mendosh për të sotmen, dhe vitet që pastaj do të vinë.
A ju ka shkuar ndërmend se do t'ju duhet të ndaloni?
A ju kanë tmerruar brumbujt e dheut?
A jeni frikësuar se Ardhmja do të jetë një hiç për ju?
A është e Sotmja një hiç? A është e Shkuara pa fillim një hiç?
Nëse e Ardhmja është një hiç, me siguri, edhe këto janë hiçi i hiçit.
Të mendosh se dielli lindte në lindje – se burrat dhe gratë ishin
Të epshëm, të vërtetë, të gjallë – se çdo gjë ishte gjallë,
Të mendosh se unë edhe ti nuk shikonim, nuk ndjenim,
nuk mendonim, nuk lindnim, as nuk vdisnim,
Të mendosh se tani jemi këtu, lindim dhe vdesim.

2

Asnjë ditë, asnjë minutë, asnjë sekondë nuk kalon pa një foshnje,
Asnjë ditë, asnjë minutë, asnjë sekondë nuk kalon pa një kufomë.
Netët e mërzitshme treten tutje, tutje treten edhe ditët e mërzitshme
Hidhërimi i lëngimit shumë gjatë në shtrat hidhet pas shpine,
Mjeku, pasi e ka shtyrë e shtyrë përgjigjen, në vend të saj,
lëshon vështrimin e heshtur dhe të tmerrshëm
Fëmijët vijnë me nxitim dhe duke qarë, lajmi u dërgohet vëllezërve dhe motrave,
Barnat rrinë të papërdorura në raft (era e kamfurit u bë kohë që ka pushtuar dhomat),

Dora besnike e të gjallit nuk e braktisë dorën njeriut që jep shpirt,
Buzët që dridhen puthin lehtë-lehtë ballin e njeriut që jep shpirt,
Frymëmarrja ndalon, edhe rrahjet e zemrës pushojnë,
Kufoma shtriqet në shtrat dhe i gjalli kujdeset për të,
Është e prekshme, njëlloj si i gjalli.
I gjalli kujdeset për kufomën me dritën e syve të vet,
Por, një qenie tjetër pa dritë syri, sillet vërdallë dhe vështron kufomën me kureshtje.

3

Të mendosh se mendimi për Vdekjen u përzie me mendimin për sendet!
Të mendosh se lumenjtë do të rrjedhin, dhe se dëbora do të bjerë, dhe se frutat do të piqen,
duke ndikuar te të tjerët, siç ndikojnë te ne tani – megjithatë nuk do të ndikojnë te ne!
Të mendosh për gjithë ato mrekulli qyteti dhe fshati dhe se të tjerët ende çmenden
pas tyre – kurse ne nuk duam t'ia dimë për to!
Të mendosh se me sa zell i ndërtojmë shtëpitë!
Të mendosh se edhe të tjerët po kaq të zellshëm do të jenë, por ne krejt mospërfillës!
(Shoh njërin që po ndërton një shtëpi ku do të kalojë ca vite,
shtatëdhjetë a tetëdhjetë vjet, e shumta,
Shoh njërin që po ndërton një shtëpi ku do të banojë më gjatë se kaq.)
Rreshta të zi, që mezi lëvizin, zhagiten ngadalë anembanë rruzullit –
ata kurrë nuk ndalojnë – janë rreshtat e varrimtarëve,
Ish Presidenti u varros, edhe Presidenti i tanishëm, me siguri, në varr do të përfundojë.

4

Kujtim i turbullt i fatit të rëndomtë,
Mostra e shpeshtë e jetës dhe e vdekjes së një punëtori,
Secili sipas sërës së vet:
Përplasja e ftohtë e valëve për anije te skela, në lumë shkëlqimi dhe akulli, balta gjysmë e ngrirë nëpër rrugë,
Sipër, qielli i përhimë, zemërthyer, drita e fundit e një dite dhjetori,
Makina e varrimit dhe kaloshinat – vargu i mjeteve të tjera me njerëz –
varrimi i një drejtuesi plak kaloshine nga Rrugëgjana.

Troku i shpejtë, i qëndrueshëm, drejt varrezave, kambana e vdekjes ushton në kohë,
Kalohet porta, ndalohet te varri i ri, të gjallët zbresin, hapet makina e varrimit,
Nxirret arkivoli, ulet dhe rehatohet në varr, mbi arkivol rri kamxhiku, dheu i hidhet me shpejtësi përmbi,
Pirgu i dheut sheshohet me lopata – heshtje,
Një minutë – askush nuk lëviz, askush nuk flet – mbaroi,
E varrosën me nderime – ç'mund të bëhet më tepër?
Ishte njeri i mirë, fliste lirshëm, nxehej shpejt, nuk ishte i keq për t'u parë,
I zoti në jetë, i zgjuar, i ndjeshëm ndaj shpërfilljes,
Mikun nuk e linte në baltë në ditë me diell, as në ditë me shi,
i kishte në qejf gratë, luante bixhoz, hante me gjithë shpirt, pinte me gjithë shpirt,
E kishte provuar ç'do me thënë të skuqesh, nga fundi ra shpirtërisht, u sëmurë, e ndihmuan me lëmosha, vdiq 41 vjeç – dhe ky ishte varrimi i tij.

Në kërkim të punës, me përparëse, pelerinë, doreza, këpucë me rrip,
rroba të lagura nga shiu, kamxhik të zgjedhur për merak,
Kapedan, soditës, fillestar, kafshar, dikush sorollatet me ty,
ti sorollatesh me dikë, vazhdon rrugën, njerëz përpara, njerëz prapa,
Ditë e mbarë pune, ditë e keqe punë, fis i zgjedhur, fis i lig,
i pari në punë, i fundit në punë, natën bie për të fjetur,
Të mendosh se këto vlejnë kaq shumë për karrocierët e tjerë,
kurse atij atje nuk i bëhet fare vonë për to!

5

Tregjet, qeveria, pagat e punëtorëve – të mendosh se sa marrin nga netët dhe ditët tona!
Të mendosh se punëtorët e tjerë do t'u japin po kaq rëndësi,
megjithatë ne nuk duam t'ia dimë fare për to!
I rëndomti dhe fisniku, ajo çka quhet mëkat dhe ajo çka quhet e mirë, të mendosh sa larg rrinë nga njëra-tjetra!
Të mendosh se ky dallim do të vazhdojë ende tek të tjerët,
kurse ne qëndrojmë përtej këtij dallimi!
Të mendosh sa kënaqësi ka!
A kënaqeni kur shikoni qiellin? A kënaqeni kur lexoni poezi?

A kënaqeni në qytet? A kënaqeni kur merreni me tregti?
A kënaqeni kur parashikoni të hidhni kandidaturën dhe të fitoni në zgjedhje?
A kënaqeni kur rrini me gruan dhe familjen?

A kënaqeni kur rrini me nënën dhe motrat? A kënaqeni kur bëni punë shtëpie?
A kënaqeni kur ngarkoheni me kujdese të bukura amësore?
Edhe këto vërshojnë përpara tek të tjerët – unë dhe ti vërshojmë përpara,
Por në kohën e caktuar, mua dhe ty nuk do të na hynë më në sy. Ferma jote,
fitimet tua, të vjelat tua – të mendosh sa i zënë je!
Të mendosh se ende do të ketë ferma, fitime, të vjela, por a të hyjnë më në punë?

6

Çka do të jetë, do të jetë mirë, se çka është, mirë është, Të përfillësh,
është mirë, edhe të mos përfillësh, mirë do të jetë.
Qielli vazhdon të falë bukuri,
Kënaqësia e burrave me gratë nuk do të shpallet kurrë,
as kënaqësia e grave me burrat, as kënaqësia që vilet nga poezia,
Gëzimet familjare, puna shtëpiake ose tregtia e përditshme,

ndërtimi i shtëpive, nuk janë fantazma, kanë peshë, trajtë, vendndodhje,
Fermat, fitimet, të vjelat, tregjet, pagat, qeveria, asnjëra syresh nuk është fantazmë,
Dallimi ndërmjet mëkatit dhe të mirës nuk është gënjeshtër,
Toka nuk është jehonë, njeriu dhe jeta e tij dhe gjithë gjërat e jetës merren mirë parasysh.

Nuk të kanë flakur në mëshirën e erërave, ti mbahesh të vetja me siguri dhe mbrojte,
Te vetja! Te vetja! Te vetja, përjetë, në pafundësi.

7

Kjo nuk bëhet që ti të shpërndahesh, o i lindur nga nënë e babë – kjo bëhet që të njihesh;
Kjo nuk bëhet që ti të jesh i pavendosur, por që ti të jesh i vendosur;
Diçka e përgatitur për një kohë të gjatë dhe e paformë arrin dhe formohet tek ti,
Që nga ky çast e tutje, je i sigurt, çfarëdo që të vijë dhe të shkojë.
Mblidhen fijet që u drodhën, të lagëtit kapërcen litarin e anijes, trajta është e përkryer.
Te përgatitjet secili ka hisen e vet,
Orkestra i ka akorduar si duhet instrumentet – shkopi i dirigjentit ka dhënë sinjalin.

Miku që po vinte – priti gjatë – tani prehet në shtëpi,
Është njëri nga ata të bukurit dhe të lumturit –
është njëri nga ata që ia vlen të kujdesesh dhe të rrish me të.
Ligji i të Shkuarës nuk mund të shmanget,
Ligji i të Tashmes dhe i të Ardhmes nuk mund të shmanget,
Ligji i të gjallit nuk mund të shmanget – është i përjetshëm,
Ligji i përparimit dhe shndërrimit nuk mund të shmanget,

Ligji i heronjve dhe i mirëbërësve nuk mund të shmanget,
Ligji i pijanecëve, spiunëve, të poshtërve – asnjë jotë e tij, për be nuk mund të shmanget.

8

Rreshta që mezi ecin dhe të zi lëvizin pareshtur anembanë rruzullit,
Veriori shkon në vig, edhe jugori në vig shkon, edhe ata në brigjet e Atlantikut,
edhe ata në brigjet e Paqësorit,
Edhe ata ndërmjet tyre, edhe çdo banor i Misisipit, dhe çdo banor i kësaj toke.
Mjeshtrit e mëdhenj dhe kozmosi ndjehen mirë teksa largohen,
heronjtë dhe mirëbërësit ndjehen mirë,
Prijësit dhe shpikësit e përmendur dhe pasunarët e mëdhenj
dhe besimtarët dhe të shquarit mund të ndjehen mirë,
Por ka më shumë shpjegime se kaq – gjallon shpjegimi i shpjegimeve.

Hordhitë e pafund të të paditurve dhe të ligjve janë diçka, Barbarët e Afrikës dhe të Azisë janë diçka, Njerëzit e zakonshëm të Evropës janë diçka – amerikanët vendas janë diçka, Të infektuarit në spitalin e imigrantëve janë diçka – vrasësit dhe të poshtrit janë diçka, Vargjet e përjetshme të njerëzve të cekët janë diçka teksa largohen, Prostituta më të përdala janë diçka – përqeshësit e fesë janë diçka, teksa largohen.

9

Për gjithë këto gjëra, tejendanë,
Kam ëndërruar se nuk duhet të ndryshojmë aq shumë, as ligji për ne nuk duhet të ndryshohet,
Kam ëndërruar se heronjtë dhe mirëbërësit duhet t'i nënshtrohen ligjit të tanishëm dhe të shkuar
Dhe se vrasësit, pijanecët, gënjeshtarët duhet t'i nënshtrohen ligjit të tanishëm dhe të shkuar,
Sepse kam ëndërruar se u mjafton ligji të cilit po i nënshtrohen tani.

Dhe kam ëndërruar se qëllimi dhe thelbi i jetës së njohur, e përkohshmja,
Duhet të formojë dhe përcaktojë identitetin e jetës së panjohur, të përjetshmen.
Nëse krimbat dhe minjtë na japin fund, atëherë Kushtrim! Se na kanë tradhtuar,
Atëherë dyshimi te vdekja është i vërtetë.

A dyshoni te vdekja? Po të dyshoja te vdekja, do të vdisja tani,
A mendoni se do të mund të shkoja shend e verë dhe i veshur si dhëndër drejt asgjësimit?

10

Shend e verë dhe i veshur si dhëndër shkoj,
Nuk e përcaktoj dot nëse shkoj, por e di se është mirë,
Krejt gjithësia tregon se është mirë,
E Shkuara dhe e Tanishmja tregojnë se është mirë.

Sa të bukura dhe të përkryera janë kafshët!
Sa e përkryer është toka dhe gjërat më të vockla mbi të!

Çka quhet e mirë është e përkryer, edhe çka quhet e ligë është njëlloj e përkryer,
Perimet dhe mineralet, të gjitha janë të përkryera, edhe lëngjet e papeshueshme të përkryera janë;
Ngadalë dhe të sigurta kanë kaluar në këtë gjendje,
dhe ngadalë dhe të sigurta ende vazhdojnë të përsosen.

11

Betohem, tani besoj se çdo gjë pa përjashtim ka shpirt të përjetshëm!
Pemët me rrënjë të ngulura në dhe e kanë! Leshterikët e detit e kanë! E kanë edhe kafshët!
Betohem, besoj se nuk gjallon asgjë tjetër, përveç pavdekësisë!
Se për të është skema e pacen, edhe vërshimi i mjegullt, për të është, edhe ngjizja, për të është!

Poet, gazetar dhe eseist amerikan, i njohur më së shumti për veprën "Gjethe bari" (1855), e cila u ndalua herë pas here, për shkak të poezive "Këndoj për trupin trondítës" ("I Sing the Body Electric") dhe "Kënga ime" ("Song of Myself"). Uitmani futi në poezi ritmet e të folurës së natyrshme. Megjithëse shpërfilli metrin, përjetimet përfundimtare që përcjell te lexuesi janë tingëllima tejet të ëmbla dhe të rrepta, si ato të ortekut të dëborës në një ditë me diell të bukur dimëror. Harold Blumi (Harold Bloom), në librin e tij The Western Canon (Kanuni Perëndimor, 1994), thekson se "asnjë poet Perëndimor, këto 150 vjetët e fundit, madje as Brauningu (Browning), as Leopardi (Leopardi), as Bodleri (Baudelaire), nuk arrin të matet me Uollt Uitmanin ose Emili Dikinsonin (Emily Dickinson)."

"Uknisht, u çuan, më rrethuan paqe e gaz dhe – dhe dituria që kapërcen të gjitha mjeshtëritë dhe përballjet me mend e fjalë, të kësaj bote;

Dhe e di se dora e Zotit është dora ime e kahershme,
Dhe e di, po, e di, se shpirti i Zotit është vëllai im i madh,
Dhe e di, po, e di, se kush ka lindur gjer tani, është gjithashtu vëllai im –
—- dhe gratë janë motrat dhe të dashurat e mia."

(nga "Kënga ime")

Uollt Uitmani u lind në Long Ajlend (Long Island) të Nju Jorkut (New York); ishte i biri i një marangozi besimtar, kurse në dejet e së ëmës rridhte gjaku i kulluar i bujqve holandezë. Kur ende ishte fëmijë, skllevërit i punonin tokat. Që aso kohe e më vonë, shpirti i i Uitmanit ziente nga dashuria për natyrën. Në rininë e vet lexoi shkrimtarë klasikë, si dhe u frymëzua nga krijimtaria e Gëtes (Goethe), Hegelit (Hegel), Karlilit (Carlyle) dhe Emersonit (Emerson). E braktisi shkollën shumë herët dhe filloi të punonte si ndihmës-piktor. Më 1835 punoi, gjithashtu, si mësues dhe kryetipograf. Pas kësaj kohe shkroi dhe redaktoi për disa organe periodike, si The Brooklyn Eagle (Shqiponja e Bruklinit, 1846-1848) dhe The Brooklyn Times (Kohët e Bruklinit, 1857-1858). Gjatë ndërmjetëzave të kësaj periudhe, kaloi tre muaj në Nju Orleans (New Orleans) pranë një gazete, dhe nxori bukën e gojës, duke u marrë me punë angari.

Në Nju Jork Uitmani pa me sytë e vet rritjen e vrullshme të qytetit, dhe dëshironte të shkruante një lloj të ri poezie, që përputhej me besimin e ri të njerëzimit, me shpresat dhe gjallërinë e pashoqe të epokës së vet. Një temë tjetër te poezia "Kënga ime" është vuajtja dhe vdekja – ai njësohet me KRISHTIN dhe fatin e TIJ: "Kot m'i gozhduan duart me gozhda. / Si tani, më kujtohen kryqëzimi dhe kurorëzimi / Si tani, më kujtohen prapashpinësat dhe kamxhikët e fyerjeve / Varrimi dhe qefini më kanë vënë përfund / Gjallë jam në Nju Jork, gjallë jam në San Francisko / Sërish, pas dy mijë vjetëve, rrugët përpëliten nën këmbët e mia." (nga varianti fillestar).

Botimi i parë i Gjetheve të barit doli në korrik të vitit 1855 me paratë e vetë Uitmanit – EDHE RADHITJEN, EDHE FAQOSJEN, VETË I KISHTE BËRË – dhe të gjitha poezitë ishin shëmbëlltyra e vetë poetit. Në të njëjtin vit u botua edhe vepra e Longfellout (Lonfellow) The Song of Hiawatha (Kënga e Hiavatës), epit tjetër të madhërishëm amerikan. Botimi i tretë i Gjetheve të barit doli në dritë gjatë ecejakeve të Uitmanit, më 1860. U prit mjaft ngrohtë, megjithëse, fillimisht, vepra e tij nuk ishte fort e njohur. Ralf Ualldo Emersoni (Ralph Waldo Emerson) ishte njëri nga adhuruesit e tij, i cili, më 1855, shkroi: "U gëzova, kur e lexova, sepse fuqia e madhe na fal lumturi."

Kur shkroi variantin e parë, Uollt Uitmani e njihte pak ose aspak filozofinë indiane, por kritikët e mëvonshëm kanë arritur të kapin mendimet indiane të shprehura në poezi – fjalët nga sanskritishtja përdoren saktë në disa poezi të shkruara pas vitit 1858. Gjethet e barit, gjithashtu, përfshijnë një cikël me poezi nën titullin "Kallami" ("Calamus"), e cila është marrë si pasqyrim i homoseksualitetit të poetit, megjithëse, sipas Uitmanit, ato lartësonin "dhembshurinë e bukur dhe të arsyeshme të mashkullit për mashkullin". Sipas disa burimeve, pat bërë vetëm një përpjekje të dështuar në drejtim të marrëdhënieve seksuale, në kuptimin homoseksual të fjalës, gjatë dimrit të vitit 1859-60.

Gjatë Luftës Civile, Uitmani punoi si nëpunës në Uashington. Kur iu plagos i vëllai në Frederiksburg (Fredericksburg), Uitmani shkoi atje për t'u kujdesur për të, si dhe për ushtarë të tjerë të Bashkimit dhe të Konfederatës. Lufta Civile ndikoi shumë te shkrimtari, çka tregohet në prozën e tij Memoranda During the War (Kujtimet e luftës, 1875) dhe në poezitë e botuara nën titullin Sequel to Drum-Taps (Kur përkëdhel daullen) më 1865. Në këtë cikël (1865-66) përfshihet elegjia e madhërishme për Presidentin Abraham Linkoln (Abra-

Vijon nga faqja 31

Sporteli numër zero

(TREGIM SATIRIK) NGA ADEM NIMANI

Në shehrin e Mustafë Agës, duke kërkuar ndërtesën e komunës, Grremçi pasi pyeti varg disa kalimtarë të rastit në katër udhëkryqe, po shkonte drejt një ure. Serish i shkoi mendja mos e kanë orientuar gabimisht, apo ky ka huq diku. Kaloi urën dhe eci drejt një ndërtese të madhe e të bukur. Mendoi për pak sarajet e Asllan Pashës. Porta kryesore ishte hapur. Pyeti serish një kalimtar në mos ka gabuar apo kjo është ndërtesa e komunës? Ishte në vendin e duhur. Hyri në korridor. Një njeri i veshur mirë, ulur brenda një kafazi xhami, i bëri shenjë të afrohet aty. Grremçi i tregoi çka po kërkon dhe portieri duke e parë mirë se ky njeri është nga një komunë tjetër dhe duket krejt i humbur, e pyeti prej nga vjen?

Grremçi iu përgjigj se vjen nga Zeza. Portieri u habit si nuk paska dëgjuar kurrë kësi emër fshati, aq më pak të një komune.

Ku duhet të paraqitem? – e pyeti portierin.

Portieri, si me mahi, pa një pa dy, i tha të shkonte në katin e dytë, në sportelin numër zero. Grremçi as e dëgjoi mirë këtë fjalën zero, por veshtë ia rrokën vetëm katin e dytë. Mësyu shkallët dhe për pak u gjend në një korridor tjetër me shumë sportele. Të gjitha kishin numra. Shikoi mirë numrat e sporteleve, por nuk iu kujtua zero, të cilën e kishte kuptuar si mahi. Numëroi me rend, një, dy, e dhjetë dhe në atë çast i erdhi në kokë fjala zero që ia kishte thënë portieri. Ndoshta është bash ky sportel, tha me veti. U afrua dhe pyeti nëpunësin për çka ka ardhur këtu.

-Prej nga vjen ore zotëri? – e pyeti nëpunësi

- Vij nga Zeza!

- Në shtetin tonë nuk ka katund as komunë me këtë emër!

-Ka, si nuk ka! Pas luftës edhe fshatrave e shehrave ua kemi ndryshuar emrat.

- Po a nuk gjetet emër pak më të bardhë, o njeri?

- E po, ja kështu kishin dëshirë zijoshët!- tha Grremçi.

-Pasi qenke nga Zeza, ti më i zi nuk bëhesh, shko në sportelin numër zero!

-Po edhe portieri juaj më tha shko në sportelin zero, e unë e kuptova si mahi, foli padashur Grremçi. Mos jeni ju nëpunësi i sportelit zero?

E kaploi njëfarë nervoze, në mos po tallen me të!

Atë ditë që vajti në komunë, Grremçit as që i shkoi ndërmend prej nga kishin ardhur të parët e tij për t'u vendosur Zezë. Tapitë për tokën e blerë nga Mustafë Aga ua kishte shkartisë krajli serb. Zijoshët nuk kishin humbur kohë me dokrrat e moçme(ashtu i quanin dokumentet) se kush prej kujt ka blerë tokë në Zezë. Vetëm Grremçi që kishte mbaruar fakultetin ishte rropatur me gojëdhënat e rrëfimet prej nga ka ardhur ky apo ai fshatar, apo kush nga cili fis kishte origjinën. .

Edhe po ta mësonte krejt historinë e Perandorisë osmane, tash kur kishte punë me administratën vendore. nuk po i mjaftonte. Atij nuk i duhej më shumë se një certifikatë për mixhën e vdekur para pesë dekadash, por nuk e nxirrte dot.

Kujtoi edhe ditën kur mixha i tij, Mani, kishte shitur tokën dhe ishte vendosë në shehrin e Mustafë Agës.

Se çfarë pune do t'i dilte me administratën, as që kishte paramenduar kurrë në jetën e tij. Atje në Zezë, në zyre punonin edhe disa ish nxënës të tij. Ishte plot shpresë se nuk do të ketë nevojë as të flas dy herë për të nxjerrë ndonjë dokument.

Sporteli me numër zero, tash nuk po i hiqej nga mendja. U hutua fare!

Nisi të lutet, por fjalët i dolën arabisht. Pastaj u kryqëzua tri herë.

Komunarët e Zezës i kishin thënë shko në shehrin e Mustafë Agës, për të marrë atë certifikatë të vdekjes së mixhës. Ne nuk jemi kompetent për këtë dokument, i kishte thënë gjykatësi, pasi mixha yt ka vdekur në Shehrin e Agës.

-A sheh që ke mbaruar shkollën kot, i tha vetit Grremçi. Asgjë nuk paska ndryshuar përveç pushtuesve të njëpasnjëshëm.

Në çdo hap që bënte kujtonte pse pleqtë iu kishin shmangur çdo pyetjeje prej nga kishin ardhur në Zezë të parët e tyre.

-Ai nëpunësi tjetër mund të më pyes, jo vetëm prej cilit fshat kam ardhur, por edhe cilit fis i përkas. Kishte mësuar Grremçi edhe për ikjen të bashkëfshatarëve nga belatë e përditshme me njeri tjetrin. Në pleqëri i kishte ardhur dita të mos dinte as kah t'ia mbante apo ku e çka të kërkonte nga hyqymeti.

I tretur në labirintet e Perandorisë së dikurshme, po rropatej me tokat e bejlerëve dhe agallarëve.

Shqiptoi më zë vargjet e rapsodisë " Po përzihet Prizreni! Pastaj ju kujtua edhe rapsodia tjetër ; "Në Shkodër të zezë ka krisë gazepi! Grremçi pa se vetëm zotërinjtë janë rrokur mes veti. Vallë mos edhe mixha Man, ai moçmi, mund të ketë qenë ndonjë zotërinj dhe mund të jetë rrokur keq me ndonjë tjetër, e kështu mund të ketë rënë në bela?

Qeshi me zë para sportelit ku do pyeste për zgjidhjen e problemit për të cilin kishte ardhur. As i shkoi mendja për sportelin numër zero, siç i kishte thënë si për mahi, së pari portieri i komunës, e tash këtë ia tha edhe nëpunësi, të cilin e kishte përpara.

-Shko në sportelin zero, i tha edhe nëpunësi që nuk i kreu punë.

-Edhe ky u tall me mua! mendoi zijoshi. Po, ani, mirë! Lë të tallen pak me mua plakun për të larguar këtë zymtësinë e punës në administratë.

Akoma nuk mendonte të kërkonte atë sportelin numër zero, pasi i dukej krejt mahi.

Pyeti një nëpunës tjetër çka po kërkonte.

-Më duhet një certifikatë e vdekjes së mixhës Man. Certifikatën e lindjes së tij, e kam këtu me veti. Moti ka vdekur mixha Man! Në zyrën e vendit në Zezë, ia gjetëm edhe certifikatën e lindjes. Viti i lindjes 1891?!

- 1891!? e përsëriti numrin, nëpunësi i habitur.

- Po, me 1891! Ashtu shkruan edhe në certifikatë, tha Grremçi.

E po mirë, vazhdoi nëpunësi të kërkonte menjëherë emrin e Manit në librin e të vdekurve.

- Ofiqari mori e rrotulloi mirë e mirë një libër regjistri të të vdekurve, por kot. Hapi edhe librin e dytë, serish kot. Emri i mixhës Man i lindur më 1891 nuk ishte! Ofiqari hapi e shikoi mirë e mirë edhe librin e tretë të të vdekurve, por emri i Manit nuk ishte askund.

- -A ka vdekur përnjëmend ky njeri,?- pyeti nëpunësi Grremçin.

- -Po ka vdekur!

-A ka lënë fëmijë mixha?

-Po, ka lënë një vajzë e një djalë! Edhe ata kanë vdekur.

Hiq pa pritur, në bisedë kishte ndërhy një nëpunës tjetër aty afër.

-Duhet të nxirrni certifikatat e vdekjes së dy fëmijëve dhe të mixhës Man.

Grremçi pastaj kishte nxjerrë ato dy certifikata, por jo edhe të mixhës, pasi atë nuk e gjenin dot në regjistrin e të vdekurve.

-E halli?- kishte pyetur Grremçi, nëpunësin!

I hutuar krejt, nëpunësi iu kishte drejtuar nëpunësit tjetër të gjendjes civile, se çka duhet bërë tash?

- Ta pyesim juristin çka thotë?!- kishte thënë nëpunësi tjetër.

Iu kishin drejtuar nëpunësit për çështje juridike, i cili ishte në vend pune për çdo rast kur dikush ka nevojë për ndihmë.

-A ka vdekur përnjëmend ky njeri,?- pyeti juristi Grremçin.

-Unë isha akoma i ri kur pat vdekur mixha Man. E kemi varrosur si çdo të vdekur, këtu në varrezat e shehrit.

- Për neve që tash punojmë në zyre për këso punësh, ai njeri nuk ka vdekur, tha juristi.

-E halli?-pyeti Grremçi.

- Për neve në Komunë, mixha yt është gjallë akoma. Pa u shënuar emri i tij në regjistrin e të vdekurve, mixha yt është gjallë.

Grremçit iu duk sikur iu mbyll shtegu i fundit.

Tash po i dukej sikur çdo njeri i gjallë i ka faj. Edhe deri tash kishte pasur mjaft përplasje me historinë, dhe sa duket vetëm edhe kjo i kishte mbetur.

Rropatej me origjinën e familjes, por nuk po ia dilte dot se çka duhej bërë më tutje. Nisi të mendonte edhe për atë Manin e parë, por nuk e dinte dot se cili mund të ketë qenë ai dhe sa veta e kanë pasur emrin Man deri të mixha Man? Ata ishin shumë dhe kanë vdekur moti. Çka ishte edhe më keq, atyre nuk iu dihen as varret.

Grremçi, i biri i vëllait të mixhës Man, sa më shumë kthehej në historinë e familjes, po fundosej thellë e më thellë në humnerën e origjinës e cila mund ta dërgonte deri në arkivat e Perandorisë Osmane, në mos edhe të Vatikanit?!

Për origjinën familjes kishte dëgjuar edhe gojëdhëna dhe ato të gjitha i dukeshin me përmbajtje të zezë. Nuk i largoheshin nga mendja thashethemet si ai Mani që ishte ngulitur në Zezë për të jetuar, mund ta ketë fshehur identitetin për shkak të belave të shumta, dhe kështu vet Grremçi padashur mund ta zbulonte historinë e sekretit dyqindvjeçar të ndonjë borxhi të moçëm fatkeq.

-Hajde babë, hajde, i tha veti!

Më nuk kishte ide se sa Mana ka pasur deri të mixha Man! As i kishte treguar dikush se prej nga kishin ardhur e ishin vendosur në fshatin Zezë, para më shumë se dyqind vjetësh. Kishte dëgjuar Grremçi ndonjë fjalë, se të parët e tij kishin ikur pikërisht nga belaja me fqinjët. Kur kishin ardhur në Zezë, kishin vendosur të mos i tregojnë askujt prej nga kanë ardhur. Aty, kishin menduar se kanë ikur mjaft larg sa nuk i arrin pushka e hasmit.

Duke parë se nuk po ndreqte dot punë, i tha veti :"Shko e eja si Adem Peja".

Ai Mani, nuk dihet cili Man, në shehër, kishte kuptuar mirë se të gjitha tokat që i sheh syri, male fusha, ara e livadhe, lumenj e liqene janë të Mbretit, i cili ua ka bërë tapi bejlerëve e agallarëve.

Zeza kishte pasur ofiqari edhe në kohën e mbretit e të krajlit serb. Kësaj radhe të gjitha sportelet, Grremçit po i dalin dolën zero, si në shehrin e Mustafë Agës, si në komunën e Zezës..

More, ai portieri ma bëri mirë me dije, por mua plakut nuk ma rroku rradakja.

Vallë a është e mundur të jetë gjallë mixha Man?

Mos vallë, atë ditë që shkuam ta varrosim, mund të na ketë mashtruar dikush? Ndoshta, atë ditë, mixha Man mund t'i ketë ikur vdekjes. Ndoshta e kishte marr malli për ta parë vendlindjen dhe i ka ikur vdekjes.

Krejt pa dashur iu kujtua ai "rroteli" i komunës së shehrit të Mustafë Agës që thoshin është zhdukur gjatë luftës së fundit dhe familjes së tij hyqymeti ia kishte akordua një pagë të mirë, ndërsa emrin e tij e kishin shkruar në përmendoren e dëshmorëve. Ai kishte punuar plot shtatëmbëdhjetë vjet në Beligrad, dhe kur

ishte pensionuar, ishte kthyer në vendlindje gjallë, e shendosh e mirë, si kokrra e mollës. Askush nuk e kishte bërë të madhe ketë punë.

Ndoshta edhe mixha Man ka punuar në komunë për gjithë këto vjet dhe është gjallë?!

Ndoshta, atë ditë e varrosem vetëm vdekjen e mixhës, e jo mixhën Man!? Edhe vetja iu bë i dyshimtë.

- Është i gjallë apo i vdekur mixha Man?

Nëse mixha i lindur në vitin 1891, për këta zyrtarë qenka gjallë, edhe unë mund të mos jem gjallë, filloi të dyshonte për veti. Gjithçka iu bë tërkuzë.

Nëpunësi e pa që zijoshi po fliste përçartë duke u larguar nga sporteli dhe nuk po e gjente as derën për të dal nga ndërtesa e komunës. Portieri i ndihmoi qe të mos ia huq portës hap e krah.

Doli pa ditur ku do të shkonte që ta kërkonte mixhën, i cili akoma qenka gjallë?! Po ku mund të ketë jetuar mixha i gjorë gjithë këto vite, kur na menduam se e varrosem atë ditë pranvere, në vitin 1978.

Nisi të numëronte me gishta sa vjet mund të kishte mixha deri në këtë ditë? Murmuriti gjatë dhe llogaria i doli se mixha Man tash do të kishte hiq më pak se 132 vjet.

-Mos ndoshta ka punuar në komunë gjatë gjithë kësaj kohe? - tha vet me veti Grremçi duke qeshur me zë, krejt i humbur.

-Mixha qenka gjallë! Gjallë ishte mixha Man!-belbëzonte vet me veti Grremçi. Bile ai zyrtari më tha, se për ata të komunës, mixha është gjallë, hiq pa dëshmitarë.

-Po ku gjen sot dëshmitar për njeriun që ka lindur në vitin 1891, e i cili sipas nëpunësve të komunës është gjallë akoma?

- Certifikatën që kërkova, nuk ma dhanë.

Nuk ishte vetëm një sportel me numrin zero, por të gjitha ishin zero për Grremçin.

Pak si me shpoti, ai zyrtari i shehrit të Agës ia kishte thënë Grremçit edhe do fjalë të majme!

- A keni zyre të vendit në Zezë, ku kryhet kjo punë?- e kishte pyetur nëpunësi?

-Natyrisht që kemi! –ishte përgjigjur Grremçi.

-Ju atje qenkeni më të vdekur se ai i vdekuri!

A e dini ju që jeni shtet i pavarur që nga viti 2008? A e dini që shteti ynë ka administratë, gjyqësi të gjitha niveleve, ka polici, ka ushtri?

-Me çfarë djalo- ligjesh e letrash punoni atje në Zezë? Mani ka lindur në Zezë kur sundonte Perandoria Osmane. Ai Mani i gjorë ka jetuar në Perandorinë Osmane deri në moshën 21 vjeçare. Bile thonë se ai i ka shpëtuar rekrutimit osman pasi ia kishin prerë gishtin e madh të dorës qysh kur kishte lindur. Ai pastaj ka jetuar edhe nën pushtetin serb që është ndërruar tri a katër herë gjatë një shekulli dhe ka qenë i regjistruar me dëshmitarë në defterin e krajlit.

-Mbi cilat ligje punojnë ata nëpunësit tuaj? A punojnë ata zijoshë me "kadiun" e mbretit, me zakonet serbe, apo me ligjet tona?- e kishte pyetur nëpunësi.

Nëse ato shërbimet administrative të Zezës nuk paskan kuptuar akoma se jemi shtet i pavarur, tregoju se për ta regjistruar Manin në librin e të vdekurve, sipas tyre u dashka të shkoni në Ankara, pasi Stambolli më nuk është kryeqytet i Turqisë. Por, ta dini se as atje nuk do të gjeni asgjë. As Perandoria osmane nuk ekziston moti dhe tash ka emër e ligje të kësaj kohe.

Ore zijosh! Ne kemi krejt administratën që i duhet një shteti. Thuaju atyre zijoshëve në komunën tuaj që të gjykojnë drejt e të vendosin sipas ligjeve të shtetit tonë, e të mos i shtyjnë qytetarët nevojë e pa nevojë, që të kërkojnë ndihmë nga strukturat paralele të administratës së Serbisë, që akoma i paguan Beligradi.

Fjala për mahi e atij portierit që më tha shko në sportelin zero, më doli e saktë, tha vet me veti Grremçi dhe u qetësua pak.

Çdo sportel kishte numër, por ama secili ishte zero për Grremçin, që nuk po ndreqte dot punë në asnjërin prej tyre.

HETUESI I DIKTATURËS



Tregim nga Robert Shkurti

Me Engjëllin kam ca kohë që njihem. I ka kaluar të shtatëdhjetat. Eshtë me trup mesatar, fytyrë ëmbël, me flokë të rënë, sportiv në veshje dhe në ecje. Të jep përshtypjen e njeriut babaxhan. Takohemi shpesh pasditeve në qendër të qytetit, në sheshin "Vittoria". Ulemi në lokalin "Caffe Cavour" ose "Caffè delle Fontane" dhe marrim ndonjë kafe ose ndonjë pije, jo alkoolike. Na bashkohet Dëfrimi dhe Luani. Si emigrantë që jemi, diskutojmë për ngjarjet që ndodhin në atdhe, sidomos ato politike. Zakonisht kemi mendime të ndryshme dhe nuk biem në një mëndje, sidomos me Dëfrimin. Në kohën e diktaturës ai ka punuar në organet drejtuese të qytetit ku jetonte, ndërsa Engjëlli në atë kohë ka qenë i persekutuar politik. Babai i tij ishte arratisur në Greqi në vitin 1951. Tre vjet kishte qëndruar në një kamp grek, pastaj e kishin nisur përtej Atllantikut, në Kanada. Pas rënies së diktaturës komuniste dhe hapjes së kufijve, u kthye në Shqipëri si vizitor. Takoi gruan dhe tre fëmijët e tij, që i kishte lënë në mëshirë të fatit kur ishte larguar. Kishte jetuar me shpresën se një ditë komunizmi do të përmbysej dhe ai do të bashkohej përsëri me familjen. Por sa më shumë kalonin vitet, aq më e largët bëhej ëndrra e tij. Ishte detyruar të martohej e të krijonte familje tjetër, por kurrë nuk e kishte harruar familjen e braktisur në Shqipëri. Ishte përpjekur t'i ndihmonte ekonomikisht gruan dhe fëmijët. U kishte dërguar vazhdimisht të holla, por, kjo nuk ia kishte larguar asnjëherë ndjenjën e fajit që ndiente ndaj tyre. Gjatë kohës së diktaturës familja e tij kishte vuajtur. Kshte qenë familje e persekutuar nga regjimi komunist.

Një pasdite, tek pinim kafe, Engjëlli ngau bisedën dhe tha:

- Do t'ju tregoj një bisedë me një hetues të kohës së Enverit pas rënies së diktaturës. Skënder, quhej ai. Vinte i gjatë, i hollë dhe me flokë gjysmë të rëna. Jetonim në të njëjtin pallat në qytetin e Vlorës. Pasi ra diktatura, Skënderi nuk ishte më hetues, por edhe pa punë nuk ndenji. Me marifete dhe me të njohurit që kishte, arriti të bëhej noter, profesion të cilin e ushtron edhe sot e kësaj dite. Ka vënë goxha pasuri. Tani duhet të jetë tek të shtatëdhjetat. Një ditë ndërsa dilja nga shtëpia, u ndesha me të te dera e shtëpisë së tij. Unë zbrisja, ndërsa ai po hapte derën.

- Mirdita, Engjëll! - më përshëndeti buzagaz.

- Mirdita, Skënder! - ia ktheva përshëndetjen dhe vazhdova të zbrisja.

- Ku po shkon? - më pyeti.

- Po dal në qytet, të bëj një shëtitje.

- Eja brenda të pimë një gotë raki. Kam raki të mirë.

Ftesa e tij m'u duk e çuditshme, sepse s'më kishte ftuar asnjëherë më parë. Madje si nëpër dhëmbë më përshëndeste kur ndesheshim nëpër shkallë ose jashtë në oborr. Po kështu edhe familjarët e mi. " Domosdo, duke qenë se i ka shërbyer sistemit, diktaturës, çoç i duket vetja, ndërsa ne jemi të persekutuar dhe të përbuzur prej tij dhe soji i tij. Ne për të jemi armiq" - thosha me vete i nxehur dhe mundohesha t'i shmangesha sa herë që mundja.

- Jo, Skënder, nxitoj, - u mundova të justifikohesha, por ai më kapi nga krahu e më futi brenda. U dorëzova. Nuk kundërshtova më.

Skënderi kishte shtëpi të mobiluar mirë. Bufe moderne, në të cilën kishte vendosur një televizor të madh, divane të veshura me lëkurë të zezë e të butë, një tavolinë të madhe, rreth së cilës ndodheshin gjashtë karrige druri të punuara bukur.

U ula në njërën nga karriget dhe po rrija si mbi gjemba. Ndërkohë Skënderi nxitoi te bufeja dhe nxorri një shishe të mbushur me raki. Pastaj mori dy gota qelqi të mëdha, i vuri mbi tavolinë dhe i mbushi përgjysmë. Njërën ma zgjati mua dhe tjetrën e mbajti për vete. E mora gotën dhe po e mbaja në dorë, në pritje që të thoshte ai i pari "gëzuar!" si zot shtëpie që ishte.

- Gëzuar, o Engjëll! Shëndet e mirësi në familje! - tha dhe e rroku gotën e tij me timen.

- Gëzuar, Skënder! - ia ktheva unë dhe piva një gllënjkë. Rakia ishte vërtet e mirë. Ndjeva të më ngrohej gjoksi dhe një aromë e mirë më mbushi gojën.

Nisëm të bisedojmë për gjëra të zakonshme: për shëndetin e të afërmëve, për punën, për çmimet, për politikën e demokracisë së çuditshme, që sapo kishte trokitur. Pasi kishim rrëkëllyer nja dy gota, Skënderit iu zgjidh gjuha dhe kishte dëshirë të fliste. U skuq në fytyrë, si një gjel deti kur zë e këndon dhe gjuha po i trashej. Trokiti gotën përsëri me timen dhe e rrëkëlleu.

- Dëgjo, o Engjëll! Ai sistem nuk ishte i mirë. Ne që ishim në postet drejtuese, në organet e Sigurimit, të policisë, të gjykatës e kudo, kemi bërë gabime e faje të shumta, madje të rënda, por e tillë ishte politika e asaj kohe dhe urdhërat që na jepnin duhej t'i zbatonim.

Më erdhi çudi kur dëgjova këto fjalë nga një ish-hetues i tmerrshëm, i cili kishte hetuar, rrahur e poshtëruar me dhjetra vlonjatë për një fjalë goje, për një gabim apo faj të vogël. Edhe pse kisha rrëkëllyer edhe unë ca gota, pata përshtypjen se donte të shfajësohej e të justifikonte veprimet e kryera në atë kohë. Vazhdoja të qëndroja si mbi gjëmba e nuk dija ç'ti thoja e çfarë qëndrimi të mbaja. Tek mendohesha, ktheva një gllënjkë rakie dhe i thashë:

- Të paktën nuk u bë gjakderdhje. Ramizi u tregua i zoti. E shmangu me diplomaci katrahurën që mund të kishte ndodhur.

- Eh, more Engjëll! Ti nuk i di ato që di unë. Çfarë gjakderdhje shmangu ai?! - tha mes grahmave të rakisë.

- Po pse, o Skënder, thua kështu? - e pyeta unë dhe më lindi një dëshirë e madhe për të ditur më shumë.

Skënderi ishte bërë çakërrqef. Kishte dëshirë të fliste. Kot nuk thonë se çfarë ka barku e zbraz bardhaku. Donte të zbrazte barkun e fryrë si kacek, atë bark të mbushur me helmin që kishte pirë gjatë jetës. Pa e zgjatur shumë, ia nisi:

- Që thua ti, o Engjëll, do të tregoj një sekret të asaj kohe. Sot nuk është më sekret, ndaj po ta them. Ja, po ta them unë se çfarë do të ndodhte në rast se do të shpërthente luftë dhe ne do të sulmoheshim nga vendet agresore.

- Çfarë do të ndodhte? - e pyeta unë, kureshtar.

- Të gjithë të persekutuarit, të burgosurit politikë dhe fëmijët e tyre do të ekzekutoheshin menjëherë, me qëllim që të mos ju kishim kundërshtarë. Të mos ju kishim nëpër këmbë e të na kthenit pushkën. Ne kishim frikë nga ju, ndaj dhe urdhëri ishte i tillë. Ekzekutimi do të kryhej nga Reparti 321 i Burrelit. Atë kishin caktuar.

Kur dëgjova këto fjalë të dala nga goja e një hetuesi të kohës, një shërbëtori të zellshëm të regjimit, m'u drodh trupi. Gjëja e parë që më shkoi ndërmend ishte se sa e thellë dhe e madhe kishte qenë urrejtja dhe përçarja që kishte shkaktuar diktatura dhe regjimi i Enver Hoxhës me politikën e tij ndërmjet shqiptarëve.

- Po prit, nuk mbaron me kaq! - tha Skënderi dhe rrëkëlleu rakinë e mbetur në gotë.

Para se të vijonte të fliste, mori shishen, mbushi gotën e tij dhe donte të mbushte edhe timem, por nuk e lejova. Më ishte prishur gjaku dhe nuk doja të pija më. Tha dhe diçka tjetër, por nuk e dëgjova. U përmënda pasi më shkundi nga krahu.

- Po të thoja që nuk mbaron me kaq, sepse veç kësaj të burgosurit ordinerë dhe emigrantët kosovarë do të zhvendoseshin në pika të posaçme, të fshehta. Ishin disa pika, si ajo e Bënçës, e Përparimit, reparti i Vodicës, Beratit, Spaçit, Çekrezit. etj.

Pasi u zbraz mirë e mirë, Skënderi m'i nguli sytë dhe nuk m'i shqiti për disa çaste. Unë kisha ngrirë. Asnjë muskul i fytyrës nuk më lëvizte. Vështrimi im përplasej dhe thyhej brenda syve të pirë të Skënderit.

- Ja, o Engjëll, kështu i kishte ndarë detyrat në rast lufte, Sigurimi i Shtetit, - zbrazi ai pikën e fundit të helmit, pa ma ndarë vështrimin.

Në fytyrën e tij pashë një lloj pendimi dhe nga fjalët që tha kuptova një vrarje ndërgjegje, që nuk kishte asnjë vlerë. Ai ish-hetues i diktaturës, një dhëmb i vogël i ingranazhit të madh të diktaturës, kishte hequr xhaketën gjakatare të hetuesit dhe kishte veshur atë të noterit mashtrues, duke zhvatur dhe grabitur shqiptarët halle shumë. As edhe një gjemb nuk i kishte hyrë në këmbë për krimet e panumurta që kishte bërë.

Pasi mbaroi së treguari, Engjëlli na vështroi në sy. Vështrimi i tij ishte sa pyetës, aq edhe kureshtar. Nuk e dinte sesi do të reagonim. Ne ishim ngurosur nga rrëfimi i tij. Ngurosja jonë vazhdoi për disa çaste. Heshtjen e theu Dëfrimi, i cili u hodh dhe tha:

- Nuk është e mundur! Unë nuk e besoj. Unë kam qenë pjestar i Shtabit të Forcave të Armatosura në rast lufte, i ngarkuar të merresha me organizimin e rezervistëve e qytetit. Asnjeri nuk na e ka thënë një gjë të tillë. Unë....

- Po kush na pyeste ty e mua, o Dëfrim?! - e ndërpreu Luani i nevrikosur, që më tej vazhdoi: - Unë kam qenë antar partie, kam qenë komunist i thjeshtë. Neve nuk na pyeste njeri. Kur bënin mbledhje partie, ne komunistëve të thjeshtë na donin vetëm për të votuar, për të miratuar vendimet e ardhura nga lart! Ka të drejtë Engjëlli. Unë e besoj dhe aq më tepër që e ka pohuar një ish-hetuesi i Sigurimit.

Unë nuk kisha as më të voglin dyshim. Ajo që kisha dëgjuar pak çaste më parë, ishte mëse e vërtetë.

12 nëntor 2023

Kënga është konceptuar si një homazh për këngëtaren e famshme

KËNGËTARI I NJOHUR ARIF DUSHAJ, SAPO KA REALIZUAR "KANGË KUSHTUAR FATIME SOKOLIT"

Këngëtari i famshem Arif Dushaj ka arritur jo vetëm një ringjallje të mitit muzikor të Fatime Sokolit, por ka realizuar në fakt një evoluim të stilit të saj të të këndurit, në krejt kontekstin emocional dhe artistik, një kontekst tjetër muzikor, plot emocione, ngjyrime dhe ritme të papërseritshme që vijnë përmes zërit karakteristik të këngëtarit të shquar Arif Dushaj.

Nga Mujë Buçpapaj

Këngëtari i mirënjohur Arif Dushaj sapo ka publikuar realizimin e tij më të ri muzikor "Kangë kushtuar Fatime Sokolit", njëres prej legjendave të muzikës Tropojane dhe shqiptare në tërësi.

Me tekst të autorit Ibrahim Daut Doçi dhe muzikë të këngës "Dy tupana në derë të kullës" një nga hitet e këngëtares së njohur Tropojane, kënga nuk është thjeshtë një mbivendosje e tesktit mbi muzikën e një kënge të njohur të saj, por një kontekst tjetër muzikor, plot emocione, ngjyrime dhe ritme të papërseritshme që vijnë përmes zërit karakteristik të këngëtarit të shquar Arif Dushaj.

Kënga e Arif Dushajt, e konceptuar si një homazh për këngëtaren e cila është ndarë nga jeta 37 vjet me parë, synon një tjetër audiencë dhe një tjetër publik, kryesisht të rinjtë e sotshëm të cilët kanë rast të mësojnë diçka më shumë për këngëtaren e mirënjohur, vokacionin e saj muzikor të drejtuar të të gjithë brezave dhe të të gjitha kohërave.

Këngëtari i famshem Arif Dushaj ka arritur jo vetëm një ringjallje të mitit muzikor të Fatime Sokolit, por ka realizuar në fakt një evoluim të stilit të saj të të këndurit, në krejt kontekstin emocional dhe artistik.

Arifi e ruan me kujdes identitetin e stilit të të këndurit të legjendës së këngës popullore shqiptare, si një muzikë e lidhur me të gjithë kombin, me kohën dhe hapsirën e pambarimtë që shoqëron edhe pas vdekjes artistë të formatit të Fatime Sokolit, duke e misherue me shumë mjeshtri karakterin e saj muzikor.

Pra kënga nuk është një këngë komerciale, por një risjellje origjinale e trashëgimisë tonë më të mirë muzikore, gjë për të cilën duhet falenderuar artsiti Dushaj, pasi e sjell atë kryesisht për të rinjtë shqiptarë që janë të interesuar të mësojnë për këtë themeluese të muzikës së përpunuar Tropojane, që frymëzoi miliona shqiptarë në Ballkan dhe botë.

Në të vertetë Arifi e ka zgjeruar këtë stil të kënduari, duke i dhënë atij një kontekst të ri, duke e ruajtur ngjyrimet dhe sjell imazhin e këngëtares para syve tanë, siç ajo ishte e fortë, krenare, me një zë burimor dhe të rrallë, pjesë e kulturës tonë kombëtare me rrënjë në Bjeshkët tona.

Edhe pse Fatime Sokoli ka patur stilin e saj karakteristik të të këndurit, gati të paimitueshëm, siç ka qënë në Kosovë Nezhmije Pagarusha apo Demir Zyko në Skrapar, pasi të dëgjoni këngën do të bindeni se cilësitë e përformancës vokale të Arif Dushajt janë të shkelqyera , dukje na e risjellë imazhin e saj të freskët dhe të paharruar.

Arifi ka realizuar një këngë që do ta pëlqejë audienca shqiptare kudo ku ndodhet

Po kështu orkestrimi është i shkelyqer dhe modern duke e bërë aq të dashur ritmet karakteristike të zërit dhe muzikës së saj.

Zëri i çuditshëm dhe tiskë i Fatime Sokolit vjen në këngën kushtuar vetë asaj si një zbukurim rimtik dhe me ngjyrime origjinale prej zërit të Arif Dushës, përfshirë mënyrën e të këndurit, mgjyrat e tonit të tij të veçantë që e dallon atë nga këngëtarët tjerë.

Kënga këndohet nga Arifi me shumë mall dhe emocione, më zë të lartë, të plotë, me stil modern epik, i bazuar tek tradita e këngës Tropojane, origjina e Eposit tonë Historik dhe Legjendar.

Teskti i Ibrahim Dautit është një rrëfim epik, i thjeshtë dhe më hapsirë kozmike, i ngjashëm më këngët Mujit e të Halilit ku shpesh në rastet kur luftojnë heronjtë apo kur zoti dërgon tek njerëzit paralajmërime të mëdha dielli dhe hana marrin pjesë në ngjajrje , apo edhe janë përsoanzhe.

Teksti i këngës fillon me mitin e lindjes së Fatime Sokolit, apo siç i therrisnin në Malsi të Gjajkovës Fatime Manja , (në emër të babës), ku në momentin e lindjes së saj edhe dielli edhe Hana, si në pak raste njëkohësisht, lëshojnë më shumë dritë për të paralajmëruar ardhjen në jetë të një vazjë të vogël, apo "Të një çike nga Dragobia", por të një talenti që do të shkëlqente në skenat e Shqipërisë dhe të botës.

Diell e hanë , o po lëshojnë dritë
N'Dragobi, o kur leu kjo çikë
Ku fryn flladi, o në atë grykë mali
Emri i saj Fatime Mani.

Pra gjithë kënga e interpretuar me mjeshtri të lartë nga Arif Dushaj është e një stili karakteristik epik.Fatime Sokoli lindi në Dragobi të Malsisë së Gjakovës, më 18 qershor 1948. Ajo u nda nga para kohe nga jeta dhe në kulmin e karrierës së saj, më 12 gusht të vitit 1987, në moshën 39 vjecare, pas një sëmundje të rëndë, duke lënë një boshllëk në muzikën tonë kombëtare. Ajo do të ishte sot në moshën 76 vjeçare.

Dua të sqaroj në këtë shënim të thjeshtë se Fatime Sokoli, para se të dilte në audiencën e madhe, këndoi si një vajzë e vogël kur ruante bagëtitë më malet e Dragobisë apo edhe nga pasioni duke patur një auditor epik malesh, legjendash dhe mitesh siç janë Alpet shqiptare.

Për herë të parë ajo doli para publikut në një përvjetor të rënjës së Bajram Currit tek shpella e tij në Dragobi, duke mahnitur të pranishmit, me talentin e saj. Ajo theu të gjitha tabutë dhe rekordet si njëri dhe si artiste. Ishte femra e parë në Malsi që doli në një koncert publik, që këndoi në një odë burrash e veshur me rroba kombëtare, që përdori çiftelinë, një instrument që deri atëherë përdorej vetëm nga burrat, ajo ishte e para nga femrat që këndoi këngët e trimërisë, baladat epike, të Bajram Currit, Azem e shotë Galicës, Boletinit, Hasan Prishtinës dhe heronjve të tjerë si Mic Sokoli etj. Ajo ishte e para nga vazjat e Tropojës që kreu shkollën e muzikës në Tiranë. Ajo u kthye në vendlindje ku dha mësim dhe përgatiti me passion dhe dashuri shumë talente te tjerë që më vonë do të bëheshin këngëtarë të nivelit kombëtar.

Në një moment pikëllimi poeti, autori i tekstit, si në epikën tonë apo folklorin shqiptar në tërësi lutet që vorri ta lëshojë dhe ajo të vijë përsëri tek në në botën tonë për të kënduar, duke shënuar një moment plot dhimbje për bijën e Tropojës.

Lëshoe moj tokë të dalë prej vorri
T'këndojë edhe njëherë Fatime Sokoli
Me atë za si zog bylbili
Aromë lulesh, o more tradafili, o hej.

Fatime sokoli vertët nuk mund të vijë ma fizikisht mes nesh , por ajo ka lënë një trashëgimi të pazakontë, të rëndësishme muzikore për studiuesit e muzikës por edhe për artistët e ardhshëm.Pa kontributin e Fatime Sokolit muzika e Tropojës nuk do të ishte kjo që është tani me shumë yje, me shumë talente, me shumë idivid-

Vijon nga faqja 31

KRYETARI DR. MUJË BUÇPAPAJ

BORDI EDITORIAL NDËRKOMBËTAR I GAZETËS NACIONAL

I JEPET HISTORIANIT LUAN PERZHITA ÇMIMIN E HISTORIANIT TË VITIT 2023, PËR LIBRIN "FORTESAT E DRINIT NË SHEKUJT IV-VI"

Me motivacion: "Për pasqyrimin shkëncor të fortesave të kulturës ilire në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut në shekujt IV–VI, duke plotësuar një boshllëk në literaturën arkeologjike shqiptare dhe ballkanike"

Të rëndësishme të historisë ballkanike të zhvillimeve dhe transformimeve në prag të dyndjeve barbare, që plotëson një boshllëk në literaturën arkeologjike për qendrat arkeologjike të antikitetit të vonë, veçanërisht për transformimin urban të provincës së Dardanisë gjatë shekujve IV–VI

Arkeologu i shquar prof. Dr. Luan Përzhita boton librin "Fortesat e Drinit në shekujt IV–VI" , pas 40 vjetësh punë kërkimore

libri përmban një punë mbi 40-vjeçare kërkimore-shkencore në terren dhe biblioteka shkencore në Evropë

Mendojmë se përmes këtij studimi kemi sjellë para lexuesit për herë të parë në mënyrë të përmbledhur një panoramë të sistemeve fortifikuese të shekujve IV–VI në pellgun e Drinave. Po ashtu, analiza mbi kronologjinë dhe dinamikën e fazave të ndërtimit të fortifikimeve, si dhe roli i tyre mbrojtës në relacion me rrugën Lissus – Naissus kontribuon në sqarimin e transformimeve urbanistike, ekonomike dhe kulturore që ka njohur ky territor ballkanik gjatë kësaj periudhe.

Nisur nga materiali i paraqitur shpresojmë se ky botim që u kushtohet "Fortesave të Drinit në shekujt IV–VI " që për vetë tematikën e studimit lidhet dhe gërshetohet me aspekte të rëndësishme të historisë ballkanike të zhvillimeve dhe transformimeve në prag të dyndjeve barbare, të shërbejë për studiuesit e fushës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Si i lidhnin Luginat e Drinit provincat e Iliricumit të Epirit të Ri, Maqedonisë II, Dardanisë, Prevalitanisë etj

-"Është plotësuar për herë të parë sistemi fortifikues i Drinit të Bardhë, një areal që historikisht kishte luajtur rol primar në qarkullimin e mallrave dhe kulturave nga bregdeti Adriatik në Ballkanin Qendror, nëpërmjet Rrugës Lissus – Naissus.

i gjithë sistemi fortifikues ndërtuar në pellgun e Drinave ka qenë i realizuar nga 51 fortesa të shekujve III–IV dhe VI.

Siç u paraqit, libri përmban një punë mbi 30-vjeçare kërkimore-shkencore në terren dhe biblioteka shkencore në Evropë dhe prezanton fortesat të lumin Drin në tre kapituj."

- "Duke analizuar kontekstin e ndërtimit, fazat e zhvillimit kronologjik, fizionominë dhe karakterin e tyre, është krijuar një panoramë e përgjithshme që plotëson një boshllëk në literaturën arkeologjike për qendrat arkeologjike të antikitetit të vonë, veçanërisht për transformimin urban të provincës së Dardanisë gjatë shekujve IV–VI."

BORDI EDITORIAL NDËRKOMBËTAR I GAZETËS

NACIONAL

I jep Luan Përzhitës

Çmimin e historianit të vitit 2023, për librin "Fortesat e Drinit në shekujt IV–VI", me motivacion:

" Për pasqyrimin shkëncor të fortesave të kulturës ilire në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut në shekujt IV-VI, duke plotësuar një boshllëk në literaturën arkeologjike shqiptare dhe ballkanike, me dëshmi të rëndësishme shkencore për periudhën e transformimeve në prag të dyndjeve barbare".

Tiranë, më 23 Dhjetor 2023

KRYETARI
DR. MUJË BUÇPAPAJ

Nisur nga materiali i analizuar rezulton se në pellgun e Drinit të Zi janë ndërtuar 22 fortesa; në Drinin e Bardhë 19 fortesa; ndërsa në Drinin e Bashkuar 10 fortesa. Pra



Libri "Fortesat e Drinit në shekujt IV–VI"
Nga Prof. Dr. Luan Përzhita

Libri "Fortesat e Drinit në shekujt IV–VI" pasqyron një ndër periudhat më të rëndësishme të fillimit të ndryshimeve të mëdha politike, ekonomike, administrative dhe etnike në provincat e Iliricumit. Luginat e Drinit kanë lidhur historikisht provincat e Iliricumit të Epirit të Ri, Maqedonisë II, Dardanisë, Prevalitanisë etj. Hapësira kohore midis shekujve IV–VI është një periudhë e rëndësishme e jetës dhe veprimtarisë së popullsisë ilire në Ballkan, gjë që është dokumentuar në shumë burime historike të kohës, si dhe nga ndërtime në një sërë monumentesh ku bëjnë pjesë dhe fortesat e kësaj kohe. Gjatë këtyre shekujve morën rrugë proceset e kalimit, formimit dhe zhvillimit të kulturës paleobizantine të popullsisë ilire, të cilat u reflektuan në ndërtimet urbane, transport, ekonomi etj.

Përpjekjet për të pasqyruar në aspektin arkeologjik dhe historik të procesit të sistemeve fortifikuese në rajonin e lumit Drin, i cili aktualisht shtrihet në territorin e Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë, kanë filluar pas viteve '70 të shekullit të kaluar. Këtu mund të përmendim botimet e disa kështjellave që vijnë si rezultat i kërkimeve përnjohëse në terren gjatë kohës së ndërtimit të kaskadave mbi lumin Drin në zonën e Kukësit, Dibrës dhe Pukës.

Gërmimet arkeologjike sistematike në drejtim të njohjes dhe evidentimit të fortesave në luginën e Drinit kanë filluar nga autori i këtij punimi në vitin 1983 me kështjellën e Bushatit (Kukës) dhe vazhduan pa ndërprerje gjatë viteve 1983–1991, përgjatë luginës së Drinit të Bardhë dhe të Zi, në kështjella të tjera, nga të cilat mund të veçojmë Qytezën e Pecës, Bardhocit, Domaj etj. Këto rezultate u publikuan nga autori i librit në punimin e doktoraturës "Fortifikimet e antikitetit të vonë dhe mesjetës në pellgun e dyfishtë të Drinave" në vitin 1991.

Në vijim të punës kërkimore për fortifikime të kësaj periudhe, në vitin 1999 kemi kryer disa ekspedita përnjohëse në pellgun e Drinit të Zi, ku u dokumentuan 12 fortesa të shekujve III–IV dhe VI, të cilat plotësuan kështu panoramën e sistemit fortifikues në këtë areal.

Gërmimet arkeologjike sistematike kanë filluar në vitin 2000 në fortifikimin më të madh të pellgut të Drinit të Zi, në Grazhdan (Peshkopi). Gjatë një periudhe 10-vjeçare tashmë kemi një situatë shumë të qartë të kronologjisë dhe arkitekturës së këtij monumenti që është me sipërfaqe 34 ha, fortifikuar me 44 kulla tipash të ndryshme dhe 3 porta madhështore, një ndërtim i fillimit të shekullit IV.

Gjatë këtyre viteve kemi organizuar disa ekspedita përnjohëse në pjesën e luginës së Drinit të Zi nga Struga e deri në Dibër të Madhe. Po ashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar sistemit të fortifikimeve në pellgun e liqenit të Ohrit.

Gjatë viteve 2000–2005, në kuadrin e projektit arkeologjik "Harta arkeologjike e Kosovës" gjurmimet arkeologjike u fokusuan edhe në fortesat e shekujve IV–VI, të cilat u plotësuan me dokumentacionin përkatës, planimetri, fotografi etj. Në disa raste janë kryer dhe sondazhe, si në Korishë, Prizren etj. Kështu u plotësua për herë të parë sistemi fortifikues i Drinit të Bardhë, një areal që historikisht kishte luajtur rol primar në qarkullimin e mallrave dhe kulturave nga bregdeti Adriatik në Ballkanin Qendror, nëpërmjet Rrugës Lissus – Naissus.

Nisur nga materiali i analizuar rezulton se në pellgun e Drinit të Zi janë ndërtuar 22 fortesa; në Drinin e Bardhë 19 fortesa; ndërsa në Drinin e Bashkuar 10 fortesa. Pra i gjithë sistemi fortifikues ndërtuar në pellgun e Drinave ka qenë i realizuar nga 51 fortesa të shekujve III–IV dhe VI.

Siç u paraqit, libri përmban një punë mbi 30-vjeçare kërkimore-shkencore në terren dhe biblioteka shkencore në Evropë dhe prezanton fortesat të lumin Drin në tre kapituj.

Në kapitullin e parë "Fortesat e Drinit të Zi" një vend me rëndësi u lidhjeve tregtare, ushtarake dhe administrative që realizoheshin në arealin ku kryqëzoheshin rrugët e rëndësishme ndërmjet Detit Adriatik dhe pellgut të Danubit, ndërmjet provincës së Macedonia Secunda, Epirus Novo dhe Dardania. Studimi nxjerr në pah se pellgu i Drinit të Zi shërbeu si një nyjë e rëndësishme dhe strategjike jo vetëm ushtarake, por edhe kulturore e tregtare në kuadrin e rrugës transversale ndërmjet Via Lissus – Naissus dhe Via Egnatia. Rajoni Ohër – Dibër – Kukës, në aspektin urbanistik është vendosur ndërmjet dy qyteteve të mëdha Lyhnidos (Ohër) dhe Deyfrakos (Grazhdan – Peshkopi), qendra të cilat në periudhën e

Vijon nga faqja 18

Vijon nga faqja 17

antikitetit të vonë, pra në shekujt IV–VI luajtën një rol parësor në përhapjen e krishterimit, në tregti dhe në aspektin ushtarak. Një sistem i përkryer ushtarak u ndërtua përgjatë kësaj lugine përfaqësuar nga një numër qytezash, kështjellash etj., si në pllajën e liqenit të Ohrit, ashtu dhe në arealin Peshkopi – Kukës. Fortesat e këtij rajoni nisur nga analiza e teknikës së ndërtimit, si dhe nga materiali arkeologjik ishin ndërtime që të shtrira në kohë nga shekulli III–IV dhe shekulli VI, në funksion të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së rrugëkalimeve, por edhe të zonave për rreth tyre.

Në kuadër të kapitullit të dytë "Fortesat e Drinit të Bardhë" për herë të parë kemi një panoramë të qartë të sistemit mbrojtës në këtë luginë, të përbërë nga fortifikime që janë ndërtuar në periudhën e mbizotërimit romak dhe më pas në periudhën e perandorit Justinian. Qëllimi i krijimit të këtij sistemi fortifikues tregon rëndësinë që kishte lugina e Drinit të Bardhë, një areal që historikisht lidhte Ballkanin Qendror me Bregdetin Adriatik. Duke analizuar kontekstin e ndërtimit, fazat e zhvillimit kronologjik, fizionominë dhe karakterin e tyre, është krijuar një panoramë e përgjithshme që plotëson një boshllëk në literaturën arkeologjike për qendrat arkeologjike të antikitetit të vonë, veçanërisht për transformimin urban të provincës së Dardanisë gjatë shekujve IV–VI.

"Fortesat e Drinit të bashkuar" në aspektin administrativ të kohës integrohen me provincën e Prevalitanës, ndonëse një pjesë e tyre janë në kufirin ndërmjet provincës së Dardanisë dhe asaj të Prevalitanës. Si rezultat i ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin Drin, në Fierzë, Koman dhe Vaun e Dejës të dhënat mbi gjurmët e fortifikimeve janë zhdukur. Informacioni që kemi në dispozicion vjen nga ekspeditat përnjohëse që janë bërë gjatë viteve 1970, si dhe nga udhëtarët e huaj që kanë vizituar këto zona gjatë shekujve të kaluar. Falë gërmimeve arkeologjike të realizuara në castrum-in e Vigut (Shkodër), qytezën e Rosojës (Tropojë), si dhe ekspeditave përnjohëse në Shëmri (Kukës) etj. është arritur të paraqitet një panoramë e përgjithshme e këtij sistemi fortifikues në luginën e Drinit të bashkuar, që mendojmë se kontribuon në njohjen e këtyre krahinave gjatë shekujve III–IV dhe VI.

Gjurmimet e deritanishme në pellgjet e Drinit, zonë e cila përfshin pjesët perëndimore të dy provincave, asaj të Maqedonisë dhe të Dardanisë, si dhe pjesët qendrore të provincës së Prevalitanës, ndonëse janë tregues për një veprimtari të gjerë ndërtimore, dëshmojnë se tashmë është krijuar një tablo e qartë dhe e detajuar mbi zhvillimin e fortifikimeve gjatë shekujve IV–VI. Të dhënat mbi fortesat e Drinit, sistemet fortifikuese, tipologjinë e tyre, aspektin kronologjik dhe arkitektonik, si dhe të dhëna arkeologjike, herë-herë gërshetohen me të dhëna nga burimet historike të kohës, duke sjellë risi të dukshme në analizën e monumenteve.

Mendojmë se përmes këtij studimi kemi sjellë para lexuesit për herë të parë në mënyrë të përmbledhur një panoramë të sistemeve fortifikuese të shekujve IV–VI në pellgun e Drinave. Po ashtu, analiza mbi kronologjinë dhe dinamikën e fazave të ndërtimit të fortifikimeve, si dhe roli i tyre mbrojtës në relacion me rrugën Lissus – Naissus kontribuon në sqarimin e transformimeve urbanistike, ekonomike dhe kulturore që ka njohur ky territor ballkanik gjatë kësaj periudhe.

Nisur nga materiali i paraqitur shpresojmë se ky botim që u kushtohet "Fortesave të Drinit në shekujt IV–VI " që për vetë tematikën e studimit lidhet dhe gërshetohet me aspekte të rëndësishme të historisë ballkanike të zhvillimeve dhe transformimeve në prag të dyndjeve barbare, të shërbejë për studiuesit e fushës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

EDHE NJË HERË PËR JURITË LETRARE

Nga Rudolf Marku



1.

Gjatë vitit që sapo kaloi, bota jonë letrare u ballafaqua përsëri me këmbënguljen arrogante të vendimeve të dy Jurive Kombëtare për botimet letrare- atë të Jurisë për veprat më të mira të Panairit Vjetor të Librit, dhe të Jurisë për Çmimet Letrare për veprat e botuara gjayë vitit 2023.

Le ta fillojmë me një fakt që tingëllon si një anekdotë, por që është e vertetë, sepse të vertetat tek ne janë, për fat të keq, gjithnjë anekdotike.

Një personalitet shtetëror, por që është njëkohësisht romancjer dhe poet i talentuar, shkruan kështu në murin e Fb të tij (për etikë, nuk po ia përmend emërin, por lexuesi kurrështar mund të njihet me identitetet përkatëse përmes murit të Fb tim):

DIALOG BIO ...

E solli fati të pyes një antar jurie të këtij viti:

- E lexove këtë vepër, po këtë tjetrën, po këtë, po ...?

- Jo, nuk i lexova, - ma ktheu me sytë e skuqur prej shqarthi.

-Po kryetari i jurisë deklaroi se juria bëri punë titanike, lexoi, analizoi e ballafaqoi estetikisht qindra vepra, më duket 850 me ISBN.

-Pallavra. Turpërim pleqërie ...!

- Po ti firmose ... si firmose ti?

-Firmosa vetëm për 5 veprat finaliste . Dhe që këto i solli një antare e jurisë.

-Po nga ato lexove ndonjërën?

- Jo, - ma ktheu i bezdisur nga pyetjet. Unë merrem me shkencë, jo me letërsi.

Ky është dialogu i shkruar me një stil telegrafik, reportues, pa komente dhe qëndrime emocionale. Shkruar me një stil kafkianesk, leximi i të cilit duhej të na sillte rrënqethje. Por jo lexuesit tonë, i cili në fund të fundit ka qënë i përgaditur për këtë standart dialogu.Dhe këtu qëndron dhe tragjedia e vertetë. Që Juritë tona në fakt do të sillnin një të papritur vetëm nëse do të kishin funksionuar normalisht!

Sharlatanizmi i Jurive për krijimtarinë letrare vazhdon më me kembengulje se kurr, tashmë ne nivelet e Ministrisë së Kultures!

Personi që ia bënë këtë rrefim shkruesit- është njëri ndër anëtarët e Jurisë me të fundit të Ministrisë së Kultures, që percaktoi veprat fituese të letersisë per vitin 2023- një militant haxhi-qemalist i LSI, një mesues i gjuhesisê (gjuetisë- do qe më e saktë) në Fakultetin Filologjik, një njeri i purifikuar dhe i virgjer nga moslexim i librave, një dinak skrapali që shtiret kompetent, në kuptimin vlonjat te fjalês, pra një tip teper i përshtatshêm per tê qenë anetar Jurie i veprave letrare dhe artistike!

Asnjëherë tjeter nuk ka ndodhur tek ne që mediokriteti dhe injoranca shtirake të kene qene ne pozita më triumfuese dhe agresive, se sa ne ditet e sotme!

2.

Shumica e veprave që marrin Çmime nga Juritë e Ministrisë së Kulturës janë dhe veprat më mediokre të botuar tek ne. Jo se nuk ekzistojnë veprat mediokre në botë, por në botë mediokriteti botohet veç me kontributet finaciare të vetë autorëve, kurse tek ne janë botuar me sponsorizimet e Ministrisë së Kultures! Nuk është fjala te dëmi financiar, se sa në momentin kur botime të tiila vlerësohen nga Institucioni më i lartë i Shtetit për Kulturën , këto krijime të japin përshtypjen se kanë marrë një farë statusi shtetëror, sepse janë përzgjedhur zyrtarisht si librat më të mirë. Të vjen keq kur sheh ndonjëherë, se dhe vetë Qendra e Kulturës së Librit dhe Leximit- me gjithë kontributin e vet te pamohueshem qe nga krijimi i sajnën njetin e mirë të inkurajimit të disa shkrimtarëve, ka kohë që u jep një vend disproporcionalisht më të gjërë poetëve dhe shkrimtarëve fillestarë amatoresk të soc-medias nga vetë krijimtaria e autorëve të konsoliduar. Është e njëjta mendësi dhe taktikë e taborreve të kritikës keqdashëse dhe sterilizuese snobe: lavdëro mediokritetin dhe nuk ke nevojë të sulmosh vlerat!

Ajo që i mungon Jurive tona është mungesa e shijeve estetike të përzgjedhjeve të vlerave të verteta. Por dhe një keqkuptim i vetë Letersisë nga ana e tyre. Për të mos thënë atë banalitetin ala shqiptar, moslexim e librave për të cilët gjykojnë.

Vlerësimi me Çmime i veprave mediokre sjell automatikisht përçmimin e veprave të mira, të cilat nuk i mungojnë as botimeve të letersisë Shqipe. Është për të ardhur keq kur ndjen një agresivitet të heshtur ndaj librave të mirë të letersisë tonë, të cilat sapo botohen, rrethohen me një izolim hermetik. Aq sa të mos shqyrtohen hiç në librat e botuar të Vitit, duke supozuar se nuk janë botuar! Dhe po qe se kërkon llogari perse aksh liber nuk eshte marrë né shqyrtim a konsideratë, organizatorët e Jurive të japin ca pergjigje burokratike, kinse Botuesi nuk e ka paraqitur librin e munguar në konkurs (ndonese nuk behet fjalë per asnje konkurs!) ose vepra nuk eshte paraqitur në kohé! Mediokrit e shtetit shqiptar, nën mburojen patriotike, thërrasin në ndihmë mediocrit e shtetit Kosovar, sipas parimit nder kombetar Birds of a feather flock together!

Ajo që është e pabesueshme-në standartin e botimeve në vendet e tjera të botës së qytetëruar,- është se armiqësia ndaj librave të mirë të botuar, fillon nga Minsitria e Kulturës. Vetëm në një vend si Shqipëria mund të dëgjosh Ministrin/ Ministreshen e Kulturës, tek thotë më një ndjesi shfajësimi '' ...mos prisni që të jap gjykim për librat, sepse libri nuk është fusha ime' ' Nëse Ministrja e ka fjalën për faktin se profesioni i saj është arkitekte, a mund t'ia kujtojmë asaj se Çehovi, William Carlos Williams, Bulgakovi kanë qënë mjek, dhe se Dostojevskin,Tolstojn, Shekspirin, Naim Frashërin, Asdrenin, De Raden, Kadarenë nuk i lexojne vetëm mësueusit e letersisë?

Dhe janë po anëtarët e Jurive po këta ''kritikë' që ekzaltohen nga leximi i një poezie mesatare a nën mesatare të përkthyer keq, mjafton që autori i saj të mos jetë shqiptar.Po t'u besosh vlerësimeve të tyre për veprat më të mira të letersisë Shqipe, vlerësime pretencioze akademikisht, letersia Shqipe do të dilte një peisazh i varfër botanik veç me dy a tre pemë dhe ca shkurre përreth. Letersia Shqipe, prej këtyre lloj Jurive, jo vetëm zvoglohet, por sakatohet dhe fallsifikohet në mënyrë të turpshme. Aq sa, asnje dashakeq i vlerave të letersisë Shqipe nuk do t'u bëntë një shërbim më të mirë dhe më efektshëm cinikëve dhe të liqve që duan denigrimin e kulturës tonë, sa ç'u bëjnë vetë të përzgjedhurit e Jurive, ngritur nga Ministria e Kultures të shtetit shqiptar, dhe nga Sejmenët e saj.

AKDAMIK VALTER MEMISHA NJË PERSONALITET I SHQUAR I GJUHËSISË SHQIPTARE

Nga Feti ZENELI

Të shkruash për Akademik Valter Memishën nuk është e lehtë. Jo se nuk ke material apo të dhëna për të. Ato janë tejet të bollshme, ku vetëm "CV"-ja e përmbledhur e tij shkon në rreth 20 faqe format "A4". Vështirësia qëndron te koncentrimi i gjithë kësaj veprimtarie për t'i bërë, si me thënë, portretin e duhur këtij shkencëtari të fjalës shqipe e të gjuhës. Je pak a shumë në atë situatë për të cilën Markez thotë: "të shkruash një tregim është shumë më e vështirë se të shkruash një roman". Në një situatë të tillë më vendos dhe mua ky shkrim modest për një personalitet të shkencës gjuhësore. Kam qysh nga 6 shkurti i këtij viti, kur kryesia e Akademisë së Shkencave e votoi Prof. Dr. Valter Memishën si Akademik për shkencën e gjuhësisë, që jetoj me idenë e një shkrimi dinjitoz për të. Qëllimi është që ta bëjë po aq të njohur për publikun e gjerë shqiptar, sa çështë edhe në rrethet akademike e katedrat universitare; pra në të gjithë botën shkencore brenda e jashtë vendit. Pastaj, familjarizimi i shqiptarëve dhe njerëzve të thjeshtë në përgjithësi, me termin "shkencëtar gjuhe", është pak më i vështirë se sa me shkencëtarët e fushave të tjera.

Tani për tani, autoriteti më i spikatur në këtë fushë të shkencës shqiptare është akademik Eqrem Çabej. Pra, ai është i pari i fisit të albanologëve tanë më në zë, të cilët mund t'i quajmë me një emër të përgjigjshëm - të "i Çabeje". Në atë kuptim që, përgjithësisht, zona e Labërisë e përdor në të folurën e përditshme për të treguar për përkatësinë familjare të dikujt, që emërtohet nga mbiemri i tij. (Fjala vjen, po qe se mbiemrin e ke "Shehu", të thonë "i Shehe").

Valteri e njeh shumë mirë këtë gjuhë. Atë, sa mbaroi fakultetin me rezultate të shkëlqyera, e emërojnë mësues në një nga fshatrat labe të Tepelenës. Ai në pak kohë arriti të njoh nga afër jo vetëm gjuhën e njerëzve, por dhe atë "të kafshëve dhe shpendëve" të asaj zone, sepse punoi për të mbledhur pasurinë dialektologjike, por sidomos atë leksikore të zonës ku punoi dhe më gjerë. Madje ka botuar një fjalor me emërtime për kafshë e shpendë në Labëri me 6500 fjalë dhe 1500 njësi frazeologjike, për të cilin ka punuar plot 10 vjet, duke i mbledhur ato si lule manushaqe, drejtpërdrejtë nga terreni. Më vonë do të jetë Akademia e Shkencave të Austrisë, që, në një projekt kërkimi për terminologjinë e jetës baritore në Ballkan, e merr përsipër për ta botuar këtë vepër interesante.

Valteri, me modestinë e tepëruar që e karakterizon, vazhdon ta konsiderojë veten ende "nxënës" të fisit të madh të shkencëtarëve të gjuhës shqipe, ndonëse qysh nga shkurti i këtij viti mban titullin "Akademik", njëlloj si Eqrem Çabej, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Androkli Kostallari, Jani Thomai, Ethem Lika, Gjovalin Shkurtaj, etj. Madje të njëjtin vlerësim i bën vetes edhe në raport, për shembull, me prof. dr. Miço Samara, me prof. Hajri Shehu, etj. Nuk kam ndërmend, dhe as zotësinë e mjaftueshme, të bëjë hierarkinë e këtij korpusi shkencëtarësh të fjalës e të gjuhës shqipe, por me këto pak radhë do përpiqem të evidentoj sa të mundem për publikun e gjerë, dimensionet intelektuale dhe ato shkencore të Akademik Valter Memisha, i cili mban një profil të tërhequr mediatik, siç ndodh në përgjithësi, me njerëzit zelltarë e të përkushtuar.

Gjuha është një fushë e gjerë studimesh, që ashtu si çdo aspekt tjetër i jetës dhe veprimtarisë njerëzore, ka hapësira të pafundme për të kërkuar dhe eksploruar. Ndaj profilizimi në sektor të ngushtë kërkimesh është një kusht për të qenë eficient dhe i suksesshëm. Profilizimi arrihet me studime dhe specializime pasuniversitare. Dhe këtë rrugëtim Valteri e nisi qysh në vitin 1984, jo më shumë se 5 vite pasi kish mbaruar universitetin dhe punonte si mësues në shkollat e mesme të rrethit Tepelenë. Tre vite pas këtij specializimi në gjuhësinë shkencore kalon pedagog në Departamentin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër. Punësimi në këtë institucion të lartë arsimor, përbënte për të, një mundësi më shumë dhe një hap më afër punës shkencore. Ndërkohë kryen dhe dy specializime të shkurtra jashtë shtetit, fillimisht në Universitetin "Aristotelis" të Greqisë dhe më pas në Universitetin e Barit në Itali. Në qershor të vitit 2001, pasi përfundoi këtë specializimin e fundit, vetëm pas 5 muajsh, saktësisht në 16 dhjetor, emërohet punonjës shkencor në Departamentin e Leksikologjisë dhe Terminologjisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Akademinë e Shkencave. Pas 7 vitesh punë të suksesshme në këtë institucion të lartë shkencor, në mars të 2008-ës, kalon tek Qendra e Studimeve Albanologjike. Ka rreth 15 vjet, që punon e kërkon në këtë fushë. Aktualisht mban edhe detyrën e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Puna dhe kërkimi shkencor në një anë, mësimdhënia akademike në krahun tjetër, janë dy fusha ku identifikohet profili i këtij gjuhëtari. Janë me fat ata studentë apo specializantë që marrin leksione dhe testojnë përfitimin e njohurive te profesor Valteri. Dhe këtë fat për 15 vjet, duke filluar nga 2001-shi, e kanë pasur pothuajse një numë jo i vogël i studentëve shqiptarë të degës së gjuhësisë, duke filluar nga ata të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë apo të Gjuhëve të Huaja në Tiranë, të Universitetit të Gjirokastrës, ku Valteri e nisi këtë karrierë. Gjithashtu për shumë vjet jep mësim në Universitetin e Vlorës, të Elbasanit apo në Shkup. Ndërsa nga 2010-a e në vazhdim është pedagog e drejtues i Shkollës së Doktoraturës në Gjuhësi. Ai deri tani ka udhëhequr rreth 20 teza doktoraturash në fushën e Leksikologjisë, të Semantikës dhe të Leksikografisë dhe mbi 50 mastera shkencorë. Këto fusha, si dhe pjesëmarrja në grupet hartuese të fjalorëve shpjegues kombëtarë të shqipes dhe atyre specialë, përbëjnë njëkohësisht dhe profesionalizimin apo specializimin e ngushtë, ku është përqendruar dhe veprimtaria e tij shkencore.

Gjurmën e parë të veprimtarisë së mirëfilltë shkencore, Valteri e ka hedhur 40 e ca vite më parë, në mars të vitit 1982, teksa në sesionin shkencor me rastin e ngritjes së bërthamës gjuhësore në Tepelenë, referon temën: "Rreth shtresës së fjalëve që lidhen me emërtimet e njerëzve sipas tipareve fizike e morale". Do referojë dhe 4-5 tema të tilla në Tepelenë e Gjirokastër, për të mbërritur tek ajo "më emocionuesja", siç na tha këto ditë Akademik Valter Memisha. Ishte dhjetor i vitit 1994. Në Gjirokastër zhvillohej sesioni shkencor, kushtuar figurave të shquara të këtij qyteti. Në këtë sesion, Valteri mban kumtesën "Eqrem Çabej - personalitet i jashtëzakonshëm i albanologjisë". Të njëjtën gjë bën në sesionet shkencore të radhës, mbajtur në qytetin e gurtë, për Ismail Kadarenë, Hasan Sazanin, Jorgo Bulon, Andon Zako Çajupin, etj. Por nëse i marrim me radhë këto kumtesa kombëtare të veprimtarisë shkencore, vëmë re se janë me dhjetëra të tilla, të shpërndara në të gjithë universitet e vendit tonë. Janë gjithashtu edhe me dhjetëra kumtesa ndërkombëtare brenda vendit, apo ato ndërkombëtare jashtë vendit, që u përkasin veprimtarive shkencore të kësaj natyre. E gjithë kjo veprimtari përfshin mbi gjithsej mbi 165 kumtime shkencore

Por aktivitete të tilla, sado të shumta në numër qofshin, përsëri nuk tregojnë shumë për punën e vërtetë shkencore të bërë nga "x" apo "y" studiues, aq më pak për Akademik Valterin. Ndryshe qëndron çështja me

artikujt shkencorë, brenda dhe jashtë vendit. Nëpërmjet tyre ballafaqohesh me botën akademike, jo më me të folurit, por me të shkruarit. Jo se përgjegjësia e profesionistëve nuk është njëlloj para publikut dhe kolegëve në të dy rastet. Problemi lidhet me faktin, se s'kemi të bëjmë, thjeshtë, me një ndryshim në aspektin e formës apo formulimit, por në atë të përmbajtjes dhe thellimit. Edhe në këtë aspekt, Valteri, fjala vjen vetëm nga periudha kur u bë profesor doktor e deria sa u bë akademik ka botuar mbi 110 artikuj shkencorë brenda e jashtë vendit, trajtuar të gjithë me profesionalizëm e kompetencë shkencore.

Sidoqoftë, gjithçka përmendëm në këtë drejtim, si dhe organizmi e bashkorganizimi prej tij i 12 konferencave ndërkombëtare kombëtare, janë dëshmi aftësie dhe kompetence në këtë fushë të shkencës, por nuk tregojnë përfundimisht gjithë personalitetin shkencor të Akademik Valterit, apo të çdokujt tjetër që ka bërë vend në këto nivele të larta të shkencës gjuhësore.

Ndryshe qëndron puna me veprat shkencore të punuara e të publikuara. Ato janë shkencë safi, janë jo vetëm sasi faqesh e veprash, por dhe cilësi e tregues e formimit të tij shkencor. Vepra të tilla, po aq sa autorit i përkasin vendit dhe gjithë popullit, sepse, në një farë kuptimi, janë e klasifikohen si pasuri e madhe kombëtare. Janë frytet e një pune disavjeçare në terrenin e kombit shqiptar këtu e në Kosovë, ku Valteri ka marrë pjesë në dhjetëra ekspedita gjuhësore për të mbledhur pasuri leksikore, frazeologjike e semantike, etnolinguistike, dialektologjike, etj. Paralelisht në kohë, dhe me të njëjtin përkushtim, është marrë e vazhdon të merret edhe me vjeljen leksikore nga letërsia artistike, nga publicistika, veprat politiko-shoqërore dhe ato tekniko-shkencore, etj. Janë punë me themel të një njeriu që nuk humbet asnjë sekondë kohë të jetës së tij, duke u endur jashtë fushës së veprimtarisë shkencore. Por janë gjithashtu edhe punë, të cilat nuk përballohen vetëm, qofsh dhe gjeni, sidomos në disa vepra që janë shtylla të gjuhës, për rrjedhojë dhe të kombit. Fjalorët e gjuhës shqipe janë vepra të kësaj natyre. Po edhe këtu, Valteri mban peshë e poste të rëndësishme. Marrim një nga këto vepra, që është "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" me 120 mijë fjalë e njësi frazeologjike (me 8 mijë deri në 9 mijë faqe), hartimi i të cilit përfundon në vitin 2024. Në këtë projekt gjigant mbarëkombëtar, ai është bashkëdrejtues, zëvendëskryeredaktor, redaktor, hartues dhe sekretar shkencor. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës, me 48 mijë fjalë e 5 mijë njësi frazeologjike, ku përveçse hartues për 12 shkronja të alfabetit, ka qenë redaktor letrar i gjithë veprës, korrektor dhe formatues i saj. Po kështu dhe me "Fjalorin e vogël të gjuhës shqipe" 2020, (me 35 mijë fjalë e 3 njësi frazeologjike), ku së bashku me Akademik Jani Thomai (një nga akademikët më të shquar të ditëve të sotme) dhe pesë punonjës të tjerë shkencorë të nivelit "Profesor Doktor", Valteri, përveçse hartues fjalësh e njësish frazeologjike për 9 shkronja të alfabetit, është përsëri dhe redaktor letrar, korrektor dhe formatues i veprës. Ndalemi tek një vepër tjetër, po me kaq rëndësi shkencore, siç është Fjalori i madh frazeologjik i shqipes me 35 mijë njësi, ku Akademik Valter Memisha është bashkautor me Akademik Jani Thomain dhe Prof. Dr. Ali Jasharin. Ashtu si Fjalori i madh i Gjuhës shqipe edhe kjo vepër janë drejt përfundimit dhe gjatë vitit 2024 do të jenë gati të përdoren.

Një grup tjetër veprash studimore të fushës së gjuhësisë janë dhe ato, që Valteri i cilëson si "Veprimtari botuese vetjake". Këto fillojnë me monografinë prej gati 300 faqe të vitit 1999, të titulluar: "Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe". Në korpusin e veprave të botuar prej tij, që deri tani janë 13 të tilla (përveç punës së hartues në fjalorët kombëtarë të përmendur më lart) përfshihen dhe "Studime për fjalën shqipe" me 8 vëllime, "Leximi leksikografik i veprës 'Shkolla e partisë' e Daut Gumenit", teksti universitar "Ushtrime për leksologji e semantikë leksikore", vepra "Emërtimet e shkurtuara në gjuhën shqipe" me bashkautor, etj.

Ai gjithashtu, po punon personalisht në një sërë veprash të tilla, si fjala vjen, "Fjalor i veprës së Martin Camajt (i parashikuar me 4 vëllime), "Fjalor i leksikut dituror në veprën e Branko Merxhanit" (diku tek 650 faqe), "Fjalor i frazeologjisë së Gjergj Fishtës" (me gati 700 faqe), etj. Paralelisht me to po përgatit edhe "Fjalor i veprës së Ismail Kadaresë", që është një vepër sa e rëndësishme, po aq dhe voluminoze.

Mund të vazhdonim të tregonim ende për punë e vepra të tjera shkencore të Akademik Valter Memishës, ndërkohë që ai është në kulmin e veprimtarisë dhe krijimtarisë së tij; plotë energji dhe me informacion të grumbulluar në mijëra skeda. Dhe siç na pohoi vetë, për ta kthyer në vepra shkencore, informacionin e deritanishëm, do t'i dukeshin, të paktën 10 vite kohë, i paangazhuar me punë e veprimtari të tjera. Duke përjashtuar kohën e punës zyrtare, çdo ditë kësaj veprimtarie i kushton edhe 8 orë të tjera. Sidoqoftë, kurrë nuk jeton me frikën se s'mund t'ja dalë. Sepse gjithçka e planifikon mbi tregues e fuqi reale, dhe punon me merakun për të lënë sa më pak hapësira për vepra të papërfunduara. Hedh themele të forta për çdo vepër gjuhësore që ngre. Mjetet e punës që përdor janë argumente kokëfortë, arsyetimi logjik dhe ekspertiza shteruese. Ka një këmbëngulje dhe durim sizifian në çdo punë të nisur. Dhe mbi të gjithë ka një moshë akademike të re. Ndaj, me siguri, që e ardhmja e Akademik Valter Memishës do të na rezervojë prurje të reja shkencore, të rëndësishme e të vlerësuara në këtë fushë.

Për shqiptarët në rajon, anëtarësimi në BE është çështje e interesit kombëtar

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE KOSOVË- SERBI, NJË ÇËSHTJE POLITIKE, NJË ÇËSHTJE SIGURIE PËR RAJONIN DHE TË EUROPËN

"Për ambasadorët e vendeve të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën, dua të ripërsëris kërkesën ta njohin Republikën e Kosovës si një realitet të pakthyeshëm."

Nga Bajram BEGAJ
President i Republikës

Për mua ky takim është i një rëndësie të veçantë, sepse është mundësi e mirë të ndajmë bashkë jo vetëm rezultatet e vitit që shkoi, por edhe sfidat dhe shpresat për vitin që sapo ka filluar.Sfidat dhe shpresat janë sa globale, edhe rajonale, dhe sa më të ndërgjegjshëm të jemi për kompleksitetin e tyre, aq më shumë do të jemi të përgjegjshëm për të gjetur zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme.Po përballemi me kriza dhe kërcënime. Ato janë të shumëllojshme për nga natyra dhe shpesh të ndërthurura ngushtë me njëra-tjetrën.Këto kriza dhe kërcënime gjejnë shprehje në zvarritjen, dhe shpesh në dështimin e dialogut, në sulmin ndaj parimeve demokratike të qeverisjes dhe në krijimin e ligjërimeve dhe veprimeve diametralisht të kundërta.

Agresioni rus ndaj një vendi sovran si Ukraina vazhdon. Populli dhe qeveria ukrainase janë heronjtë e përditshëm të një qëndrese në emër të sovranitetit dhe dinjitetit njërëzor.

Shqipëria e mbështet Ukrainën në luftën e saj për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit.

Sulmi terrorist i Hamasit kundër Izraelit e rindezi konfliktin, duke përkeqësuar situatën e sigurisë në Lindjen e Mesme.

Mbështesim zgjidhjen e konfliktit dhe nisjen e bisedimeve për gjetjen e zgjidhjes me dy shtete, në paqe dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Po ashtu edhe rajoni ynë nuk ka qenë imun ndaj kërcënimit prej krizave reale. Akti terrorist i shtatorit 2023 në Banjskë dhe ngjarje të tjera të ndodhura në Kosovë janë shenja të një status-quo-je të brishtë dhe të një situate që mund të sillte pasoja të rënda për rajonin dhe Europën. Fatmirësisht, nuk pati përshkallëzime.

Mbështetja e BE-së dhe bashkësisë ndërkombëtare për kryerjen e hetimeve të thelluara për identifikimin dhe dënimin e nxitësve dhe të autorëve është e domosdoshme. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve Kosovë-Serbi nuk është vetëm një çështje politike, por edhe një çështje sigurie për rajonin dhe Europën.

Situata në Bosnje-Hercegovinë është delikate dhe kërkon vëmendje, pasi ka ende aktorë politikë, të cilët nuk janë shkëputur nga e kaluara konfliktuale.

Këtyre situatave u shtohen dhe zhvillimet dramatike në vende të tjera. Rreziqet dhe kërcënimet potenciale të lidhura me: ekstremizmin e dhunshëm, emigracionin e paligjshem, kriza ekonomike, kriza ushqimore, kriza energjetike, sfidat e sulmeve kibernetike, kontrollin e inteligjencës artificiale, pasojat e pandemisë dhe ndryshimet klimatike janë çështje që duhen përballuar e për të cilat duhet angazhim dhe zgjidhje.

Përballja me këto sfida dhe kërcënime kërkon të jemi të bashkuar në një aleancë për mbrojtjen e paqes dhe të vlerave demokratike.

Kjo aleancë vlerash duhet të jetë e hapur, jo e mbyllur; përfshirëse, dhe jo përjashtuese, ku diversiteti kulturor, fetar dhe etnik konsiderohet pasuri dhe jo mangësi.

Zonja dhe zotërinj,

vitin e shkuar pata kënaqësinë të vizitoj dhe të pres kryetarë dhe përfaqësues të lartë të shteteve dhe organizatave të ndryshme. Çdo takim ka patur veçantinë e tij, por e përbashkëta e tyre ishte dakordësia për respektimin e vlerave universale.

Vitin e shkuar, Shqipëria dha një kontribut të rëndësishëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në NATO dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Ne do të mbetemi të angazhuar dhe të përkushtuar edhe në ushtrimin e detyrave të tjera, si anëtar i Këshillit të të Drejtave të Njeriut dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s.

Shqipëria do të vijojë të ketë politikë të jashtme dhe të sigurisë të linjëzuara me Bashkimin Evropian dhe SHBA, si dhe do të angazhohet në forcimin e multilateralizmit dhe të bashkëpunimit rajonal.

Shqipëria gjithashtu do të vijojë të japë kontributin për paqe në rajon dhe më gjerë, sepse paqja është themeli i mirëqënies, sigurisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe respektit të ndërsjellë.

Angazhimi ynë në arenën ndërkombëtare do të vijojë paralelisht me të gjitha reformat e filluara në vend, në veçanti me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet publike, si dhe përpjekjet tona për drejtësi sociale.

Thellimi i reformave dhe nxitja e zhvillimit social- ekonomik të vendit është para së gjithash për të mirën e qytetarëve tanë. Këto ndihmojnë gjithashtu edhe në çeljen e kapitujve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si dhe për të konsoliduar besimin e aleatëve dhe të miqve tme në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjej rastin të falënderoj SHBA-në dhe vendet e Bashkimit Europian për bashkëpunimin dhe mbështetjen në ecurinë e procesit të integrimit dhe zhvillimin e reformave të gjithanshme që kemi ndërmarrë për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit në BE.

Ju falënderoj, shkëlqesi ambasadorë dhe përfaqësues të organizatave shumëpalëshe, për ndihmën dhe kontributin e dhënë që Shqipëria të konsolidojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të përballojë sfidat ekonomike dhe sociale!

Falënderim dhe mirënjohje për promovimin e Shqipërisë, vlerave të saj historike, kulturore dhe bukurive natyrore, si dhe për bashkëpunimin e frytshëm në nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta!

Zonja e zotërinj,

vitin e kaluar Shqipëria njohu zhvillime pozitive dhe të suksesshme në disa fusha, ndër të cilat mund të veçojmë turizmin, sportin dhe kulturën.

Jemi krenarë që po shpërblehet mundi dhe puna e çdo shqiptari të ndershëm, punëtor e atdhetar. Kontributi i tyre duhet të jetë frymëzues edhe për klasën politike, e cila ka mundësinë të ushtrojë dialogun politik dhe të bashkëpunojë në funksion të interesit të qytetarëve dhe interesit kombëtar.

Të nderuar shkëlqesi ambasadorë,

Arritjet e vitit të shkuar do të pasurohen nga ngjarje të reja gjatë vitit 2024. Të tillë e quaj 10-vjetorin e Procesit të Berlinit, që shpresoj se do të gjejë një rajon më bashkëpunues dhe më pranë BE-së.

Shpreh bindjen se edhe Bashkimi Evropian do vijojë t'i kushtojë vëmendjen e duhur e të veçantë Ballkanit Perëndimor.

Është me rëndësi që rajoni të mbështetet dhe të krijohen mekanizmat që mundësojnë jo vetëm linjëzim politik, por edhe përparim ekonomik dhe lehtësira për jetën e përditshme të qytetarëve.

Për shqiptarët në rajon, anëtarësimi në BE është çështje e interesit kombëtar. Faktori shqiptar ka kontribuar dhe do të vijojë të kontribuojë për paqen dhe sigurinë e rajonit.

Shqipëria mbështet integritetin dhe sovranitetin e Kosovës, si dhe integrimin e saj Euro-Atlantik. E përshëndes vendimin e BE-së për liberalizimin e vizave me qytetarët e Kosovës!

Për ambasadorët e vendeve të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën, dua të ripërsëris kërkesën ta njohin Republikën e Kosovës si një realitet të pakthyeshëm.

Gjej rastin të ritheksoj mbështetjen tonë që dialogu Kosovë -Serbi të jetë i hapur dhe të avancojë, të normalizojë marrëdheniet mes palëve dhe të çojë drejt njohjes reciproke.

Uroj që presidencat belge dhe hungareze të Këshillit të Bashkimit Evropian, si dhe presidenca malteze e OSBE-së, gjatë këtij viti t'i kushtojnë vëmëndjen e duhur rajonit të Ballkanit Perëndimor në funksion të mbizotërimit të frymës së bashkëpunimit dhe të dialogut.

Të nderuar të pranishëm,

Sot bota ka nevojë për më shumë diplomaci, bashkëpunim e dialog. Diplomacia nuk është opsion, është domosdoshmëri që lind nga nevoja për një botë të paqtë e të sigurt.

Unë besoj se paqja, bashkëpunimi dhe shpresa për një të ardhme më të mirë, duhet të jenë lajtmotivet tona gjatë këtij viti.

Me shpresën se paqja, siguria dhe bashkëpunimi do të jenë orientimi i komunitetit botëror në qasjen ndaj sfidave të reja, ju uroj vendeve, popujve dhe organizatave tuaja tuaj, një vit të mbarë e të begatë!

Të bashkëpunojmë intensivisht që sfidat t'i kthejmë në mundësi reale zhvillimi, mirëqenieje dhe solidariteti. Të përkushtohemi për një të ardhme ndryshimesh konkrete e shpresash që bëhen realitet, si mundësi frymëzimi për brezat e rinj.

Mbetem i gatshëm që këtë vit të vijojmë më intensivisht bashkëpunimin për të promovuar mesazhin e paqes, solidaritetit dhe shpresës.

Ju faleminderit!

*FJALA ME RASTIN E PRITJES SË TRUPIT DIPLOMATIK NË SHQIPËRI

Poezia e Bardhyl Maliqit u botua në dhjetra gjuhë të ndryshme, duke u vlerësuar edhe me çmime të rëndësishme letrare

NDAHET NGA JETA POETI DHE STUDIUESI I MIRËNJOHUR, DR. BARDHYL MALIQI, PEDAGOG I FILIALIT UNIVERSITAR TË SARANDËS

Gazeta Nacional dhe Shtepia Botuese Nacional u shprehin ngushëllimet e sinqerta familjes Maliqi, miqve, të afërmëve, kolegëve dhe lexuesve të dr. Bardhyl Maliqit.

Tiranë, 12 janar 2024. Është ndarë sot nga jeta, poeti dhe studiuesi i njohur sarandiot, Bardhyl Maliqi. Shkrimtari, përkthyesi, esseisti , pedagogu dhe studiuesi i njohur ndërroi jetë sot në një spital të Tiranës, në moshën 69 vjeçare. Maliqi vuante vitet e fundit nga një sëmundje e rëndë më të cilën luftoi deri në momentet e fundit.

Bardhyl Maliqi u lind më 19 korrik 1955 në Konispol dhe punoi ndër vite si mësues i gjuhës dhe letërsisë në shkollat e mesme të Sarandës, ishte psikolog shkollor, aktualisht drejtues i Njësisë Psiko-sociale dhe pedagog i Filialit Universitar të Sarandës prej disa vjetësh. Mbante gradën shkencore dr. i shkencave pedagogjike.

Gazeta Nacional dhe Shtepia Botuese Nacional u shprehin ngushëllimet e sinqerta familjes Maliqi dhe gjithë miqve, të afërmëve dhe kolegëve të dr. Bardhyl Maliqit.

Bardhyl Maliqi ishte mik i vjetër i familjes Buçpapaj dhe gazetës Nacional. Poezitë, studimet, përkthimet, essetë dhe shkrimet problemore të tij kanë qënë të pranishme në gazetën Nacional dhe vlerësoheshin shumë nga lexuesit tanë kudo në Ballkan dhe në Botë.

Gazeta përcolli po kështu edhe sukseset nderkombëtare të Bardhyl Maliqit i cili u botua në dhjetra gjuhë të ndryshme, duke u vlerësuar edhe me çmime të rëndësishme letrare.

Dr. Bardhyli do të mbetët i paharruar, për fisnikërinë, mëncurinë, inteligjencën dhe talentin e tij letrar, për patriotizmin dhe nacionalzimin e flaktë.

Bardhyl Maliqi Ka kryer fakultetin gjuhë – letërsi (studi-me të thelluara në psikologji – pedagogji), master në mësimdhënie, doktor në shkencat e edukimit. Ka shkruar 19 libra, prej të cilave janë botuar: "Shije të rrezikuara" (ese), "Qortimi i hartimeve (studim), "Etika rrjedhave të komunikimit" (studim), "Pasqyrat" (poezi), "Morfologjia" (tekst për studentë), "Ankthi i statujave" (libër me poema shqip – anglisht), "Perandoria e zogjve" (pema) në anglisht, italisht, kroatisht, rumanisht, greqisht etj. "Detyrat e shtëpisë" (ese), "Mësimdhenia dhe vlerësimi etik", (studim), "Tej portave të jetës" (novelë) etj. veprat e tij të fundit janë 2 libra me letërsi kritike për shkrimtarin Mexhid Mehmeti, "Shprehësi imagjinare"-kushtuar letërsisë së tij për fëmijë, "Vrasja e heshtjes", kushtuar letërsisë së tij për të rritur si prozator dhe dramaturg, poema "Presheva – nuse përdëllimi" dhe botimi poetik me një bashkë autore rumune "Mangalli i yjeve"

Bardhyl Maliqi – Çmime dhe vlerësime

Bardhyl Maliqi ka fituar mbi 20 çmime rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për veprat letrare dhe konkurse artistike, ndër të cilat veçojmë:

– Libreti më i mirë i vlerësuar me kupën e teatrove mbarëkombëtare (Shqipëri-Kosovë-Maqedoni) me dramën "U largua deti" më 2004 zhvilluar në Pogradec,

* Çmimi "Butrinti" në konkursin ndërkombëtar (ballkanik) të qershorit 2007 zhvilluar në Sarandë,





* Çmimi special ndërkombëtar (për poemat "Perandoria e zogjve dhe Ankthi i statujave" Birds Empire & The Anxiety of Statues, marrë në Kongresin e Dytë të Uneskos për letërsinë artet dhe shkencën, zhvilluar në Atalanti në tetor 2011,

* Çmimi special ndërkombëtar për "Etika e poetit dhe ndikimin e saj në shkolla"- marrë në Kongresin e Dytë të UNESKO-s për letërsinë artet dhe shkencën, zhvilluar në Atalanti në tetor 2011,

* Letër mirënjohje dhe vlerësimi drejtuar autorit, Ministrisë së Kulturës, Shtëpisë Botuese "Toena" dhe revistës "Mësuesi" për përfaqësimin me dinjitet të Shqipërisë në Kongresin e Dytë të Uneskos, tetor 2011,

* Çmimin e Maratonës Poetike Ndërkombëtare të Sarajevës me ciklin poetik "Kur ndriçojnë pikëllimet" (Literary Aëard for the poetry cycles "Ëhen sorroës gloë"),

* Çmim Special për poemën "Akuarel për Zagrebin" dhënë nga Panteoni Paneuropian i Kulturës Kroate dhe Shoqata e Artistëve shqiptarë "DEA" të Kroacisë,

* Çmim I për ciklin poetik të botuar në revistën boshnjake "Rjeç" si autori më i mirë i huaj për vitin 2016,

* Çertifikatë vlerësimi Nga Akademia Alternative Pegasiane si "Poeti i Vitit 2016" për qarkun Sarandë – Delvinë.

* Diploma e Çmimit I për poemën "Jam shkrirë në qenien tënde" në konkursin vjetor të "Unionit Art pa kufij", pjesë e Euroartit, Durrës 2018,

* Çertifikatë vlerësimi për Veprën Jetësore "Rrapi" nga Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë – Shkup për vitin 2018,

* Mirënjohje e veçantë nga Shoqata e Shkrimtarëve "Feniks", "Shkrimtarit Bardhyl Maliqi për arritje në fushën e letërsisë", Preshevë, tetor 2019, Çmimi "Naim Frashëri" në Festivalin poetike Ditët e Naimit në Tetovë, tetor 2020 etj.etj.

Si drejtues mësimor i rretheve letrare ka fituar 29 çmime rajonale dhe kombëtare të nxënësve dhe studenttëve të tij.

Ka qenë Trajner për efekt Atestimit për mësuesit 1984-2006,

Ka botuar 879 artikuj, mbi 300 e tyre të botuar në shtypin letrar e pedagogjik: Drita, Nentori, Mesuesi, Revista pedagogjike, Aks, Ndryshe, Nacional, Fjala e lire, Galaktika Atonis, Zemra shqiptare, Illyria (në ShBA) etj.

Bardhyl Maliqi ka kryer 163 redaktimet librash nga autorë të ndryshëm në poezi e prozë etj.

E shtunë, 13 janar 2024
NACIONAL

FLUTURA E DHJETORIT DHE TREGIME TE TJERE

Konstandin Dhamo

NGJASHMERI FATALE

Atë ditë shtatori , mëngjesi te Kafe Pergola ishte veçanërisht i këndshëm ! Bënte fresk, qielli ishte i kthjellët si qelq i sapolarë dhe, lulet së bashku me barin dhe mandarinat mes tryezave n'oborr , i kishin ujitur dhe gjallonin gjithë njomështi dhe shkëlqim. Ja ta pinim një kafe , të bënim pak shaka dhe të diskutonim dhe për punët e ditës që na prisnin; ato dy koleget tona , të bukura ,të bukura dhe të parfumuara që uleshin me ne , ju siguroj se ,mund t'i njëjtësoje përnjëmend me lulet aty përreth : zambakët , apo trëndafilat melankolikë…

Me ne e pinte kafen çdo mëngjes edhe Sherifi, që na e kujtonte gjithmonë se, i vinte mirë që, njerëzit që s'e njihnin , asqë e merrnin dot me mend , tek e shihnin ngado se, ai ishte një shkrimtar delikat , me shpirt drithërues që prekej për hiçgjë. Më marrin lehtësisht për një hidraulik, tregonte tek qeshte Sherifi, për një elektriçist , por në dimër, kur vesh xhupin e zi prej lëkure dhe vë në kokën time të rrojtur paq kapelen me sprethin e gjerë së prapi, më marrin për ndonjë të fortë lagjeje; hahaha…

Por atë mëngjes na rrëfeu një histori të re:

- Pardje – tha – në Lidhjen e Shkrimtarëve , që po shkrihet, mesa duket dhe do të mbyllet fare së shpejti, më ndali roja, tek po futesha brenda për të marrë pjesë në promovimin e librit të një autori të ri. Ku vete ti, m'u kthye ai , s'është për ty këtu; ku e ke parkuar maunen ? Ik këtu te qoshja dhe futi një dopio raki…
- Ah, e sajove në vend, më duket – e ngacmova unë.
- Ju betohem që jo. Por ju e dini sesi jam unë së brendshmi ; i dashur dhe i ndjeshëm sa s'ka…

Por ja ç'na ndodhi…

N'oborrin e kafenesë hyri një mashkull që ecte e ndalte duke na vështruar vëngër të gjithëve sa ishim ulur pas luleve dhe degëve të poshtme të mandarinave. Atë fytyrë nuk e kishim parë asnjë herë aty. Ndryshe nga ne, që ishim me mëngë të shkurtra , ai kishte veshur një xhakavento të gufuar , në xhepat e së cilës kishte ngjeshur edhe duart. Dukej fytyrë e keqe dhe na shqetësoi seriozisht; ç'deshte ai në atë kafene të qetë , që frekuentohej veçse nga intelektualë?

Por ja doli krejt papritur , siç edhe u shfaq.

- Për Zotin, e kishte me mua ! – pohoi i tronditur Sherifi – Askënd tjetër nuk e vështroi aq gjatë sa më vështroi mua; idioti, provokatori, a ç'dreqin ishte …

U mpimë të gjithë dhe nuk po merrnim dot asnjë vendim, ndonëse mendja na punonte për keq.

- Kaq ishte, harrojeni atë budallain , sepse nuk hyn më ; pale ç'hall kishte. Ç'po thoshim ? – na shkundi njera nga koleget.

Por ja, në çast u shfaq përsëri ai tipi fytyregër, mu si fantazmë. Po po, mu si fantazmë ! Veçse kur e pamë pranë tryezës sonë ! Askush nuk e pikasi kur u fut në kafene dhe bëri njëzet hapa gjersa mbërriti te ne ; e çuditshme ! Këtë herë , fare haptazi ia nguli sytë veçse Sherifit, i cili ndonëse nuk po përcillej dot , u bë gati ta pyeste siç kuptohej se, përse po na bezdiste, apo edhe po na kërcënonte, e kë pa…

Por ai na ktheu kurrizin dhe pa u ngutur , u drejtua nga dera e oborrit.

- Prisni ; - tha Sherifi – do të dal vetë të shoh ç'bëhet; ah , ndyrësira !
- Mos dil ore ! – iu lëshova unë – Tani vërtet, iku njëherë e mirë !

Sherifi nuk m'u bind , prandaj iu vura pas.

Ai kërcënuesi po fliste në celular me dikë dhe, në çastin që hapi derën e një Audi, hoqi celularin nga veshi dhe iu kthye Sherifit, që po i afrohej pa hezituar:

- Qenke jetëgjatë, ti ! Të mora për tjetër person , për pak s'të palosa…

Ndezi Audi - n dhe u largua , duke e ngarë me ngdalë dhe me terezi,a thua se në timon ishte një pensionist i qetë dhe i ngeshëm .

- E ? – iu ktheva Sherifit.
- Mos ore, mos ! – buzagazej ai pikëllueshëm – Ku ma ke të dukesh si një shkrimtar , nga ata që ecin mendueshëm në rrugë, me një dosje të pandarshme në dorë dhe me gjyzlykë me xhama të trashë në sy…

1994

INTERMEXO ME LIBRA

Gabimi

Në mëngjes, kur dola nga shtëpia, përveç qeses së madhe të plehrave, mora me vete edhe një qese tjetër me pesë kopje të librit tim më të ri. O, do t'ia shpija shkrimtarit R.T, i cili e kishte lënë Francën për një muaj dhe, kishte zbritur në atdhe për t'u çmallur ca dhe njëherësh për të vënë dhëmbë në gojë…

Ashtu, duke rrotulluar nëpër mend njëqind gjëra, u gjenda përballë kazanëve të plehrave dhe, hop! e fluturova njerën qese drejt tyre.

Mos!Në vend të plehrave, hodha librat! Hajde t'i fusje duart nëpër pisllëqet e njerëzve! Pale të të shihte ndonjë nga ata të shumtët e gatshëm, të cilët nuk lënë gjë pa nxjerrë në rrjetet sociale! Po kush ma dha komandën gabim?

E mo', më mahiti alteregoja, se nuk u bë ndonjë gabim kushedi se çfarë; librat.nëse t'i kap syri sot majë plehrave, intrigojnë më tepër sesa në vitrinat e librarive apo në raftet e bibliotekave…

Bananas Bananas

Me botuesin isha marrë vesh që në fillim për të m'i dorëzuar mua në dorë tridhjetë kopje nga tirazhi i plotë i librit tim.

Eh, botimi i një libri, i sadoqoftë në numër, përndez çdo herë një gëzim më vete, po po!

Pasi firmosa në disa fletë radhazi, vura re se, punëtori i shtypshkronjës m'i kishte sjellë kopjet e librit të futura në një arkë bananesh!

Bananas Bananas

Ah, psherëtiva, me bananet sigurisht që do të kisha fituar para shumë më tepër! Megjithatë, çdo botim i ri është një gëzim më vete, e thashë këtë.

Dhe, preka librin tim me dhembshuri!

Bananas Bananas

Ah, e pabesa rastësi

Ah, e mbrapshta llogari …

2005

POEZIA

Tek pija mendueshëm kafen e mëngjesit, vështroja lart në ballkonin e një pallati, pardesynë e bardhë të një femre, e cila, e varur për t'u tharë në tel, ashtu e vënë në kremastar, rrotullohej e rrotullohej nga era sa majtas – djathtas dhe, të kujtonte ato tabelat e qitjes, kur i godet plumbi...

Por erdhi poeti MT, i cili, kur e dallova që tutje , m'u dhimbs me atë supin që ia shtrembëronte çanta e pandarshme përplot me libra. Eh, ishte gjithmonë po ai, me hap të ngadaltë dhe me një buzëqeshje të prerë në fytyrë, e cila të sillte ndër mend humorin dramatik të filmave të Çaplinit..

- Po ku je, ore ? – i kërkova llogari për ta ngacmuar – Gjithmonë të del një punë përpara.
- Ç'm'u desh mua ! Mora nja dhjetë libra nga të mitë dhe, thashë t'i shpërndaj te dy librarë të cë ndodhen përgjatë rrugës së shtëpisë sime, mirëpo ato shitëset , kështu po i quaj, sepse nuk e kanë fare hijen e atyre librareve të dikurshme, që na i vlonin librat e bukur nën banak dhe, që lexonin edhe vetë kur nuk u hynin klientë, m'u gërmushën : ç'e ke këtë or' xhaxha,fletorkë me vjersha?! Po të tilla gjëra tani,na sjellin veçse gjimnazistet ! Nuk kemi vend për libra të tillë në librari, jo jo, nuk na ecin...
- U bënë vite, që poezia refuzohet; ehu, më vjen keq, nuk na the gjë të re, ndonëse u pikëlluam tek të dëgjonim! Raftet e librave tashmë, mbushen me librat e të pandalshmes Daniel Still. Ato, shiten tërë ditën si hamburgerat. Dorën e zonjës Still, e lëviz një mekanizëm i përsosur perpetuum mobile, ka thënë një kritik idhnak.Po ti sikur na premtove se, do ta dhuroje librin, ashtu siç bëjnë në përgjithësi të tërë me vëllimet poetike ?
- Po more, po, dyqind kopje janë të shkretat; por ja që kisha qejf ta shihja librin tim në vitrinat e ndonjë librarie.
- Sidoqoftë, librarët kryesore në qendër, do të ta mbajnë dhe do të shesin diçka. Dihet, poetët e vërtetë, të varfër vdesin, - u talla pa të keq në fund.
- Po nuk u shqetësove dhe , po nuk ëndërrove, nuk krijon dot, po tallu ti sa të duash. E sheh atë Mercedesin në trotuar ? Më mirë ta ëndërrosh sesa ta kesh.
- Jo more ! Me femrat ama, nuk ke dashur asnjë herë të kesh marrëdhënie të tilla platonike. Femrat ke dashur t'i gëlltitësh me gjithë lecka !
- Tjetër gjë janë femrat, mos spekulo ! Po, si m 'u derdhën ato shitëset: nuk mbajmë fletorka me vjersha ne, or'xhaxha; gjimnazistet shkruajnë të tilla gjëra tani. Mirë të tjerat, po fjalën xhaxha, ku e gjetën ? Sa të pasjellshme ! Eh, ç'llomotis kot edhe unë ! Prit, prit të ta jap edhe ty librin tim, sepse, pastaj, merremi me llafe dhe, harroj…

Shkroi diagonalisht një dedikim të gjatë, të cilin, kur e lexova, më shumë se vetë teksti, më preku shkrimi i madh dhe i rrumbullakët si ai i fëmijëve të fillores. O Zot, thashë me vete, dikur kishte një shkrim të imët dhe të dendur.

- Si më thanë ato ashtu: o xhaxha, nuk mbajmë fletorka me vjersha ; gjimnazistet shkruajnë tani gjera të tilla. O xhaxha ! Bobo; sa keq po e qëllojnë poezinë hyjnore, që drithëron e drithëron ...

Eh, miku im, nuk e pranojnë më poezinë !

Para ca ditësh një burrë hodhi gruan nga dritarja e banjës, si t'ishte sendi më pa vlerë në shtëpinë e tyre. Më pas, po një burrë, shqiptar shqiptar, ia nguli thikën në zemër ish gruas së tij në sy të diellit dhe të kalamajve. Po pardje, po sot, harruat ? Burri qëlloi me pistoletë gruan e tij brenda në makinë, teksa ajo po nisej për në punë…

Po nesër

Po pasnesër…

Ne vrasim femrat, miku im,për ç'poezi po flasim ...

Ajo pardesyja e bardhë, me prerje femërore, atje lart në ballkon rrotullohej e rrotullohej majtas – djathtas m'u si ato tabelat e qitjes, kur i zë plumbi…

2005

FLUTURA E DHJETORIT

A e dini sa zgjat një pasdite dimërore, aty nga fundi i dhjetorit ? Nëse pranojmë, që ajo fillon diçka pas orës pesëmbëdhjetë, do të thotë se, nuk zgjat më tepër se pesëdhjetë minuta, sepse para orës gjashtëmbëdhjetë regëtin perëndimi e më pas shfaqet edhe ai muzgu me të blertën fare të lehtë, që shngjyroset shpejt.

Por ja t'ju tregoj…000

Haja drekë ngutshëm dhe, herë pas here hidhja sytë tej dritares gjithë merak, për të parë dritën . Qielli kishte ende ngjyrën blu kobalt ,siç kanë qejf ta perceptojnë piktorët, ndërsa vetë dielli, majë një pallati ku kishte mbetur, rrezatonte mbi dritare atë të artën e ngrohtë...

Duhej të dilja medoemos shpejt, përndryshe do ta humbisja pasditen, ashtu siç humbet edhe një shfaqje, nëse mbërrin me vonesë.

Mbatha atletet dhe u lëshova drejt Parkut të Madh.Aty ishte qetësi e plotë, aqsa të vinte të mbaje frymën. Parku im, thashë me vete, dhe u lëshova mespërmes drurëve të zhveshur, të cilët i sheh me një trishtim romantik, ashtu në dramën dimërore kur mbesin pa gjethe, pa prarimin drithërues, pa frushullimat gjithë fshehtësi, por vetëm me ca fole të zbrazura zogjsh shtegtarë në majë, që era i tund,

i shprish dhe i shthur…

Po shtëpitë pas liqenit, gjithë vëllime hijedrite ? O, ato pasqyrohen n'ujin e rrëqethur dhe të kujtojnë ca piktura të vjetra dhe të ciflosura...

Sot, si zakonisht në Park nuk ka as dëborë dhe as mjegull dhe, gjethet e shtruara përtokë, ende të pakalbëzuara, më kërcasin nën këmbë.Trungjet janë të veshur me myshk të dendur, që më duket si një blerim që ka marë të përpjetën.

Por ja, dhe një flutur !

Por , a është vërtet flutur , apo një gjethe e shpirtëzuar , kushedi nga ç'ndrra e ç'trille ?!

Me krahët përplot vija të spërdredhura dhe të ngatërruara befasisht, që të kujtonin kafeglifet e një filxhani, kur ai përmbyset për t'u lexuar më pas nga besëtydet, ajo fluturon ulët dhe si e përgjumur nëpër rrezet e pjerrëta dhe të kursyera të diellit të dhjetorit.Thashë një herë ta ndjek pas e ta kap, sa për të shijuar pakëz fëmijëri, por ndërrova mendje ; më pëlqeu më shumë ta shihja n'ajër, ashtu si një mrekulli që kishte shtyrë jetën e vet, e cila duhet t'i kishte përfunduar së paku para një muaji...

Po ku u zhduk? Ku u zhduk magjishëm, ashtu siç edhe magjishëm u shfaq ?

A e dini se sa zgjat një pasdite dimri …

1995

TAKSI

A, çfarë moti! Derdhej shiu ujëvarë dhe krisnin rrufetë me aq zhurmë dhe ndriçim verbues, sa gati-gati ndiheshe i indinjuar dhe i fyer prej papërgjegjshmërisë së qiellit…

U lëshuam me të katra që nga libraria, ku kishim hyrë për të shfletuar disa libra të rinj dhe, kapëm një taksi para Bankës Kombëtare. Pasi u rrasëm brenda, duke shfryrë dhe duke marrë frymë me zor, i thamë shoferit, ku të na hidhte por, o Zot! tek po rrinim pa folur në ndenjëset tona, dëgjuam befas që nga magnetofoni i taksisë vargjet e poemës sime "Zoti Kallashnikov". Ku nuk qenka shpërndarë, thashë me vete, kjo kasetë; deri edhe te shoferët e taksive! Dhe mendo, s'ka as një muaj që është përgatitur. Por, sidoqoftë, hajde dëgjoje tani gjatë gjithë rrugës…

Alkimia e mallit, rilindësve tanë,

Baltën e atdheut ua kthente në mjaltë…

Të paktën nuk qenka nga fillimi; qenka diku nga fundi! Nuk e di, por s'kisha më nerva e dëshirë ta dëgjoja. Ndoshta ngaqë e kalova për një kohë të gjatë nëpër duar dhe, ngaqë edhe opinioni u mor shumë me të. Mirëpo, shokun tim, që e kisha në krah, nuk po e zinte vendi, gjersa të pyeste shoferin për poemën, sepse ishte i sigurt, që do të dëgjonte prej tij ndonjë batutë, prej së cilës do të shkriheshim gazit më pas.

- Ç'është kjo, që po dëgjon! S'paske kaseta me muzikë ti? - e pyeti ai, sapo ndalëm në një kryqëzim të rrëmujshëm, semaforët e të cilit nuk punonin.

- Aha! Kaseta me muzikë kam sa të duash dhe çfarë të duash, por ja që "Kallashi" më pëlqen shumë. Rri pres radhën te Banka dhe vë kasetën dhe e dëgjoj; ku të qëllojë… I kam hequr mbi kurrizin tim unë të gjitha ato që përmenden aty!

- Ashtu, ë? - u interesova unë sinqerisht dhe i bëra shenjë shokut tim të mos llapte më. Ndërkohë, taksisti filloi të deklamojë me një zë të vrazhdë vargje nga poema, duke u sinkronizuar perfekt me zërin e aktorit, që gurgullonte nga kaseta:

- Ky popull mbeti me arkivol mbi supe… Ah, ah!

- Vërtet, vërtet! - pohoi shoku im. Por taksisti nuk u bë aspak qesharak. Kur e ndërpreu deklamimin atje ku desh ai vetë, na u kthye neve dhe tha:

- Ah! Rri pres radhën përpara Bankës dhe dëgjoj "Kallashin". Më është bërë si lutjet, jua thashë një herë.

- Po kush e ka shkruar këtë "Kallashin"? - pyeti përsëri këmbëngulshëm shoku im. - Dua të them, si e ka emrin autori; e di?

- Emrin? E kush ia qiu t'ëmën…

1998

TË QOFTË DHEU I LEHTË MUSA VYSHKA!

Nga Ymer Ciraku

Në foto: MUSA VYSHKA

Është pikëlluese ndarja nga jeta e poetit MUSA VYSHKA. Njohja ime me të, zë fill përmes letërsisë, që na e përcolli prej shumë vitesh. Por e kam njohur edhe përmes takimeve të drejtpërdrejta. Fillimisht, ne studentë të fillimit të viteve `70 të gjuhë – letërsisë, kishim mjaft vlerësim për disa nga ata studentë, që kishin pak vite që patën mbaruar në atë degë dhe kishin bërë emër veçanërisht në poezi si: Sulejman Mato, Niko Kacalidha, Sadik Bejko, Anton Papleka, Xhevahir Spahiu, Moikom Zeqo, Thanas Dino, Rudolf Marku etj. Mes tyre, ishte sigurisht edhe Musa Vyshka. Kishim patur rastin disa herë që ta shihnim portretin e tij, tek qëndronte i përqendruar disa çaste, kundruall derës së përtejme të fakultetit të filologjikut. Përcillej shumë mall e nostalgji në atë qëndrim. Na bënte përshtypje me ato duar të kapura fort pas hekurave të derës së madhe. Sikur kishte një betejë të heshtur me to.

Musai jetonte dhe kishte nisur punën në qytetin e tij të lindjes në Elbasan dhe duket, kur vinte prej andej për në Tiranë, para se të shkonte tek ndonjë redaksi gazete letrare për të çuar për botim ciklet me poezi, nuk harronte që të bënte "ritualin" e ndaljes para asaj godine. Që sigurisht, duket se i rizgjonte kujtime. Ishte djalë i ri, i hajthëm dhe me qëndrimin e çpenguar dhe flokët e zgjatura, karakteristika këto për dukjen e jashtme antikonformiste të shumë poetëve të rinj aso kohe. Se ishin vite, kur po frynin ca erëra liberalizmi, ndonëse mjaft kohëshkurtër. Më pas, kam patur mjaft raste që të njhem nga afër me të dhe të ndajmë mendime rreth letërsisë dhe problemeve të jetës universitare. Pasi prej shumë vitesh, ai ka qënë lektor dhe drejtues i departamentit të letërsisë në universitetin "A. Xhuvani" në Elbasan.

Si peng nderimi dhe kujtimi, po përcjell disa vlerësime të miat rreth poezisë së krijuar dhe botuar prej Tij, në një hark kohor pothuaj 60 vjeçar.

"…Profili artistik i shkrimtarit Musa Vyshka, para së gjithash në poezi, mbetet i spikatur dhe me shenja origjinaliteti. Qysh me krijimet e tij të para poetike, ai u dallua për ndjeshmëri të hollë e pothuaj delikate. Nuk ishte një poet që do të dëshmonte në vargjet e tij, prirje të dukshme për nga temat dhe konfliktet e forta sociale dhe historike të jetës. Në vargjet dhe ritmet e kësaj poezie, më së shumti, gjejmë "oazin" e vendlindjes së përmallshme, me gugatjen e kumrive, me trokitjen e erërave, që për një çast rrëzëllitës i kujtojnë heroit lirik ardhjen e të dashurës… Gjejmë po ashtu, etjen e rinisë nëpër udhëkryqe të kohës, qiellin e marsit që spërkatet me ngjyrat e ylberta të pranverës, njerëzit e dashur të larguar nga jeta… Te kjo poezi akuareli, duket se ndihen mjaft motive të spërkatura me impresione personale, aq sa mjaft cikle poetike, të ngjajnë si shfletim albumesh të jetës së heroit rrëfyes lirik, ku vrehen të derdhura në to: ujëvara kujtimesh të largëta të fëmijërisë, mbresa takimesh të bukura, apo edhe pendesash – ardhur prej keqkuptimeve, apo mos mundjen dot për t`iu përgjigjur ndjenjave trallisëse të dashurisë. Skaliten në këto krijime: biri, ati, vëllai e shoku, si Raporti Njerëzor i Gjithësisë.

Poezia e këtij autori, është kryesisht e prirjes së përsiatjes dhe jo aq e detajeve dhe impresioneve e situatave fabulistike. Kuptohet, se secili prej këtyre modeleve, ka ndjekësit dhe po ashtu, ka padyshim vlerat e veta, kur arrihet që ato të realizohen. Por poeti M. Vyshka, nuk priret që të rendë aq nëpër përshkrime subjektore ngjarjesh e situatash, prej të cilave, të burojnë pastaj vetiu mesazhet dhe nëntekstet poetike. Pra, duket se ai nuk preferon që ta transmetojë poetikisht vet ngjarjen, por të evidentojë para së gjithash, përsiatjet pafund rreth asaj ngjerjeje, apo situate poetike, që çlirojnë për pasojë – edhe një spektër të pasur emocional.

Vargmalet kokëthyer u krrusën përmbi fusha

E qajnë tok mes erës.

Mijëra përralla dridhen e vdesin në gëmusha

Me valën e skëterrës ("Elegjia e zhgënjimit")

Ndonëse të shpërndara përgjatë përmbledhjeve poetike të botuara në vite ("Do të vdes i dashuruar", "Vijmë dhe shkojmë", "Mos e kthe kokën pas", "Pse rënkon kumria ime" etj), mund të thuhet se përbëjnë një cikël më vete poezitë kushtuar disa prej poetëve e shkrimtarëve të njohur të letërsisë shqipe: Fan Nolit, Kristoforidhit, Lasgush Poradecit, Migjenit, padër Anton Harapit, Petro Markos, Viktor Qurkut, Genc Lekës etj. Në to, ndihet venerimi i thellë për njerëzit e paharruar të Vëllazërisë së Poetëve, të cilët, u shuan nëpër kohë e rrethana të ndryshme, por që mbeti përherë e gjallë vepra e tyre. Ajo vepër, nuk përcillet thjesht dhe vetëm si kujtesë, por para së gjithash, vlerësohet për rolin dhe peshën e saj të madhe, si fortesë e letërsisë dhe e gjuhës shqipe.

Vdekja e Lasgushit, përjetohet si një vajtim i tërësishëm/kozmik edhe i vet natyrës:

Liqeri i mbytur në lotë
Rënkonte me dhimbjen në gji,
Poeti i lodhur në shqotë
Kërkonte mes shqotës qetësi…

Kurse shkrimtarin e befasive, në jetën dhe në letërsinë e tij, Petro Markon, e mitizon në model balade të tretur si bard në shkumën e bardhë të valëve të detit, duke i apeluar poetikisht: Mos u fshih pas maleve, (pra pas maleve/lartësive të veprave e jetës së tij) - thuaju që je ti!

Librin me poezi të përzgjedhura, botuar para pak vitesh, e shoqëron edhe një shkrim i Dritëro Agollit. Ai e çmon dhe e përcakton krijimtarinë e M. Vyshkës, si një poezi meditative, ku ndihen bukur vibracionet e shpirtit dhe dilemat e njeriut në jetë, ku ndeshen të kundërtat dhe shpesh shpallen pikëpyetje, jo vetëm për të sotmen, por edhe për të nesërmen.

Në faqen e pasme të kësaj prmbledhjeje, është vendosur një fragment poezie, ku derdhet si në fije ari, një përdëllimë dashurie e pashuar, që endet nëpër eterin e kohëve pa cak:

Ti fundi je i pritjes që s`ka fund,
Je prehja e shqetësimit që s`qetohet
Sapo të shoh mërzia krahët shkund
Trishtimi i trishtuar larg largohet.
Aq shumë të dashkam sa as vetë s`e di.
O dashuri! O dritë e kësaj bote!
Sa herë dal në pasqyrë, për çudi,
Veten kërkoj, më del fytyra jote!

Këto vargje, mund të cilësohen edhe si kredo e poetit për dashurinë me kahje universale, pra, në të gjitha pamjet/shfaqjet e saj - në jetën njerëzore.

Një dashuri e thellë dhe pa kushte kjo, e cila, ka aftësinë që të sjellë dritën dhe paqen e bekuar dhe përtëritëse mes njerëzve."

Faqja u përgatit nga Asja Mulgeci

Letërsi bashkëkohore

Një poet, një poezi

Agim Bajrami

KOHË E GABUAR

Une kam qene nje lindje e gabuar
Koha e ardhjes ketu ish nje gabim
Ndofta fati im ende s'ish zgjuar
Ndofta u shpejtua Ati im ?
Mund te kisha zgjedhur kohe tjeter
Pergjithmone bej gafa kur perzgjedh
Erdha te vjell veten ne cdo meter
Dhe me pas serish me dore ta mbledh
I rrethuar keq nga lukunite
Ujqer dhe bastarder te cdo lloji
Ndjej se si kerrusem dite per dite
Dhe as me me hijen nuk ngjasoj
Ndaj cdo cast nga vetja flak nje shprese
Se baloni im po bie ngadale
Nese dje jam shquar per qendrese
Sot nuk kam guxim te nxjerr nje fjale
Ne cdo hap qe hedh duke caluar
Guacka prej zgenjimesh shkel me droje
Mos me thoni me se jam i zgjuar
Nje i zgjuar di si te veproje !
Jam koke forte dhe kete po e paguaj
(Geni eshte nje gje qe s'ndrrohet dot)
Turmat jane per mua rrace e huaj
Blegerime e tyre me ngjall ndot
Une kam qene nje ardhje e gabuar
Edhe sot qe flas jam nje gabim
Koha ime eshte e tradhetuar
Dhe nuk ngjan aspak me emrin tim

Nga VIOLETA KADRIU

NDALE TURRIN, PËRBINDËSH NJERI

(11 vjeçares së përdhunuar në Kosovë)

Ndale turrin, përbindësh njeri,
a e di se ka Perëndi,
a ke nanë, o a ke motër,
a e ke ndokend që të pret në votër,
m' përdhunove sot mua, më shkatërrove vëllanë,
më shkatërrove nënën, motrën dhe babanë!
Që nga sot kukulla ime do të qajë,
jam ende e vogël, e kam të vetmen pajë!

Do t' më dalë zemra prej krahërori,
kur po më prek kjo dorë mizori,
cuclla e qumështit ende mirë s' më është tharë,
ende nën buzët e mia qeshin dhëmbët e parë!

Ndal e dëgjo këtë përgjërim fëmije,
liro shpirtin nga ky çfrenim çakërdie,
mos më zbath sandalet që sot nëna m'i ka mbathë,
m' ka ruajtë si sytë, si manare në vathë!

Oh, mos ma shqyej ti sot fustanin,
e kam nga babai, me kordele, ma dogje xhanin,
mos më përdhuno, jo, mos m' përdhos,
me fytyrë nga toka,
jo, mos m' plandos!

Sot fëmijërisë dardane i hape varr të ri,
ndale turrin përbindësh-njeri,
faqet e mia për ty janë tepër të buta,
freno turrmonstrumin, ty të nxiftë futa!
Mos më nduk rruzat e mësyshit, në vend floriri,
ende nga buza më rrjedh qumësht gjiri!

Hapu qiell, e vranëso re,
lësho murmurima, mijëra rrufe,
duart tuaja le t'ua ngrijnë,
si çelik të nxehtë le t'ua shkrijnë!

Çjerru qiell e hapu tokë,
mblidh Engjëjt e Drejtësisë Hyjnore kokë më kokë,
dëno ata që i ngrin lotin n'sy një nane,
ata që ia këputën rrezet një hane,
atyre që ia lënduan rrezimin burrëror një dielli,
atyre që ia përdhunuan kaltërsinë këtij Nën-qielli!

Spasse Thanasi

QESHIN LULET E ZAMBAKUT !...

Qyteti me një koder – kala
Mbi lumin ujëkulluar "Osum"
Një vend grotesk i paqes në shpirtë
Kujtesë e dashur, e paharruar…

Dielli përmbi lumë
Me xixëllima të pandërprera loz
Dhe në anën tjetër të bregut
Lulet e zambakut qeshin
Fusha e gjerë shpërndan dashuri !...

Tahir Bezhani

KUJTESË E VRARË MALLI...

Morën dallgë kujtimet e nxehta
Fërkimet e përmalla nuk ndalnin vrapin
Dielli përcëllonte lëkuren e hijeve
Rëra kokrrize piqte si çerep i prushtë
Valët e detit valëviteshin brenda zemrës
Koshi kraharorit përplasej dënesjeve
Si astmagji kronik i pashëruar dhimbjeve
Sytë shëtisnin syprinës pafund të detit
Atje larg shikoj aniet në hapësirë pafund
Lundronin mbi valët tërbuese
Dëgjohej piskamë sirenash n'ankorim
Përmes shkumëzimit të valëve të njelmëta
Dëgjoja frymëmarrjet e ngrira n'parzëm
Dridhesha nga prushi nostalgjik
Lotët rrëshqisnin lëkurës së plasaritur
Sa përcëlluese kjo stinë vjeshte
Fola me vete...
Tërhoqa shikimin nga valët shushuritëse
Lodrova me pamje kërshnajës së djegur vetëti-mash
Atje lartë mbi det, mes pishave
Një kulm shtëpie vezullonte me tjegulla të kuqe
Eh!
Sa më ngacmoi kujtesa e vrarë malli
Më përfytyrohej miku, ZeqirLushaj
Në sofrën prej guri dikur mbushur plot
Si në Grinëe vetë n'Malësi të Gjakovës
Sa pikëlluese ishte kjo stinë në Shëngjin!...

Gjakovë,30 dhjetor 2023

ZANA TAKO

SOT DHE NESËR

Isha edhe dje,
jam edhe sot,
do të jem edhe nesër,
por nuk dukem kur ëndërroj…..
E nesërmja nuk ka kuptim pa të djeshmen,
e sotmja je ti,
jam edhe unë,
kur mendoj për ty…..
Mendimi udhëton me të sotmen,
të nesërmen ende nuk e di.
Ti je aty,
edhe dje, edhe sot, edhe nesër.
Të shkoj…..
nuk mundem dot pa ty.
Të vish....
ashtu si erdhe dje,
veshur me ngjyra farfuri,
i bardhë si bora,
i qeshur si drita,
i ëmbël si mjalti i hojeve,
i shpejtë si vetëtima.
Kohë e tashme,
kohë e shkuar,
kohë e largët....
Brenda tyre je vetëm ti,
fytyrë qeshur,
gjithmonë i ri!

Mark Përgjoni

I MIRI ME TË MIRA!

Kur lind njeriu nuk di të flasë,
veç të qajë e të bërtasë.
Duke parë e degjuar,
ai nis për të mësuar.
Duke u rritur të tjerë shikon,
si ata dhe ai mëson.

Mëson në familje, çerdhe e kopësht,
mëson në shkollë e në shoqëri,
por edhe në punë mëson ai.
Kur të shohë punë të mira,
dhe degjon fjalë të dëlira,
për ato i shtohet deshira.

Fjalët e mira që ka dëgjuar,
me dëshirë i ka shqiptuar.
Punët e mira që ka parë,
vetë punoi për t'i bërë.

Mirë ka parë e ka dëgjuar,
dhe gjatë jetës ka mësuar.
I mirë në punë e në shoqëri,
për mirë përmendet emri i tij.

Prandaj secili sa të rrojë,
mirë të flasë e të punojë,
që prindërit e tij t'i ndërojë,
Por dhe vetën ta lartësojë
Kumrie Avdyli Shala

MBRETI DHE BJESHKA

Ti që fshihesh pas gardhit në çdo orë
Duke u zgërdhirë pa pikën e njerëzisë
Pikërisht si ai bajlozi plak
E ende mendon që je meteor
Dhe lëvjerresh tej si halabak

Pasi ia zbulove stërkeqen asaj deles galë
Duke iu hudhe në gjah për ta lënë pa fjalë
Asaj që moti në shpirt ishte këputur
Aq sa zotit për vdekje ishte lutur

E ti, nuk e ndale mashtrimin
Do kaleroje mbrapsht edhe atin e shalës
Por, harrove se nuk mba më ujë pilafi
As në këtë kala, s'të zë vend grati

Ndjej dhembje për ty, mbret i modernizmit
Nuhasje fort lulëkuqen e Dardanisë
Nuk tolerohet t'kalërosh mbi bedena
Se forca jote kishte mbaruar
Ti thërrasësh trurit o pjellë e djallëzisë

Tashmë hidhu mbi bedena a pupla
duke hedhur shikimin nga i dyti kat,
E nga malli do të ngulfatesh tek e vona
per Lulekuqet tona,
vrapthi, si ulkonjë e tërbuar sokak më sokak

Duke medituar borën e par'vjemë
Në malet e lashta të Shalës e Marashit plak
Shpres´humbur që nuk kalërove bjeshkët tona
Eh, mos o Zot me keq!
Se puna e këtij "Mbreti" shkoj si për dreq.

PERIKLI SHULI

PO PSE....?

Lundrova këto ditë qiejve në reshje Raketash,
mes errësirës së natës ,
mbi dallgët e detit,
mbi maja malesh me dëborë,
në lumenjë të fryrë nga ujra që vinë vrullshëm nga malet.
Eca në autostrada ,hekurudha, porte dhe aeroporte,
të prek ëndrrën që ngrita në ditën kur nuk ëndërroja.
Dhe në bulevardin me dy dalje,
në sheshin monumental
në "pallatin e ëndërrave"
podiumeve, kuvendëve pa
auditorë,
të mbrrij në kujtesën e harruar, nga rrethi pa kujtes.
Kudo pash "katrorë" me një të panjohur, lotë , derte me oi,
zëra që vinin nga thellësia e errësirës, me thirrje pafajsie!
Pash lëndina me bar të ngrirë,
portrete të dylluara,
buzëqeshje faciale,
gëdhendur me dalta plastike.
Diku largë një shtrëngim duarsh ,
dhe nënbuzë, mërmëritje,
"vetë shëndosh" sikur thonë!
Po pse.....kush vdiq?
Joooo, ka akoma të gjallë,
dhe për këta ka një fondë për "katastrofat".

Tiranë 2023

Nikolin Sh. Lëmezhi

MOS I VRITNI NËNAT!

Kushtuar viktimes Liridona Ademajt

Zot i madh e i bekuar,
nëse Ti je dashuri,
kjo dhimbje e njerëzimit,
a mund të ketë kufi?

A mund të vritet Nëna,
- pyesin zemrat tona?

Siç bënë me dy të shtëna,
për motrën Liridona.

Të dashur vëllezër e motra,
le të dihet në tokën mbarë,
se kush guxon të vrasë Nënat,
ai s'është burrë shqiptar.

Si mundet, pra, njeriu,
me gjithë këtë begati,
të vrasë pa mëshirë i ziu
edhe gjakun e tij?

Kur Zoti krijoi rruzullin,
bashkë me Diell e Hënë,
aq shumë e lartësoi gruan,
saqë e bëri Nënë.

Mos i prekni Nënat,
se të shenjta ato janë!
Mos i vritni zemrat,
që botën në dorë e kanë!

Liridona, bijë e dashur,
për këtë botë plot ligësi.
Lutu ti, lart nga Parajsa,
që të ketë më shumë mirësi!

Shpirti yt n'paqe pushoftë,
ty të duam shumë Liridona.
Prindërit Zoti t'i ngushëlloftë,
rrofsh gjithmonë në zemrat tona!

Shkodër, më 03. 12. 202

EL GJERGO TANKA

"LUGATKA"

U ke ngjallur kërshërinë
lugetërve të mi,
kanë filluar dhe shesin shpirtra
poshtë filxhanit të kafesë,
matin hapat e tu, sa herë del dhe bën xhiron e radhës
syve të mi...
e unë, poshtë qelqit ku më mbajnë të lidhur,
pres ta vjedhësh hënën,
të shoh tek ngjitesh me kujdes
hapësirave që nuk të përkasin,
dhe me lëvizje psherëtimash, thërret emrin tim,
ti nuk e njeh atë,
nuk je mësuar ta kesh mes buzëve
e as t'ia prekësh gërmat, si të ishin duar femreje...
ti nuk e di në sa gremina duhet të hidhesh
e të qëndrosh sërish i gjallë para meje,
për të më njohur,
për të më pranuar kështu siç jam,
e ndryshkur,
e harlisur,
e brishtë,
e keqe,
ndryshe,
Duhet të jesh prej guri
që të mos thyhesh sa herë do të të duhet
të përplasesh brenda meje,
të gjesh hapësirë e të mos mbytesh prej mendafshit,
që prodhon krimbi me të njëjtin emër
i imi,
të jesh prej ajri, që të mos të të hedhin tutje
furtunat e mia,
të jesh i qetë para zhurmës sime
dhe i zhurmshëm para vetmisë që m'zhyt fluturat…
U ke ngjallur kërshërinë
lugetërve të mi,
ata zor se më lëshojnë kollaj,
të dehem dhe te çmendem,
prandaj ti mos ki frikë,
eja dhe vëri në gjumë…
(Poezi-fragment i shkeputur prej filmit cinepoetry me te njejtin titull).

IM ATË TË SHTUNAVE MË BLINTE KËPUCA LLASTIKU

Nga Arif MOLLIQI

Të premten kur u ktheva në shtëpi
dyqind metra para se të hyja brenda
filloi të bjerë shi në një rrugë të pashtruar
u ndjeva ligsht edhe pse kthimi është i gëzuar
brenda kornizës së shtëpisë një ngjyrë e errët
përtej një sfondi kulla, muret, dyert, pemët
zogjtë kishin shpërndarë disa njolla gjaku
figurën time të harruar e gjej në dhomë mbi shtrat
aty është im atë
dritë i pastë shpirti
që kishte vdekur atë sene kur ra lia e madhe
ai nuk vdiq nga ajo sëmundje e mistershme
as nuk e kishte marrë vesh ç' ishte ajo dergjë
ka qenë pranverë
data e vdekjes së tij është në mermer
shënimet e tjera mbahen në regjistrat e ofiqarit
po unë e di që jam ende gjallë
e mbaj mend mirë sepse sado që isha axhami
e kisha për zemër një grua që e takoja rrallë
nganjëherë veç në këmishë të bardhë
herë tjetër lakuriq
tashmë e kujtoj vetëm në ëndërr atë që ju dyshoni
e kur zgjohem nga gjumi hëna ka ngjyrë tjetër
kam një ndjenjë të pështirë e të gërditshme
e bash tash ëndrra ma kujton edhe kohën
kur e nxorën im atë prej shtëpisë me tabut
e kishin mbuluar me një çarçaf të bardhë
s'kam si ta kujtoj ndryshe vdekjen e tij
veç kur e lanë në një qoshe të oborrit lakuriq
e nga uji i dukeshin gjymtyrët e trupit
ishte aq i qetë sa nuk lëvizte as nga uji i nxehtë
kur tim atë e nxorën nga shtëpia
s'di nga erdhi e kush e nisi më i pari
por të gjithë bënin kuvendime në pikë të diellit
gjëmë e madhe ishte e vërteta, e vërteta ishte vdekje
kur gruaja me këmishë të bardhë më tha:
mos u mërzit se në atë dynja do ta takosh tët atë
se në këtë botë ke mbetur jetim
i bekuar a i pabekuar të ftoj të pish gji në gjoksin tim
këmishëshkopsitur prej gruaje
vetëm unë e ndieja atë fshehtësi
kur më ngacmonte shpesh për dashuri
pse duhet ta fsheh se kisha frikë
derisa pija gji nga koha ime prej gruaje
kur më vdiq im atë ditët dhe netët qenë njësoi
përveç të shtunave
që tashmë s'kthehej më nga pazari si dikur
mbi një kalë pullali me trokëllimat e shiut
që binte mbi gjethet e pemëve në atë stinë
II.
nesërmen që kisha mbetur jetim
dola për të kërkuar shitoren
ku im atë të shtunave më blinte këpucë prej llastiku
që sa herë i mbathja binte shi e mjegull
djemtë e pasherr të fshatit ma kishin lakmi
në atë qiellin e cuklavtë robëria e zezë dridhej
kur i kujtoj pleqtë që thurnin fjalë lufte
në një lëndinë plot gurë varri të panumërta
e rrëfimet e mbushnin lëndinën plot tym grotesk
dhimbja e tyre më përtokte
tash të gjitha kujtimet e vitet më braktisin
më kanë mbetur sall hijet e pazbërthyeshme të numrave
si alarm trishtimi për një dashuri të vjetër
kur im atë të shtunave m'i blinte këpucët prej llastiku
me një mjerim që vazhdonte e s'linte zgjidhje
nga një sëmundje e pavdekshme që na vriste
netëve dhe ditëve të së shkuarës
në atë kohën e territ që s'di ç' emër t'i vë
mjerimit s'di si t'i jap emër të kuptueshëm

Poezia në gegnisht e Asja Mulgecit është e ndikuar nga një serë fenomenesh, letrare, sociologjike dhe shoqërore

POEZIA E ASJA MULGECIT ËSHTË NJË PRURJE ORIGJINALE NË LETËRSINË BASHKËKOHORE SHQIPE, NJË RIPËRTËRITJE TË SAJ NËPËRMJET VARIANTIT GEGË

Nga dr. Mujë Buçpapaj

"Moderniteti i krijimtarisë së Asja Mulgecit është një zhvillim i brendshëm letrar, një tendencë individuale që shënon një ripërtëritje të poezisë shqipe në përgjithësi, nëpërmjet variantit gegë, si dhe një tendencë e përhershme zhvillimi dhe komunikimi me botën."

Poezia e Asja Mulgecit është një prurje origjinale në letërsinë e viteve të fundit. Me gegnishten e saj letrare ajo ka sjellë freski në poezinë bashkëkohore duke qenë e frymëzuar nga poezia më e mirë pararendëse shqiptare, si poemat epike të Mujit dhe Halilit të shkruara këtu e 12 shekuj më parë, poezitë e Bogdanit, Budit, deri tek poetët e shquar të Dukagjinit si Fishta, Mjeda, Gaspër Pali, Martin Camaj etj.

Moderniteti i krijimtarisë së Asja Mulgecit është një zhvillim i brendshëm letrar, një tendencë individuale që shënon një ripërtëritje të poezisë shqipe në përgjithësi, nëpërmjet variantit gegë, si dhe një tendencë e përhershme zhvillimi dhe komunikimi me botën.

Për disa shekuj me radhë qysh kur u shkrua kjo poezi në Alppet shqiptare dhe për rreth tyre deri në Shkodër, edhe tani pas vitit 1990 , ajo po shenon një kthesë të rëndësishme drejt pasurimit dhe modernizmit të saj, si rezultat i shumë faktorëve letrarë dhe jashtëletarë që paracaktuan frymën e kësaj poezie pas rënjes së kritereve ideologjike që e pengonin përdorimin e gegnishtes jo vetëm si gjuhë standarde të administratës, por edhe si gjuhë e letërsisë dhe kërkimeve shkencore.

Poezia në gegnisht e Asja Mulgecit është e ndikuar nga një serë fenomenesh, letrare, sociologjike dhe shoqërore dhe parasegjithash nga trashëgimia kulturore dhe letrare e trevës së Malsisë së Gjakovës, Tropojës. Kjo trevë e përmendur për epikën legjendare dhe historike shquhet edhe për një lirikë simbolike të rrallë dhe shumë të pasur. Asja mbetët një vijuese e kësaj lirike dhe e frymëzuar thuajse në çdo poezi prej saj.

Në këtë kuptim, Asja përdor një leksik specifik, toponime, mikrotoponime, nëntekste të një stili metafizik, po kështu edhe një figuracion të mbyllur, gjuhë të pastruar nga teprime e stërholl-ime të tepërta, pra një legjerimin sintetik deri në përsosje formale që vjen në kontrast me një poezi të mbushur me vargëzime të thata kompjuturike të viteve të fundit, duke u kthyer lexuesve shqiptar shijen e humbur të poezisë së mirfilltë. Ja disa vargje nga poezia "Nuk e di":

Si relikë e artë krahve t'hanës
Gdhendem do deshira, do andrra
Sperkatun pluhnit t'saj
Nji farfullimë e ftohtë rreth nadjes
Shploj synin e pagjumë
Ndërsa ai shtriqun krahve t 'saj
përmallshëm shkrehet n'vaj .

Një lirikë që mbart gjithë peshën e njohjes dhe gjetjes së dashurisë së jetës në një peisazh gati kozmik ku mungojnë vetëm Lugjet e verdha dhe zanat e Epikës për të rindezur fantazinë tonë, një poezi që është gjithnjë në paqe me natyrën dhe vetvetën, por që përqendrohet tek detajet dhe peisazhi.

Nga pikëpamja e cilësisë estetike, poezia e saj është një vijim i arritjeve tashmë të njohura të letërsisë së viteve 1990, një konsolidim i risive që pati arritur brezi pararendës i shkollës së poetike të Tropojës dhe i atyre arritjeve në përceptimin dhe refleksionin poetik, në strukturimin poetik dhe subjetin poetik, në mendimin poetik, në sferën poetike, kuptimore dhe ndjesore dhe në shumë elementë të tjerë që dalin veç e veç tek autorët e Tropojës si Ndoc Papleka, Skënder Buçpapaj, Hamit Aliaj, Almona Bajrami etj.

Ndërsa kam lexuar një numër të konsiderueshëm të poezive të saj të botuara në gazetën letrare "Nacional", kam konstatuar se veçori të poezisë së Asjas janë metaforizmi, misticizmi, simbolizmi dhe krejt modelet e tjera të përvetësimit të poezisë disashekullore të Alpeve. Këto veçori e dominojnë gjithë krijimtarinë e saj, si stil dhe ndjënjë individuale krijimi, me një synim të pandërprerë për të krijuar një ndërgjegjësim gjuhësor, se gegnishtja është një gjuhë e poezisë, për shkak të strukturave leksikore të ngjeshura, shpesh njërrokëshe që e bëjnë genishten shqipe edhe sipas studiuesve të huaj në një studim 150 autorëve të botuar këtë verë në revistën e famshme "Shkencore" në Gjermani "gjuhë mëmë të botës", apo "gjuha e vetme primitive në botë akoma e gjallë."

Këtë frymë përcjellin poezitë: "Dashnia ankorohet aty përjetë", "Je apo s'je", "Nuk e di", "Dashnia jëme e pathinjun", "Hirshëm projektohet çdo dashni", "Mos ndodhtë kurrë", "Ndalni","Mos vini dorë", "Det ndjenjash trazue", "Dorzan i fikjes së diellit n'sy", "Ah moj dashni" etj.

Një tjetër veçori e poezisë së Asja Mulgecit është përdorimi i një figuracioni të ri, autentik, duke e pasuruar leksikun e poezisë shqipe, duke rikthyer simbolikën identare të përdorur nga poezia shqipe që është shkruar në Kosovë dhe troje në vitet 1960-1990, por edhe nga poetët e famshëm të Tropojës, pas vitit 1970 dhe në vijim.

I interesuar për parapelqimin e autores për të shkruar në një gegnishte letrare kam marrë si përgjigje të sinqertë se autorja ka zgjedhur të shkruaj në gegnishte jo si sfidë ndaj standardit letrar, por si një mënyrë për të ndikuar në pasurimin e standardit me fjalë dhe forma të reja poetike të brumit të shqipes, fjalë që fjalori në fuqi i Akademisë nuk i ka përfshirë. Ja poezia "Ndalni mos vini re":

....E padurimit, ditën e thirra pa zbardh mirë
Frigueme , e vetme, shtratit n' errsinë

Mandej, krejt papritë m 'vinte afshi i tij
Si melhem m'futej n'dej
M'shtrëngonte mallshëm n'grykë
Un e lumnuemja tek shtriqja shpirtin lulnajash,
S'i mbaja dot trupit dallditë...

Poezia e Asjas ka nota ekzistencialiste, hermetike si një konstrast i qartë në krahasim me poetët tjerë bashkëkohorë.

Duke u përqëndruar posaçërisht tek analiza e gjuhës poetike, bashkë me ambiguiditetin apo dykuptimësinëe tyre, mendoj se poezia e Asja Mulgecit, mbart kuptimet më të fshehta dhe shtresat më të thella kuptimore, e shprehur përmes një forme sintetike, të ngje-

–"Mendoj se duke hequr dorë nga letarja standarde, Asja u dha me pasion pas kujdesit ndaj formës poetike, toneve, imazheve, ritmeve të brendshme dhe konteksteve të thella kuptimore, bazuar në një leksik origjinal dhe të bukur të gegnishtes, duke i dhënë shtysë një zhvillimi të ri, jo vetëm formalist, strukturor, por në përgjithësi gjithë jetës së poezisë shqipe të pas viteve 1990, si dhe duke e pasuruar me fjalë dhe shprehje të papërseritshme gjuhën shqipe, përfshirë edhe standardin letrar i cili duhet të fillojë të hapet ndaj leksikut gegë, fjalëve, strukturave dhe shprehjeve që do të pasuronin gjuhën tonë të bukur shqipe."

shur, ritmi dhe figuracioni origjinal, me një fjalë ky është edhe stili i poeteshës me origjinë nga Tropoja, i cili mbart dukshëm prirjet për ndryshim dhe eksperiment stilistik.

Poezia e Asjas është një poezi lirike e virtytit poetik dhe njerëzor që pavarësisht stilit të lartë dhe frymëzimit të fortë dhe shpesh të mbyllur, është e lidhur me fatin e shoqërisë së saj dhe kombit t e saj.Poezia "Hirshëm projektohet çdo dashuni":

Unë shpirtin kam ngul, palcës t'ksaj toke
Zemrën kam ngjyrue, në t' kuqin flamur
Njatij zhguallit t'artë, oazë e mjaltë
Ku dhimbjet shuhen e pritë ban loti
E hirshëm projektohet çdo dashuni!

Teknika e qartë dhe zgjerimi i sferës poetike deri tek figuracioni shpesh i errët dhe abstrakt, e bën akoma më të veçantë ketë poezi.

Liria njerëzore, humanizmi dhe pamja e brendshme e jetës, janë veçori poetike të saj. Po kështu lirizmi individual, është një tjetër element i përbashkët i poezive të saj.

Poetesha ka jetën e saj të veçantë dhe njëkohësisht edhe stilin e saj krijues, fjalorin, procedimin formalist, strukturën e të menduarit dhe të shprehjes, pra prurjen poetike individuale, mendoj krejt të veçantë.

Ajo krijon përgjithësisht një poezi refleksive, meditative, ndërsa kur shkruan bazuar mbi motive të së shkuarës, poezia e saj përshkohet edhe nga nota të metafizikës së epikës veriore. Sugjestioni ndaj qetësisë së përjetshme të Alpeve, është një motiv i përhershëm i poeteshës në këtë periudhë.

Metafora e kudogjendur, strukura e çlirët konceptuale dhe vargu i lirë tërësisht jashtë rregullave tradicionale, i japin asaj ngjyrat e një poeteshe specifike dhe moderne si p.sh: " digjesh si andërr, vjeshtë e mjegullt drunjore, dashni e ankorueme n'qiell, e yllzueme n'dritë rrufeje, me buzqeshje bjeshke, krahvë t'hanës përqafohet ethshëm, ngjitem qiejsh të shpresës, bujashkë zemre në pakthim", etj.

Siç konstatohet lehtë gjendja ekzistenciale dhe dilemat që fshihen në shumë poezi e shprehur kjo në forma të ndryshme procedimi, sintakse dhe ligjërimi poetik të lirë dhe të mëvetësishëm, e bëjnë Asjan një poete originale shqiptare.

Kritika përpos vlerësimeve shumë të mëdha, në ndonjë rast e ka sulmuar poezinë e Asjas si shumë "hermetike dhe të ftohtë", për "përdorimin e gegnishtes dhe strukturave të saj morgologjike dhe kuptimore", duke shprehur thjeshtë një moskuptim, apo një kulturë të sipërfaqshme të autorëve të këtyre kritikave, e cila mbetet sipërfaqësore dhe e pabazuar në argumente estetike. Një kulturë gjuhësore e ngushtë dhe shpesh me probleme të shumëanshme, nuk e ka ndihmuar kritikën e viteve të fundit që të zërë vendin e saj në gjykimin e drejtë dhe të paanshëm të letërsisë bashkëkohore, pra që të fitojë me meritë edhe vendin e saj.

Unë mendoj se ka patur një paragjykim për shkak të përdorimit prej saj të gegnishtes, pasi poezia e saj mbart autencitetin e llojit të poezisë meditative, filozofike, pa zhurma dhe britma, por që komunikon me jetën dhe njerëzit me gjuhën e saj shpirtërore dhe specifikën e saj të mendimit.

Mendoj se Asja është një poete i lirizmit natyror, burimor, poezia e saj krijon një ndjenjë të fuqishme dhe befasuese tek çdo lexues.

Asja ka edhe një strukturë të lirë poetike. Ajo shkruan me varg të bardhë, me varg të lirë, por edhe me rimë. Poetesha përdor strofen dyshe, strofen treshe, apo edhe strofën rregullt klasike, duke sjellë larmishmeri dhe mjeshtri të lartë proceduese.

Ajo shquhet pikërisht për kujdesin ndaj gjetjes së strukturave komplekse të grupeve të veçanta gjuhësore, veçori të gegnishtes, prej të cilave rrjedhin edhe nëntekste e mbartje të rëndësishme semantike dhe ideoartistike.

"Mbas syve t'bukur, mos u ban i marrë,
Mos i puth tinëz, hala pa i prek
Ata janë pasqyrë e shpirtit, smerald t'rrallë"
(Dashuria ankorohet aty përjetë).

Apo
"E padurimit, diten e thirra pa zbardh mirë
Frigueme e vetme, shtratit n' errsinë"
(Ndalni, mos vini dorë).

"Mos me pre n' besë
As diten kur t'vdes "!

Apo

"E në ndodhtë naj ditë t' venitet kjo magji
Stinët ngjyra kurrë mos paçin
U ngrifsha e mjerë me krye n' frangji
E lulet praverave pa çilë u thafshin...." (Dorzan i fikjes së diellit n'sy)

Po kështu ajo përdorë të gjitha llojet e rimave me zhdërvjelltësi dhe larmishmëri të plotë, duke dhuruar emocione dhe kenaqësi estetike tek lexuesit.

Asja Mulgeci hyri në poezinë e viteve 2000 si një poete e identifikuar shpejt për stilin origjinal dhe kompeks. Ajo shumë shpejt solli një frymë të re konceptuale duke liberalizuar vargun dhe modernizuar atë, duke zgjeruar tematikën dhe fjalorin poetik, duke bërë një revolucion në këtë fushë me përdorimin e gegnishtes letrare.

Poezia e saj është demokratike, novatore dhe e hapur për t'i dhënë kënaqësi estetike lexuesit të çdo kohe, pasi ajo inspirohet nga dashuria për njeriun, cilësia e jetës në liri dhe krenaria kombëtare.

Asja mendoj se është një fenomen në poezinë moderne shqipe. Përfytyrimet saj te vendlindjes janë të gjalla, mali, guri, kroi, lisi, bjeshka me imazhet e papërsëritshme etj, do ta frymëzonin gjithnjë krijimtarinë e tij.

Këto imazhe dhe imagjinata e shfrenuar e vendlinjdes së saj që do të ushqenin poezinë e saj në çdo rast dhe në çdo kohë.

KONKLUZION

Mendoj se Asja Mulgeci është një poeteshë përfaqësuese e gjeneratës poetike të viteve 2000 dhe një nga poeteshat më të shquara të letërsisë bashkëkohore.

Ajo së bashku me brezin e saj, u bënë nismëtare të një ndryshimi të madh në poezinë bashkëkohore shqipe, duke e zgjeruar shtratin tematik dhe natyrën strukturore të poezisë shqipe të kohës, fjalorin dhe metriken, duke e modernizuar dhe sofistikuar atë.

Asja ka një poezi metaforike, të bazuar kryesisht tek vargu i lirë me nëntekst të fortë filozofik si dhe të çliruar prej rregullave tradicionale të vargut klasik, po kështu përdorimit të metaforës dhe figuracionit abstrakt.

Asja ka krijuar një poezi si shprehje emocionale, individuale përmes një sistemi shpesh të ndërlikuar abstragimesh, përfshirë edhe metaforën, si dhe një strukturë më të veçantë ligjërimore.

Kjo formë shkrimi i ka dhënë një kuptim të ri poezisë së fateve njerëzore, duke e çuar atë drejt prirjeve të poezisë bashkëkohore europiane.

Asja ka një kombinim të çuditshëm mes elementeve të poezisë abstrakte siç është shenja, imazhi dhe gjurma metaforike e fjalës, me elementë e poezisë sociale me një shqetësim njerëzor por edhe një frymë universale të dashurisë ndaj familjes, jetës dhe Atdheut.

Kam vërejtur se stili i saj konciz, në gegnisht, kryesisht me vargje të shkurtra, dhe të ngarkuara emocionalisht, i kanë dhënë origjianlitete poezisë së saj dhe prirjeve të saj për ndryshim.

Ajo u përfshi me sukses në rrymën e ndryshimeve që pësoi poezia shqipe pas viteve 1990 me origjinalitetin e temave, ideve dhe strukturës poetike.

Mendoj se posaçërisht ajo ka sjellë në poezinë tonë më mirë se kushdo tjetër nga brezi i saj, imazhin e epikës së Bjeshkëve të Namuna, maleve të Tropojes, imazhin dhe mitin e Shkelzenit etj.

Në lirikën e dashurisë Asja ndjek impulset e veta krijuese shpirtërore, shprehur me një spontanitet letrar gjithnjë në kërkim të një forme të re shprehjeje poetike. Asja ka një inspirim edhe nga poezia klasike tropojane e shkruar këtu dhe shekuj më parë me Poemat Epike të Mujit dhe Halilit, si një substrat i fortë jo vetëm frymëzimi, por edhe procedimi poetik.

Mendoj se duke hequr dorë nga letarja standarde, Asja u dha me pasion pas kujdesit ndaj formës poetike, toneve, imazheve, ritmeve të brendshme dhe konteksteve të thella kuptimore, bazuar në një leksik origjinal dhe të bukur të gegnishtes, duke i dhënë shtysë një zhvillimi të ri, jo vetëm formalist, strukturor, por në përgjithësi gjithë jetës së poezisë shqipe të pas viteve 1990, si dhe duke e pasuruar me fjalë dhe shprehje të papërseritshme gjuhën shqipe, përfshirë edhe standardin letrar i cili duhet të fillojë të hapet ndaj leksikut gegë, fjalëve, strukturave dhe shprehjeve që do të pasuronin gjuhën tonë të bukur shqipe.

Mendoj se leksiku i saj shumë i pasur dhe i shpesh i rrallë, mund të jetë objekt studimi edhe për leksikografët tanë.

Në foto: ASJA MULGECI

Asja shpesh shkruan një poezi ku fryma e vargut të bardhë të Eposit tonë ndjehet qartë në shumë poezi duke përdorur me sukses edhe vargun e gjatë, përsëritjet, enumeracionet, aliteracionet, sinekdotat, ritmet, zërin mistik dhe kozmik të Alpeve, njëkohësisht, me jehonën nga legjendat dhe mitet shqiptare.

Gjuha e saj e figurshme, imazhi poetik, ironia dhe metafora e bëjnë poezinë e saj një krijim të veçantë në krejt poezinë shqipe bashkëkohore. Pra gjithë poezia e saj përfshirë edhe lirikat e dashurisë, ka një strukturë konceptuale, vetërrëfyese dhe imagjinative të një stili modern të shkruari. Proçedimi poetik, formacioni leksikor dhe figuracioni bazë e veçon natyrën ligjerimore të saj, e bënë atë një poezi interesante.

Asja në përgjithësi në krijimtarinë saj është një poete që eksperimenton në stilin e vet të veçantë me plot larmi shprehjesh, gjetjesh dhe kuptimesh të figurshme dhe shpesh abstrakte. Në pikëpamje të stilit dhe karakteristikave të tjera metrike Asja është origjinale, me ndjesi të forta frymëzimi dhe ndryshimi të vazhdueshëm. Ajo shkruan me një sintaksë krejt të ndryshme, të veçantë si strukturë dhe mendim, krahasuar me poeteshat e tjera bashkëkohore.

Ky stil poetik i Asjas është një sintezë e përvojave të saj individuale, që shfaqet si një kombinim i miteve të Tropojës dhe rezistencës ndaj ndryshimeve sipërfaqësore që kanë përfshirë poezinë shqipe të 30 vjetëve të fundit.

Mendoj se ajo do të na japë edhe në të ardhmen një poezi të suksesshme, pasi e ka fymëzimin, kulturën e gjërë letrare dhe njerëzore, si dhe sigurinë e një mjeshtreje të vërtetë të vargut dhe figurës me rrënjë tek gegnisshtja letrare.

E shtunë , 13 janar 2024
NACIONAL

TRE LIBRA ME EPIGRAME BASHKËKOHORE TË VIRON KONËS

Shkruar nga: Fran GJOKA

-Vështrimi i studiuesit-

"Zgjidh rrugën tënde!" është libri i tretë me epigrame i shkrimtarit të njohur Viron Kona. Ky libër vjen pas dy librave të pëlqyer nga lexuesi "I zemëruari" dhe "Zot i fatit tim!" Libri përmban 101 epigrame, një numër ky i parapëlqyer i autorit, si të dojë të na tregojë se edhe në të ardhmen do të vijojë të shkruaj në këtë lloj letrar tepër tërheqës për lexuesit. Janë të kërkuara epigramet për disa arsye, midis të cilave po përmend shkurtësinë e tyre. Me pak vargje, autori shpreh mendime të mençura, që herë për njërin lexues e herë për tjetrin shërbejnë edhe si mësime për jetën. Duket që shkrimtari Kona me jetën interesante që ka bërë, me vështirësitë që ai ka kaluar, por edhe me talentin dhe kulturën e lartë të të shkruarit, arrin që të krijojë epigrame të atilla, që të mbeten në mendje dhe, krahas entuziazmit që shkaktojnë gjatë leximit ato admirohen nga lexuesi për bukurinë e vargut dhe mesazhet mbresëlënëse që përcjellin.

Siç shkrova në fillim, janë tre libra të tillë. Do të dëshiroja të qëndroja shkurtimisht pak radhë te secili prej tyre.

Mesazhe dobiprurëse

"I zemëruari", të cilin nuk e gjejmë në tregun libror, përcjellë mesazhe për përditshmërinë e jetës, duke vënë theksin në ato probleme jetësore që na shqetësojnë më shumë. Kanë të bëjnë ato me probleme social ekonomike, kulturore – artistike apo aty - këtu edhe politike, ndërkohë që na duket sikur autori na merr për dore dhe na rrëfen herën njërën "bimë" të kopshtit të tij krijues dhe herë tjetrën. Janë përmbajtje që na shkaktojnë entuziazëm me mënyrën se si e përcjellin mesazhin, teksa na vënë edhe në mendime për çështjet e ndërlikuara që ndeshim në rrugën tonë të jetës apo që na pengojnë të ecin përpara, ashtu siç pengojnë njeriun kurthet dhe mentalitetet e dëmshme, konceptet e gabuara apo padituria dhe injoranca. Nga libri "I zemëruari", te shumë lexues kanë mbetur të fiksuar fort në mendje epigrami: "Shqipëria - ëndrra dhe shpresa,/vendlindja e bukurive të Dheut, /këtu ndihem i lirë si shqiponja,/ këtu ndihem i fortë si Anteu."(Shqipëri);"Vargjet pa mendim:/trena,/që bosh venë e vijnë"(Vargjet pa mendim);"Si qentë, /nga larg të përgjojnë,/heshtazi të ndjekin pas,/ çastin presin të të kafshojnë". (Spiunët);Ai e do popullin me një trup dhe me një fytyrë,/mundësisht me një kokë dhe me një gojë,/do që ta përdor si një makinë me kurdisje,/do që ta ndezë dhe ta fikë sa herë të dojë.(Diktatori);" Mos bëj veprime të nxituara,/kur pendohesh është vonë,/Këtë, më shumë se të tjerëve,/duhet t`ia themi vetes sonë"(Kështillë)... Kështu me ritëm dhe ide vijojnë dhjetëra epigrame si "Xhelati", "Mjafton një kockë", "Diploma e kryetarit", "Kur nisi beteja", "E keqja", "I ngjitur", "Një kovë", "Miqësia në provë", "Mos e tepro!", "Njeri, je apo s`je?", "Gjashtë profesorë", "Forca e kohës", "Ca princër, ca argatë" etj. etj.

Epigramet e këtij vëllimi shprehin opinionin se "Epigrami ka në themel, edhe formën tërheqëse, po aq edhe vet mendimin e mençur që përcjellë te lexuesi ide, motive dhe mesazhe dobiprurëse".

Freski, dinamizëm dhe energji

Mund të them që vijim i librit të parë, janë edhe epigramet e vëllimit të dytë të titulluar "Zot i fatit tim", ku autori sikur i bën thirrje lexuesit që ta marrë vet në dorë fatin e vetë, t'i bëj vet punët dhe detyrat që ka në jetë, të mos pres që ato t`i marrë të gatshme. Përkundrazi nëse i lë ato në rrjedhën spontane dhe nuk tregohet aktiv, atëherë vështirësitë e jetës së tij janë edhe më të mëdha e më të ndërlikuara. Mesazhi artistik shfaqet mbresëlënës sidomos tek epigrami: "Ca grurë e ca egjër" ku autori shkruan: "I dija se ishin të gjithë engjëj,/vija për ta dorën në zjarr e në zemër,/por, kur nisën të ndaheshin pronat,/ca dolën grurë e ca dolën egjër."; Xixëllonjë": "Respektoje një xixëllonjë,/jetën ajo nuk e çon dëm,/kur natën fluturon,/një dritëz e bën."; "Ato që dua vetë": "Vite të tëra bëra ato që më thanë,/me mendjet e të tjerëve eca në jetë,/por, tani, ju lutem, mjaft më,/do të bëj ato që dua vetë!";"Kur": "Kur për interesat e tua vetjake,/ tradhton shokët dhe vendin tënd,/të gjithë do të të zbojnë me neveri,/si një akrep që u lëvrin nën këmbë!";"Mos u brengos miku im!":"Rrugën s`ta ka zënë askush,/ka vend plot, për ty, për mua,/ec, mos ngurro, tregoje veten,/mos u tërhiq, kështu të dua!" Mesazhe mbresëlënëse shfaqen edhe tek epigrami "Ke para, s`ke para", ku autori shkruan: "Ke para, je dijetar,/ke para, gjithnjë fiton,/ke para të drejta ke,/ke para, botën sundon". "S`ke para, je budalla,/s`ke para, asgjë ti s`di,/s`ke para, kot ekziston,/s`ke para, s`ta var njeri!". Se çfarë vlerësimi bën autori për fëmijët, që janë edhe personazhet e tij më të dashur te librat e tij për fëmijë, këtë e kuptojmë edhe tek epigrami: "Engjëjt". Autori shkruan: "Nëse ekzistojnë engjëjt,/me siguri ata janë fëmijët./ Nëse nuk ekzistojnë engjëjt,/engjëj kemi fëmijët,/Nëse duhet t`i krijojmë engjëjt,/ata përsëri do të jenë fëmijët!" Mesazhe po aq të fuqishme duken edhe tek epigramet: "Mirënjohës e mosmirënjohës", "Harrojmë veten tonë!", "Zot i fatit tim", "Me njëri-tjetrin", "Lojë", "Zhgënjimi", "Ironi", "Ti vet cili je?", "Vendin e minjve", "Mendja jote si llamba", etj. etj. Pajtohem plotësisht me njërin nga recensentët e këtij vëllimi e konkretisht z. Bujar Agalliu, i cili duke analizuar e vlerësuar epigramet e Viron Konës, mes të tjerash shkruan: "Në epigramet e vëllimit "Zot i fatit tim", bie në sy tematika e gjerë, por edhe fjalë dhe shprehje të figurshme, e sidomos metaforat, që janë karakteristikë e krijimtarisë së këtij autori, ashtu dhe figura të tjera letrare si metonimia, simbolet, epitetet, krahasimet, por edhe ironia e sarkazma, të cilat i japin më shumë fuqi, freski, dinamizëm dhe energji epigrameve të këtij vëllimi".

Epigrame transparente dhe të drejtpërdrejta

Kurse tek epigramet e librit "Zgjidh rrugën tënde!" Viron Kona që në titull na përcjell mendimin se "ti vet e ke në dorë rrugën tënde për të ecur në jetë", ndërkohë që ai bën objekt të epigrameve edhe tema të mprehta të ditës si korrupsioni, zhvatja, shpërdorimi e vjedhja e pasurisë së popullit, padrejtësia, tjetërsimi i njeriut, ashtu dhe makinacionet për të mbuluar gjurmët e krimeve dhe të këqijave të tjera që ndodhin. Tek epigrami "Si urdhëron zotëri!, autori godet servilizmin, përuljen ndaj zyrtarëve të lartë e të korruptuar, të cilët vjedhin e pasurohen në kurriz të popullit, por kur ata zbulohen, përgjegjësinë ua lënë vartësve të përulur, që më mirë se çdo gjë tjetër përsëritin togfjalëshin "Si urdhëron zotëri!" Autori shkruan: "Kur vjedhja dhe korrupsioni dalin në skenë,/të mëdhenjtë e shfaqin veten viktima e pa përgjegjësi,/veprojnë si gjarpërinjtë që ecin e fshijnë gjurmët me bisht,/fajet mbeten te vartësit e përulur që thonë: "Si urdhëron, zotëri!". Kjo temë shfaqet edhe tek epigrami "Oktapod dhe kriminel", ku autori i krahason mafiozët dhe krimelët e rrezikshëm me oktapodin, këtë grabitqarë të njohur të deteve, që maskohet mjeshtërisht kur ndien rrezikun: "Oktapodi tetëkëmbësh grabitqar i njohur,/sapo ndien rrezikun lëshon bojën në det,/ashtu bëjnë edhe mafiozët e kriminelët,/kur duan të fshehin krimin e vetë". Kur shkruan për grabitësit, Kona ka parasysh jo vetëm grabitësit e pronës shtetërore apo individuale, por edhe grabitësit e punës intelektualëve të njerëzve të ditur, të cilët të përfshirë në punën e tyre ideore, shkencore, pedagogjike, artistike e letrare harrojnë se përreth mund të kenë nga ata që ua përvetësojnë apo tjetërsojnë idetë dhe mendimet. Shkrimtari i krahason këta lloje grabitësish me minjtë e drithit në hambar. Ja se si shkruan autori tek epigrami "Grabitësit": "Punën dhe arritjet e njerëzve të ditur,/ mundin e tyre intelektualë shumëvjeçar,/e grabitin dinakët që u vijnë rrotull,/si minjtë e drithit në një hambar!" Këtë ide, Kona e shfaq edhe tek epigrami "Miu", duke fshikulluar fort ata gjoja "artistë" që përvetësojnë punën artistike të të tjerëve: "Rrëmbe këtu dhe rrëmbe atje,/një metaforë dhe një metonimi,/ i shton në librin tënd me vargje,/n 'botë s`gjen tjetër "poet" si ty!/Bëhesh si miu që çdo gjë lëpin,/ ushqim me aromë kudo kërkon,/por edhe nëse çarku ka defekt,/diku te qoshja macja përgjon."

Si dhe në librat e mëparshëm me epigrame, "I zemëruari" dhe "Zot i fatit tim!", edhe në këtë libër të ri, Viron Kona është transparent dhe i drejtpërdrejtë në ato çfarë shkruan. Ai dallohet për stilin e zhdërvjelltë, për çiltërsinë dhe sinqeritetin e plotë, për botën e tij të pasur letrare e artistike, për ndjeshmërinë ndaj jetës dhe dukurive më të qenësishme të saj. Janë disa epigrame që fokusojnë problemet që ka drejtësia shqiptare, probleme këto që kanë shqetësuar jo vetëm popullin shqiptar, por edhe Evropën dhe botën e përparuar. Autori ndalet veçanërisht tek veset e disa prej gjyqtarëve të korruptuar, por edhe te zvarritjet e mëdha të çështjeve të drejtësisë. Janë një sërë epigramesh që pasqyrojnë këtë dukuri, e midis tyre po përmendim epigramet: "Pa fund", "Nga i ri bëhesh plak" etj. Qëndrim demaskues mban autori edhe ndaj disa të rinjve, të cilët të përfshirë në botën e krimit, bëjnë allishverishe me kriminelë për të kryer vrasje me pagesë, sepse këtë ua kërkojnë "punëdhënësit". Në epigramin "Profesion" autori shkruan: "Si në filmat me horror,/vrasja u bë profesion,/dy veta bien në ujdi,/njëri vret, tjetri paguan." Autori i kujton me gjuhe artistike lexuesit të jetë sa më realist dhe i vërtetë në jetë, të mos përulet as nga vet hyjnizimi i disa njerëzve që veshin petkun e gjoja të paprekshmëve dhe të pandëshkueshmëve: "Mos hyjnizo askënd në këtë botë,/mos u gjunjëzo para tyre, o njeri,/ata i thurin vetvetes kurora e lavdi,/ s`janë perëndi!"

Epigrame që shprehen përmes hidhësisë së sarkazmave

Viron Kona, si një shkrimtar me ndjenja të thella kombëtare fshikullon gjendjen e rënduar dhe pasigurinë sociale-ekonomike të vendit, që i detyron njerëzit, herë si individë dhe herë familjarisht të marrin arratinë dhe ta "braktisin" Shqipërinë për një jetë më të mirë ekonomike. Tek epigrami "Dhimbje poetike!" autori shpreh dhimbjen e tij, duke përdorur një ironi të hidhur, sarkazëm: "Tani bota s`ka më porta,/mbathjani e mos ngurroni,/ s`janë kurrkush para nesh,/Magelani dhe Kolombi...!" Autori e mbyll librin me një epigram që ai e konsideron edhe "epilog" të librit. Është epigrami "Lekë të vjetra apo lekë të reja?", që autori ua kushton pensionisteve, të keqtrajtuar nga shteti me pensione krejt të pamundura për përballimin e jetës. Ja dy strofa nga ky epigram: "-Të kërkoj falje, o bijë, ti ke shumë t 'drejtë,/ ne me ato lekë të vjetra merremi mirë vesh,/s`ke pulën, do hash sorrën, - thotë populli!,/ ne, na e dhanë sorrën, na e bën peshqesh!"

E uroj shkrimtarin e palodhur Viron Kona për kënaqësinë që na dhuron me këto tre vëllime me epigrame, të cilat na emocionojnë dhe na shërbejnë si mësime dhe mesazhe të dobishme për jetën!

PSEUDOMODELET INTELEKTUALE DHE MITI I MERITOKRACISE



DR.EDUARD A.SKUFI
ATHINE

Debati me disa kolegë italianë e francezënë një interval në simpoziumin e glaukomës në Milano para pak kohësh, më stimuloi mendimin për të trajtuar problemin e titujve shkencorë të akorduar. Si rastësisht një koleg francez mes politesës inokuloi ironinë , duke thënë se : " në Shqiperi gjen më shumë njerëz me tituj , se sa nga ata pa tituj . Inteligjence ' eksesive ' apo mungese kriteresh " ? Une ju përgjigja me refuzimin që i bënë ata Molierit ,duke mos e pranuar në akademine franceze, (gabim që e korigjuan pas 6 brezave) , duke i cituar fjalët e poetit M. Étienne , në inagurimin e monumentit të Molierit , në Akademinë Franceze : " E lumtur epoka jonë që shlyeu detyrimin e gjashtë gjeneratave në një ditë " . Kjo tregon kriter ? , I thashë duke buzeqeshur , ai nuk u përgjegj por mbeti I shtangur mbas ' komentit ' tim … Megjithëse thënia e tij ishte hiperbolike , por fshihte dicka të vertetë ,heshtur , por prezente… Këtë shqetësim jo rastësisht e kisha dëgjuar në biseda e debate dhe nga disa intelektualë shqiptarë , që theksonin se jo rallë

titujtë shkencorë dhe titujte honorë nuk shkojnë tek ai që e meriton , kështu që kjo përbënte preokupacion .Procedura dhe mënyra e dhënies të titujve shkencorë dhe të nderit është jo vetëm një çështje komplekse e rëndësishme por edhe pikë nevralgjike . Dekadat e fundit ajo ka marr formën e një epidemie progresive gjeometrikisht .

Diskutohen mjafte titujt shkencorë (akademikë dhe honorë) ' sipas kërkesës dhe jo meritës. Dhënia e titujve akademikë pa kriter ' fabrikon ' pseudoshkencëtarë dhe një '

civilizim sugjestionues ' por ireal . Fenomen pseudo meritokratik që asociohet me klishe dhe stereotipi anakronike . Kështu st artificialisht zhvillimi I shkencës , duke rritur në numër ' pseudo modelet ' dhe hibridet , të cilat penalizojnë ' përmasat e vlerave të vërteta . Do tërikujtoj thënien picante të polimathistit Benjamin Franklin :" Lavdërimi për të pamerituarit mbetet një satirë e ashpër ". Nuk jam ' scienometrist ' por ekziston nje postulat shkencor : përqindja e lartë , në disponimin e titujve shkencor akademikë të nje vendi nuk mund të ketë si

paradoks , numrin më të ulët të artikujve shkencorë të publikuar . Eshte fakt se një vend me studime dhe kërkime shkencore insuficiente vetvret avenirin por dhe civilizimin e tij . Vec kesaj gradat akademike dhe honoret shoqërohenme atribute , të cilat u japin subjekteve të tilla ,

jo vetëm pseudoprestigj shoqëror , por promovojne përfitime dhe privilegje aksesore . Ndërsa ata duhet të vlejnë faktikisht si model dhe inspirim për

gjeneratën e ardhme … Ndoshta eshte momenti të reflektojnë mbi ekuivokun e motos ' modeli I shkencëtarit apo shkencëtari model ' , jo si nocion filozofik por si realitet. Sugjerimin e gjejmë tek citimi i V. Hygoit : " E ardhmja u takon njeriut të mendimitdhe njeriut të punës ". Për konseguencë praktika e titujve tëakredituar pameritë me konvergim interesash , si deficit

real intelektual , dancon në ' hard rockun ' emediokritetit me varferinë spirituale , në një binomfatal , të inspiruar nga ' kulti teknokratik dhe idea e mosdiskriminimit ' . Meritokracia ideale duhet të bëhet ' statussocial ' duke vlerësuar meritat dhe ekselencën e vërtetë .

Këtu në mënyrë analoge shpreh mirënjohjen për figuratintelektuale profesorësh të nderuar , e të merituar po dhe' regretin ' tim për shume personalitete intelektuale harizmatike , pedagogë dhe kolegë , një ' perlë ' e vërtetë, që mbetën 'profesorë pa tituj ',të lënë në harresë denigruse, në një ' vlerësim të munguar ', por që me veprën e tyre u

vendosën në eternitet . Memorja e mirënjohjes publike i ka skalitur në epitafin dedikues : " Lavdia e tyre nuk kishte nevojë për historinë , historia ka nevojë për ta ! "

Tingëllon si akuze citimi filozofik i Aristotelit :

" Forma me e ulët e pabarazise eshte

perpjekja për të bërë të barabarta , gjërat e pabarabarta . "

Meritokracia dismorfike eshte argumenti më negativ kundër demokracisë , si asistencë vitale e hierarkisë , si fabulë absurde në një retorikë mbi një demokraci ' hybrid ' , që

reklamohet si ' prioritet ' . Mbetet paradoksale metamorfoza magjike e disa kuadrove të cilët ngrysen thjeshtë si ' vokacion ' dhe gdhihen si ' profesor ' , për më tepër kur njihen si ish studentë të padalluar dhe profesionistë ordinerë . Por ata shfaqen si

meteor dhe ashtu shuhen në nje trajektore pa gjurmë … Këto pseudomodele intelektuale jane si një ' maskarade ' autosarkastike , regresiste që infiltron në histori , me ' falsitet ' kultural e Inspiruar nga " hipokrizia si një ves në modë dhe kur të gjitha veset e modës konsiderohen virtyt ", citonte Molieri . Me sa duket këtë spektakël e monitorojnë subjekte , që si ' maitre të ireales dhe psudoshkences ' improvizojne variacione të ndryshme , duke i bërë ato ' gënjeshtra të kamufluara ' , të tingëllojnë si të vërteta ! Universi i dijes nuk e aksepton formalizmin por e abordon , si deti papastertitë dhe mbeturinat pa vlerë . Edukimi perfekt eshte licenca më precioze e të ardhmes dhe jo ' status kontroversial

' apo ' komforti ilusiv ' . Parimet e kësaj meritokracie ' atipike ' mbeten insuficiente . Shoqëria në esencë ' ideale ' , inspirohet nga shkalla e lartë e edukimit dhe principet ' egalitare ' të meritoktacisë , cka

promovon vlerat e vërteta dhe talentet .

Meritokracia ka të bëjë me lirinë e vërtetë ,me përpjekjen për të përsosur njerëzimin dhe për të krijuar një ' parajsë tokësore ' , thekson shkrimtari modern , Michael Faust .

Meritokacia esenciale presupozon një transparencë radikale , që stimulon ekselencat dhe jo ' imitacionet ' .

Shkalla dhe niveli i edukimit shpreh atë të civilizimit .

Alternativa në këtë temë mbetet vizioni i rinovuar i taktikave dikasteriale , që tashmë titujtë shkencorë të mos akreditohen ' sipas kërkesës (apo nevojës) , por sipas meritës ' . Akordimi i titujve duhet të ketë primare kompeticionin etik , mandej vlerat shkencore . Aksi kryesor është vetëm koherenca e misionit didaktik , në raport me vlerat e transmetuara , që meritokarcia realisht të mos mbetet një ' mith ' , apo pseudomeritokraci por

të jetë një meritokraci e vërtete , larg perversionit , nepotizmit apo privilegjeve të veçanta .

Dhënia e titujve të jetë vendim konsensual , bazuar në parimet e vlerësimit të ' kontributit për vlera ' dhe jo për konsum , kompetent dhe eficient në akordim dhe jo impakt i ' preferencesklienteliste ' . Modelet ekselente intelektuale bazuar në teorinëmoderne të " zhvendosjes të paradigmës " dhe krijimit tëstandarteve neoterike ,duhet të bëhen objekt inspirimi dhemotivimi. Ato duhet tëshprehin një ' nder ekskluziv ' të merituar , jo traditë spekulative . Opsionet e mundshme , në kontekstin epistemologjik për të përmirësuar cilësinë e shkencës të vendeve të rajonit dhe vlerësimit të saj duhet të diktohen nga një format modern mbi kriteret dhe standartet . Normat e etikës shkencore mbeten principet bazë të veprimtarisë shkencore , të cilat duhet të jenë të pranishme në cdo vlerësim si vlera universale , me integritet dhe objektivitet. Vetëm në këtë mënyrë ' trashgimënia kulturoreshkencore ' , do të mbetet aseti më me vlerë dhe kontribut për inspirim dhe jo nje iluzion komfort- iv .

Vijon nga faqja 16

ualitete të nivelit kombëtar e ndërkombëtar. Fatime Sokoli mbetët një këngëtare e fashme e cila na vjen kaq e gjallë në të tëra përmasat artistike, njerëzore dhe emocinale, nëpërmjet këngës së përmallshme të Arif Dushajt, një vazhdues i denjë i shkollës muzikore të Fatime Sokolit, krahas yjeve të tjerë të kësaj treve si Fatmira Breçani, Gëzim Nika, Zef Beka, Arianit Hoxha, Dionis Delia, Anila Hoxha, Lekë Pecnikaj , Soni Malaj etj.

Interpretimi i Arifit e dientifikon atë si një këngëtar të madh që nderon një artiste të fashme të ndarë nga jeta 1987, si një tjetër dëshmi e këtij këngëtari e dashurisë së tij ndaj trashëgimisë tonë kulturore, posaçërisht të muzikës së Tropjës dhe F. Sokolit, si pjesë e rëndësishme e kuturës tonë kombëtare.

Arif shumë urime për këngën! E degjova disa herë me kujdes.Meleodisë së Fatimes i ke dhënë ngjyrime të reja dhe emocione të forta, ndërsa i ke dhënë individualitetin tënd të spikatur në interpretimin e këngëve epike, burimore të Tropojës. Të lumtë ! Edhe teksti i Ibrahimit shumë i mirë dhe shkon natyrshëm me meleodinë. Të dy bashkë na e keni ringjallë një nga këngëtaret më të dashura të shqiptarëve kudo që jetojnë. Artisti që kujton dhe nderon artistët e shquar si Fatime Sokoli është i nderuar përjetë. Suksese!

Miqësisht,
Mujë Buçpapaj

KANGË PËR FATIME SOKOLIN

Nga Ibrahim Dauti

Diell e hanë , o po lëshojnë dritë
N'Dragobi, o kur leu kjo çikë
Ku fryn flladi, o në atë grykë mali
Emri i saj Fatime Mani.

Po t'baj be, o në qiell e dhe
Në Tropojë, shoqja jote ma s'le
T u rrite në bjeshkë e në male
Ti u bane, o kënëgtare e madhe.

Ty perjetë po të këndohet kanga
Si në djep të përkundi nana
Je në këtë dhe, ku shijon jeta
Si në lulet ku merr bleta.

Zani yt bani jehonë
N'Gjirokastër, o deri në Kosovë
Për Kosovën, o kishe shumë mall
Disaherë i këndove kangë.

Lëshoe moj tokë të dalë prej vorri
T'këndojë edhe njëherë Fatime Sokoli
Me atë za si zog bylbili
Aromë lulesh, o more tradafili, o hej.

"QEVERISA E SHQIPËRISË GJATË LUFTËS II BOTËRORE 1939-1944"

"Qeverisa e Shqipërisë gjatë luftës II botërore 1939-1944" duhet parë si një kontribut i rëndësishëm demistifikimti të njëës ndër periudhat më dramatike nga fillimi i Lufëts së Dytë botërore 1939-1945, me ç'rast Shqipëria ishte viktima e parë e fashizmit italian, ndërkohë që pas shpërbërjes së Jugosllavisë në prill të vitit 1941, viset e pushtuara prej saj nga vitet 1912 pjesërisht iu bashkuan imperisë së Musolinit...

Nga Jusuf Buxhovi

Libri i Gjet Ndojt "Qeverisa e Shqipërisë gjatë luftës II botërore 1939-1944" duhet parë si një kontribut i rëndësishëm demistifikimti të njëës ndër periudhat më dramatike nga fillimi i Lufëts së Dytë botërore 1939-1945, me ç'rast Shqipëria ishte viktima e parë e fashizmit italian, ndërkohë që pas shpërbërjes së Jugosllavisë në prill të vitit 1941, viset e pushtuara prej saj nga vitet 1912 pjesërisht iu bashkuan imperisë së Musolinit, ndërsa në tetor të vitit 1943, pas kapitullimit të Italisë fashishte, pushtimi gjerman rezultoi me krijimin e Qeverisë Shqiptare, e cila riktheu jo vetëm pamjen etnike (me 74 mijë kilometra katrore), por anuloi të gjitha vendimet e qevrisë fashiste si dhe krijoi institucionet e pavarura: ushtrinë , xhandarmarinë , bankën shqiptare dhe të tjerat.

Gjet Ndoj sjell një pamje të rëndësishme të këtyre zhvillimeve kryesisht duke u mbështetur mbi dokumentat e arkivit shtetëror shqiptar. Ajo që ka rëndësi me këtë rast, është përfshirja objektive e Qeverisë Shiptare itutcioneve të shtetit të pavarur shqiptar nga themelimi në nëntor të vitit 1943 e deri te largimi në nëntor të vitit 1944. Autori paraqet momentet më të rëndësishme si dhe zhvillimet në qeverinë Mitrovica, Biçoku dhe e F. Dinos.

Promovimi i këtij lirbi në Mitrovicë ka po ashtu rëndësi, meqë akterët kryesor të kësaj qeverie (Xhafer Deva, Rexhep Mitrovica e të tjerë) vinë nga ky qytet, po që ishin të rëndësishëm në uvertyrën e saj nga kapitullimi i Jugosllavisë në vitin 1941, kur, pjesa e Mitrovicës dhe veriu u përfshinë në Qeverinë e Nediqit nën protektoratin gjerman. Roli i Xhafer Devës në këtë qeverisje, ndonëse në rrethanat e një qeverie kuislingë të Beogradit, ishte me interes, meqë në marrëveshje me gjermanët, instaloi autonominë shqptare në veri me arsim në gjuhën shqipe, xhandarmari shqiptare si dhe institucione të tjera të pavarura. Kjo fazë e qeverisjes, pamëdyshje se ia hapi rrugët Shtetit Shqiptar të formuar në nëntor të vitit 1943 si dhe rikthimit të identitetit të tij shtetëror në përmasa etnike. Ky proces u përcoll me mbajtjen e Kuvendit të Dytë të Lidhjes së Prizrenit në nga 16-20 tetor që i dha legjitimitet Ansamblesë Kombëtare si dhe Qeverisë Mitrovica e cila lidhi marrëveshje me Vermahtin gjerman për neutralitet.

Ky kapitull, i anatemuar nga historiografia ideologjike shqiptare, me këtë vepër dhe me ato të ngjashmet (Tokat e Lirueme nga R. Gurakuqi), ndihmon që historisë shqiptare t'i rikthehet një hallkë e rëndësishme e shtetndërtimit në rrethanat tejet dramatike siç ishin ato të Luftës së Dytë Botërore, ku shqiptarët kërkonin që të korrigjoheshin padrejtësitë e vendimeve të Konferencës së Lonndrës. Po ashtu, ku libër, ndihmon që njëri ndër personalitet kyçe të këtyre zhvillimeve, Xhafer Deva, të dalë në një drejtë objektive, si një intelektual që punoi për një Shqipër etnike, antikomuniste, që rrjeshtimi në anën e fuqive të boshtit si dhe fitorja e komunistëve në kuadër të Fanifashisht Nacionalçlirimtar jo vetëm që i rrënoi frytet e saj, pra riktheu pushtimin e Kosovës dhe viseve të tjera shiptare nga Jugosllavia, por krijoi rrethana për një hakmarrje të përgjakshme të komunistëve kundër nacionalistëve shqiptarë me mbi 50 mijë viktima. Kjo hakmarrje vazhdoi për mbi një gjyshmë shekulli edhe në historiografinë shqiptare me anatemimin e tyre si "kuisling", "fashistë" e të ngjashme, paçka se kjo i dha një pamje tejet të shtrembëruar dhe të njëanshme gjith; procesit kompleks të shtetndërtimit shqiptar në të gjitha fazat.

(Theksime nga fjala gjatë promovimit të veprës "Qeverisja e Shqipërisë gjatë luftës II botërore 1939-1944) në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë)



Dëshira për të shkruar diçka është e lehtë, ndërsa dashuria për të shkruar atë që duhet është e vështirë

Nese shikoni me kujdes kete fotografi, aty dalin ne pah disa tipare, si ato fizike por dhe ato qe lidhen me teresinë e elementeve karakterizuese e individuale qe bejne diferencën nga nje njeri tek tjetri. Njeri i qeshur, i çilter , terheqes, komunikues, tolerant bashkëpunues, bujar, i thjeshte, human, dhe i papertuar, tipare e veti keto qe i manifestonte, ne familje, pune, shoqeri e kudo ku asistonte prezencën e tij.



"Vellait tonë ALBERT KRUJA"

Linde si banor i perkohshem ne kete toke, vdiqe per tu bere banor i perhershem i kesaj bote vellai jone i dashur Albert. Abert Kruja i datelindjes 21.05.1954 ne date 6 Janar 2024 mbylli syte per te hapur nje faqe te re ne historinë e tij, te para dhe te pasvdekjes si njeri i Zotit, si vella, bashkshort, prind, gjysh, shok, mik, koleg e demokrat, si nje qytetar i denje i qytetit tone Peqin. Nese shikoni me kujdes kete fotografi, aty dalin ne pah disa tipare, si ato fizike por dhe ato qe lidhen me teresinë e elementeve karakterizuese e individuale qe bejne diferencën nga nje njeri tek tjetri. Njeri i qeshur, i çilter , terheqes, komunikues, tolerant bashkëpunues, bujar, i thjeshte, human, dhe i papertuar, tipare e veti keto qe i manifestonte, ne familje, pune, shoqeri e kudo ku asistonte prezencën e tij. Mjek Veteriner gjith jeten e tij. I lidhur me profesionin, me librin, me shkencën, si ate ne teresi e ate profesionale ne veçanti. Jeta deshi qe te provonte veten dhe ne 33 vjet ne demokraci, ku edhe pse ne shume raste mund te ngjitej ne kariere si per per shkak te personalitetit qe ai mbarte, por dhe te aktivitetit partiak ne kete qytet per vete pozicionin e tij si drejtues i PD, si Sekretar i deges Peqin, ai nuk kerkoi asnjehere pushtet, por kenaqej kur shoket e tij te mire perfaqesonin vlerat e mira njerëzore ne shërbim te qytetareve te rrethit tone. "Harronte ate qe nuk kishte bere dhe bente ate qe duhej bere". E drejta do te thoshte ai, eshte koncept, ndërsa e vërteta eshte realitet, prandaj te ndjekim kete. Pati nje detyre te veshtire dhe ne familje (krahas te tjerave si ne cdo shtepi e familje) ku jetoi, per ti sherbyer e qendruar shume afer per 29 vjet (1995-2024) rrjesh vellait te tij te paralelizuar Benon, ku me veprimet e tij përtej cdo sakrifice e shnderroi kete "barre te rende" ne nje fat te mire te jetes se tij duke u bere njesh me te. Eshte per tu admiruar. Pranonte te behej pjese e halleve te te tjerëve, ndërsa "sikletet e veta" mundohej ti perballonte vete. Do te ruajmë kujtimet me te mira te vllait tone, duke theksuar faktin se vertete, ishin te shume mira, por dhe ndonje porosi apo keshille te tij ne raport me gjera si te rastesishme, por dhe te qenesishme ne jete. Duke lumturuar vellain tone me keto rrjeshta qe domosdoshmerisht i takojne, skalisim ne memorjen historike shprehjen e njohur, " Me vdekjen bashke udhëtojmë, asnjëherë se kujtojmë, bejme mire qe harrojme se perdryshe nuk jetojme".

Lamtumire vlla. Vëllezërit, Dergud, Shkelqim, Krenar dhe Benon Kruja.

Vijon nga faqja 12

ham Lincoln), When Lilacs Last in the Dooryard Bloom'd (Kur te oborri lulëzuan jargavanët herën e fundit). Një poezi tjetër e famshme që u kushtua vdekjes së Linkolnit është "O Kapiten! Kapiteni im ("O Captain! My Captain!").

"Ngazëlleni o brigje, dhe bini o kambana!
Veç unë me hap të përzishëm,
Shkoj te kuverta ku rri shtrirë Kapiteni
Akull i ftohtë dhe i vdekur.
(Nga "O Kapiten, Kapiteni im").

Për shkak të shërbimeve të veta të vyera, Uitmani u punësua si sekretar në Departamentin e Punëve të Brendshme. Pastaj e transferuan në Prokurorinë e Përgjithshme, ku shefi i tij e etiketoi veprën Gjethe Bari libër të turpshëm, për shkak të vargjeve të tilla si: Kapelën e vë siç ma ka ënda, jashtë dhe brenda; Nuk kam tule, në kockat e shatit zbuloj ëmbëlsinë e ëmbëlsive; Unë jam burri, vuajta, isha atje; Po flas përçart? Shumë mirë, atëherë po flas përçart"; Lëshova sokëllimën time barbare sipër çative të botës, Kur fal, fal veten time (nga "Kënga ime"); Lundrimi për në Indi (nga "Lundrimi për në Indi"); Më pret një grua (nga "Më pret një grua"); Shtegu i gjatë ngjyrë kafe përpara meje më çon ku ma ka ënda (nga "Këngë për rrugën e lirë"); "… kokëkrisja e pafund e të zgjedhurve (nga "Këngë për sëpatën e burrit"); Pionierë! O Pionierë! (nga "Pionierë! O Pionierë!"). Megjithatë, në Angli vepra e Uitmanit u prit më mirë – mes adhuruesve të tij bënin pjesë Alfred Tenisoni (Alfred Tennyson) dhe Dante Gabriel Roseti (Dante Gabriel Rossetti).

Një goditje paralize më 1873 e detyroi Uitmanin të hiqte dorë nga puna. Në moshën gjashtëdhjetekatërvjeçare, ai u vendos në shpinë e tij të vogël në Mikëll Strit (Mickle Street) në Kamden (Camden) të Nju Xhersit (New Jersey), ku kaloi pothuajse gjithë jetën që i kishte mbetur. Për të u kujdes një vejushë, të cilën e kishte të dashur.

Fama e tij u errësua, ngaqë ishte shprehur hapur lidhur me çështjet seksuale, por nisi të rritej pas njohjes në Angli nga Suinbërni (Swinburne), Znj. Gilkrajst (Mrs Gilchrist) dhe E. Karpenteri (E. Carpenter).

Një histori për vitet e fundit të Uitmanit, e treguar nga një botues, zbulon se autori nuk i humbi asnjëherë vetëbesimin dhe krenarinë, deri sa ndërroi jetë. Uitmani kishte hyrë me mjekrën të shpupuritur dhe me sombreron në kokë, në hollin e Hotel Albertit (Hotel Albert) në Nju Jork. Të pranishmit kishin mbuluar fytyrat me gazetë, për t'u fshehur nga shikimi i shkrimtarit. Ai u kthye, dhe doli jashtë. Botuesi, për kushedi çfarë arsyeje, e ndoqi pas dhe e pyeti se kush ishte. Ai ia ktheu: "Jam Uollt Uitmani. Po më falët një dollar, do të ndihmoni pavdekësinë të bëjë mëkat." [nga The March of Literature (Marshimi i Letërsisë, Ford Madox Ford, 1938)].

Horhe Lui Borhesi (Jorge Luis Borges) e ka cilësuar Uitmanin heroin e epit të vet, personazhin që i pikonte në zemër të ishte: Pra, në njërën faqe të kësaj vepre, Uitmani lind në Long Ailend (Long Island); në të tjerat, në Jug. Pra, në njërin nga pjesët më të mirëfillta te "Kënga ime", ai shtjellon një episod heroizmi nga Lufta Meksikane, dhe thotë se e ka dëgjuar këtë histori të treguar në Teksas (Texas), vend ku nuk kishte shkuar asnjëherë." [nga Biblioteka e plotë (The Total Library, 1999)].

Më 1881 doli botimi i ri, i përpunuar dhe i pasuruar, veprës Gjethe bari. Një vit më pas Uitmani botoi librin Specimen Days & Collect (Mbledhja e ditëve mostra) dhe më 1888 përmbledhjen e artikujve në gazeta November Boughs (Degë nëntori). Vëllimi përfundimtar Gjethe bari u botua para vdekjes së tij, të cilin e përgatiti më 1891-92. Ai mbyllet me një pjesë proze të titulluar "Vështrim prapa i rrugëve të shkelura" ("A Backward Glance O'er Travel'd Roads"), ku përpiqet të shpjegojë jetën dhe veprën e vet. Uitmani vdiq më 26 mars 1892, në Kamden.

Vargjet tallaze-tallaze dhe përdorimi i freskët i gjuhës e ndihmuan Uitmanin të çlironte poezinë amerikane. Ai dëshironte të bëhej bard kombëtar. Mes jehonave të librave të tjerë, dëgjohen edhe ato të klithmave profetike të Biblës, por çiltërsia e tij erotike e veçoi atë nga poetët konvencionalë romantikë. Ai, gjithashtu, mburrej se nuk ishe "as letrar, as i hijshëm" – çka ndoshta nuk ishte aspak e vërtetë. Kur e nxiste Muzën të harronte çështjen e Trojës dhe të shtjellonte tema të reja, e dinte mirë se çfarë ishte çështja e Trojës.

Gjethe bari, fillimisht, u paraqit si grup me 12 poezi, dhe u pasua nga pesë botime të përpunuara, si dhe tre ribotime gjatë kohës që autori ishte ende gjallë. Uitmani mendonte se stili i poetit duhet të jetë i thjeshtë dhe i natyrshëm, pa rimë dhe metër të ngrirë. Poezitë u shkruan për t'u lexuar si bashkëbisedim, por ato kanë larushi të madhe ritmi dhe volumi në ton. Tema qendrore lind nga pikëpamja panteiste e Uitmanit për jetën, nga identifikimi simbolik i ripërtëritjes së natyrës. Përdorimi nga Uitmani i vargut të lirë pati ndikim të madh në poezi. Ai ishte shembull i madh frymëzimi për Brezin Grushtdhënës (Ginsberg, Kerouac, etj.). Në hyrje të kësaj vepre Uitmani shkroi: "Arti i artit, lavdia e të shprehurit dhe shkëlqimi diellor i dritës së letërsisë është thjeshtësia. Asgjë nuk është më e mirë se thjeshtësia … asgjë nuk mund të zëvendësojë teprinë dhe mungesën e qartësisë. Mbartja e peshës së impulsit, zhbirimi i thellësive intelektuale dhe artikulimet e përveçme të temave, nuk janë aftësi të zakonshme, as shumë të pazakonshme. Por të flasësh përmes letërsisë me saktësinë dhe lirshmërinë e përkryer të lëvizjeve të kafshëve, dhe me ndjesinë e panjollosshme të pemëve në pyje dhe të barit buzë rrugës, është ngadhënjimi i pacen i artit."

Vepra të zgjedhura: Franklin Evansi (Franklin Evans, 1842); Gjethe bari (Leaves of Grass, 1855, botimi i parë); Kur përkëdhel daullen (Sequel to Drum-Taps, 1865); Pamje demokratike (Democratic Vistas, 1871); Kujtimet e luftës (Memoranda During the War, 1875); Mbledhja e ditëve mostra (Specimen Days & Collect, 1882-83); Degë nëntori (November Boughs, 1888); Vepra e plotë, 10 vëllime (Complete Writings, 10 vol., 1902); Korrespondenca, 4 vëllime (Correspondence, 1961-69, 4 vols., redaktuar nga E. H. Miller); Vepra në prozë, 2 vëllime (Prose Works, 1963-64, 2 vols., redaktuar nga F. Stoval); Librat e ditëve dhe fletoret e shënimeve (Daybooks and Notebooks, 1978); Gazetari: 1834-1846, (The Journalism: 1834-1846, 1998).

Bordi Editorial Ndërkombetar i revistës "Nacional"

DR. MUJË BUÇPAPAJ,
Instituti i Studimeve dhe Projektteve "Nacional" Kryetar, Tiranë

1. Prof. Dr. Frederick Turner (USA), (Professor, UTD)
2. Prof. Dr. Ed Garcia (USA), (Professor, retired)
3. Dr. Rati Saxena (India), (Drejtoreshë e revistes "Kritya")
4. Mai Van Phan (Vietnam), (Poet Professional, Vietnam)
5. Prof. dr. Vasil Tocinovski, Shkup/Skopje
6. Akademik Fabijan Lovriç (Prof. Dr), Knin, Kroaci
7. Prof. Dr. Basil Schader Zvicer, Universitetit i Cyrihut, albanolog
8. Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj, Akademik, Tiranë
9. Prof. Dr. Milazim Krasniqi, Universiteti i Prishtinës
10. Prof. Dr. Albin Sadiku, Qendra Albanologjike, Prishtine
11. Prof. Dr. Shaban Sinani, Qendra e Stud. Albanaologjike, Tiranë
12. Prof. Dr. Ardian Marashi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
13. Prof. As. Dr. Ukë Bucpapaj, Univeristeti i Tiranës
14. Prof. Dr. Nuridin Ahmeti, (Hulumtues në Degën e Historisë)
15. Prof. Dr. Sadik Bejko, Universitei i Tiranës
14. Dr. Nail Draga, Ulqin, Mail i Zi
15. Pr. Dr. Avzi Mustafa, Universiteti i Shkupit
16. Michael Agustin, Gjermani
17. Naim Araidi, poet, Izrael
18. Dr. Rovena Vata, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
19. Prof. As. Dr. Anton Papleka, Tiranë
20. Prof. Dr. Albert Nikolla, Bruksel
21. Prof. Dr. Klara Kodra, Tiranë
22. Prof. Dr. Laura Smaçi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë

SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
jetojmë më mirë së bashku
Mbrojtja më e mirë
për makinën tuaj.
Siguroni automjetin tuaj me Kasko, i cili
përballet me rreziqe sa herë që lëvizni në
rrugë apo qëndroni në parking.
Sigurimi
KASKO
i makinës
vetëm tek
SIGAL
UNIQA
sigal.com.al